



100 Vjet Pavarësi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2180, datë 29.10.2012

Për

**“Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: Detyrimi i Shërbimit Universal-
Dokument Konsultimi Publik”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare _____, në mbledhjen e datës _____.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: Detyrimi i Shërbimit Universal- Dokument Konsultimi Publik”

- Dokumentacioni i Grupit të Punës përbëhet nga:
- Projekt vendimi
- Relacioni Shoqërues i projekt vendimit
- Dokumenti: “Detyrimi i Shërbimit Universal- Dokument Konsultimi Publik”i përgatitur nga Konsulenti Ndërkombëtar.

BAZA LIGJORE:

1. Nenet 25 e në vijim të Kreut IV të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);
2. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (*ligji nr. 8485*), i ndryshuar;
3. Pika 1, germa (e) dhe pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (ish ERT)” (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues (*VKD*) të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;
4. Udhëzues për Procedurat e Keshillimit me Publikun miratuar me VKD nr.1183, datë 10.03.2010.

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

V Ë R E N:

1. Dokumentacioni i paraqitur nga Grupi i Punës i ngritur me Urdhërin nr. 705, datë 07.06.2011, përbëhet nga:
 - a. Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485;
 - b. Dokumenti: “*Detyrimi i Shërbimit Universal- Dokument Konsultimi Publik*”, i përgatitur nga Konsulenti Nderkombëtar i përzgjedhur nga Banka Botërore (BB) në kuadrin e asistencës së BB për AKEP për implementimin e shërbimit universal në Shqipëri;
 - c. Relacioni shpjegues për Projektvendimin e KD dhe dokumentin “*Detyrimi i Shërbimit Universal- Dokument Konsultimi Publik*”.
2. Dokumenti për Konsultim Publik përmban midis të tjerave:
 - a. një panoramë të politikave, kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës të Bashkimit Europian dhe të Shqipërisë në lidhje me shërbimin universal, përfshirë amendimet e propozuara të Ligjit 9918, nga Qeveria e Shqipërisë në Shtator 2012;

- b. përmbledhje të zhvillimeve kryesore të sektorit dhe situatën aktuale të sektorit në Shqipëri, Vendet Anëtare (VA) dhe Vendet Kandidate dhe Potenciale (CPS) për anëtarësim në Bashkimin Europian, si dhe disa të dhëna dhe analiza relevante në nivel rajonal për Shqipërinë;
 - c. përshkrim mbi mënyrën specifike në të cilën VA dhe CPS kanë implementuar shërbimin universal në praktikë;
 - d. diskutim të detajuar të elementeve kryesore të çdo regjimi shërbimi universal dhe opsionet përkatëse;
 - e. propozime për një sërë parimesh që do të udhëheqin hartimin dhe zbatimin e një plani kuadër shumë-vjeçarë ("Plani Kuadër") si dhe propozime për hapat e mëtejshme për implementimin e shërbimit universal në Shqipëri.
3. Sic është theksuar edhe në Dokument, qëllimi i AKEP është që të krijojë planin kuadër me objektivin që Shqipëria të implementojë plotësisht Direktivën e Shërbimit Universal ("DSHU") të BE-së, ndërsa në të njëjtën kohë të sigurojë që ajo kryhet në mënyrë të tillë që të përfitojë Shqipëria.
 4. Dokumenti: "*Detyrimi i Shërbimit Universal- Dokument Konsultimi Publik*", është përgatitur nga Konsulenti Nderkombëtar, pas një sërë konsultimesh me AKEP, MITIK si dhe me lojtarët e tregut. Me lojtarët e tregut janë zhvilluar dhe takime në AKEP si dhe disa takime me operatorë të vecantë.
 5. Qëllimi i këtij konsultimi është që të kërkojë komentet e palëve të interesuara për një sërë çështjesh të lidhura me zhvillimin e regjimit të shërbimit universal në Shqipëri.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të dokumentit të cituar me lart, bazuar në pikën 1 të nenin 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe pika 17, neni 21 të Rregullores së Brendëshme të AKEP, e ndryshuar,

V E N D O S:

1. Të miratojë nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit "*Detyrimi i Shërbimit Universal- Dokument Konsultimi Publik*" (bashkangjitur).
2. Proçedura e këshillimit publik të kryhet, nga data 01/11/2012 deri më 01/12/2012.

3. Ky vendim dhe dokumenti “*Detyrimi i Shërbimit Universal- Dokument Konsultimi Publik*” të publikohen në faqen e internetit www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURCE

Detyrimi i Shërbimit Universal Dokument Konsultimi

1 Nëntor, 2012

Dokument per Konsultim Publik

(MIRATUAR ME VKD NR.2180 DATE 29.10.2012)

PUBLIKUAR NE www.akep.al ne seksionin Konsultime ne Proces

Detyrimi i Shërbimit Universal Dokument Konsultimi

1 Nëntor, 2012

Përmbajtja

1	Qëllimi	1
2	Kuadri Ligjor dhe i Politikave.....	3
2.1	Kuadri i OBT	3
2.2	Kuadri i BE	3
2.3	Kuadri Kombëtar	11
3	Zhvillimi dhe Statusi i Sektorit.....	22
3.1	Hyrje	22
3.2	Shërbimet e Telefonisë Fikse	23
3.3	Telefonat Publikë me Pagesë	24
3.4	Shërbimet Celulare.....	26
3.5	Shërbimet me Brez të Gjerë (Broadband)	28
3.6	Të Ardhurat e Sektorit.....	30
3.7	Ribalancimi i Tarifave	31
3.8	Penetrimi Fiks në Shqipëri në Nivel Prefekturë.....	32
3.9	Diskutim	35
4	Shërbimi Universal në Praktikë	37
4.1	Caktimi i Sipërmarrësve.....	37
4.2	Forma e Caktimit	38
4.3	Elementët e përcaktuar të detyrimit të SHU	38
4.4	Kërkesat për Kompensim	41
4.5	Mekanizmat Aktualë të Financimit	42
4.6	Diskutim	45
5	Dikutim dhe Identifikimi i Opsioneve.....	47
5.1	Hyrje	47
5.2	Parimet	47
5.3	Akses & Shërbim nga Vendndodhje Fikse	50
5.4	Disponueshmëria e Numeratorit të Përgjithshëm dhe Shërbimit të Kërkimit në Numerator	67
5.5	Disponueshmëria e Telefonave Publikë me Pagesë.....	70
5.6	Masat Ekuivalente për Përdoruesit me Aftësi të Kufizuara	72
5.7	Çështje të Tjera	73
5.8	Hapat e Tjera të Propozuara.....	75

Lista e Shkurtimeve

ADC	Kontributi për Defiçitin e Aksesit
OA	Operator Alternative
BULRAIC	Kosto Mesatare Shtese Afatgjatë Poshtë-Lart (Bottom-Up Long Run Average Incremental Cost)
CATV	Televizion Kabllor
CPC	9 vendet Kandidate dhe Kandidatë të Mundshëm për hyrje në BE
CDir	Numerator Telefonik i Përgjithshëm
KM	Këshilli i Ministrave
DES	Shërbimet e Kërkimit në Numerator
AKEP	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
KE	Komisioni Europian
BE	Bashkimi Europian
BE (EU)-12	12 Vendet Anëtare të BE që u pranuan në 2004 dhe më vonë
BE (EU)-15	15 Vendet Anëtare të BE që jane pranuar para 2004
BE (EU) EU-27	27 Vendet Aktuale të BE
FYROM	Ish Repulika Jugosllave e Maqedonisë
FGSM	GSM Fiks
GoA	Qeveria e Shqipërisë
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
TIK	Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit
ITU	Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve
VA (MS)	Vendet Anëtare të Bashkimit Europian
MITIK	Ministria për Inovacion dhe Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit
AKR	Autoritet Kombëtar Rregullator
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
PKE	Politika për Komunikimet Elektronike
PPP	Partneritet Publik-Privat
FNT	Fuqi e Ndjeshme në Treg
SoIS	Strategjia për Shoqërinë e Informacionit
ULL	Qarku i Hapur Lokal
ASHU	Aksesi dhe Shërbimi Universal
DSHU	Direktiva e Shërbimit Universal
FSHU	Fondi i Shërbimit Universal
USO	Detyrim i Shërbimit Universal
OSHU	Ofrues i Shërbimit Universal
BB	Banka Botërore
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë

1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Dokumenti Konsultimi është që të kërkojë komentet e palëve të interesuara për një sërë çështjesh të lidhura me zhvillimin e regjimit të shërbimit universal në Shqipëri.

Kapitulli 2 ofron një panoramë të politikave, kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës të Bashkimit Europian dhe të Shqipërisë në lidhje me shërbimin universal. Kapitulli 3 jep një përmbledhje të zhvillimeve kryesore të sektorit dhe situatën aktuale të sektorit në Shqipëri, Vendet Anëtare ("VA") dhe vendet candidate dhe potenciale ("CPC") të Bashkimit Europian, si dhe disa të dhëna dhe analiza relevante në nivel rajonal për Shqipërinë. Kapitulli 4 pershkruan mënyrën specifike në të cilën VA dhe CPS kanë implementuar shërbimin universal në praktikë. Bazuar në të gjitha këto, Kapitulli 5 përfshin një diskutim të detajuar të elementeve kryesore të çdo regjimi shërbimi universal dhe opsionet përkatëse. Ai gjithashtu propozon një sërë parimesh që do të udhëheqin hartimin dhe zbatimin e një plani kuadër shumë-vjeçarë ("Plani Kuadër"). Qëllimi i AKEP është që të krijojë planin kuadër me objektivin që Shqipëria të implementojë plotësisht Direktivën e Shërbimit Universal ("DSHU") të BE-së, ndërsa në të njëjtën kohë të sigurojë që ajo kryhet në mënyrë të tillë që të përfitojë Shqipëria.

Në këtë kontekst, ky Dokument Konsultimi është një hap fillestar në këtë proces. Dokumentet vijuese, përfshirë Planin Kuadër, do të përcaktojnë më tej një proces të tillë.

AKEP fton palët të japin kontributin dhe komentet e tyre në lidhje me çështjet e ngritura në këtë Dokument Konsultimi, përfshirë opsionet e referuara më sipër dhe/ose çdo çështje tjetër me rëndësi për zhvillimin e regjimit të shërbimit universal në Shqipëri.

AKEP vë në dukje se ka angazhuar shërbimet e një konsulenti ndërkombëtar për ta ndihmuar me këtë proces konsultimi. Si pjesë e procesit të konsultimit publik, AKEP dhe/ose Konsulenti i AKEP mund të takohet me palët për të shqyrtuar dhe për të diskutuar në mënyrë më të detajuar përgjigjet e tyre për këtë Dokument Konsultimi.

Sic përcaktohet në Seksion 5.8, në përfundim të këtij procesi konsultimi, AKEP pret të publikojë një raport mbi konsultimin që do të japë opinionet kryesore të shprehura dhe përfundime dhe analiza të tjera të nevojshme. Raporti i konsultimit do të përmbajë edhe hapa të tjerë përkatës të mëvonshëm të procesit të konsultimit, sipas rastit. AKEP do të vlerësojë komentet specifike të palëve të interesuara dhe do të gjykojë nëse ka informacion të mjaftueshëm për të përgatitur Planin Kuadër të propozuar. Për këtë çështje, AKEP propozon që të kryejë konsultim me palët e interesuara për Planin Kuadër. Përndryshe, AKEP mund të gjykojë që është më mirë të kryejë analiza të tjera shtesë me objektivin e formulimit apo detajimit të propozimeve specifike.

Ky Dokument Konsultimi është i disponueshëm në faqen e Internetit të AKEP <http://www.akep.al>. Palët e interesuara që dëshirojnë të shprehin opinionet e tyre në lidhje me këtë Dokument Konsultimi ftohen të depozitojnë komentet e tyre me shkrim në AKEP.

Afati i dërgimit të komenteve nga palët është deri më 01 Dhjetor, 2012.

Komentet në lidhje me këtë Dokument Konsultimi mund të dërgohen në një osë disa nga menytrat dhe adresat e mëposhtëme:

a) E-mail : info@akep.al

b) Dërgim me dorë ose me postë (të printuar dhe kopje elektronike):

AKEP
Rruga Rreshit Collaku, nr.43
Tiranë
Shqipëri

AKEP mirëpret të gjitha komentet mbi Dokumentin e Konsultimit. AKEP fton palët e interesuara për të dhënë përgjigje për pyetjet e veçanta të numëruara të përcaktuara në këtë Dokument Konsultimi ("Pyetjet e Konsultimit") dhe për çështje të tjera që palët i konsiderojnë me rëndësi për procesin.

AKEP inkurajon palët që të mbështesin të gjitha komentet me të dhëna, analiza, studime dhe informacione krahasiore përkatëse bazuar në situatën kombëtare ose në përvojën e vendeve të tjera. AKEP mund t'i japë peshë më të madhe komenteve të mbështetura me evidence përkatëse.

Në ofrimin e komenteve të tyre, palëve të interesuara u kërkohet që të tregojnë numrin e Pyetjes (Pyetjeve) së Konsultimit që është i lidhur me komentin e bërë. Palët nuk janë të detyruara të japin komente mbi të gjitha pyetjet e konsultimit. AKEP nuk ka asnjë detyrim të miratojë komentet e asnjë pale.

Kopjet e të gjitha komenteve të paraqitura nga palët e interesuara në lidhje me këtë Dokument Konsultimi do të publikohen në faqen e internetit të AKEP në <http://www.akep.al>.

2 Kuadri Ligjor dhe i Politikave

Ky kapitull paraqet një panoramë të politikave, kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës të Bashkimit Europian dhe të Shqipërisë në lidhje me shërbimin universal.

2.1 Kuadri i OBT

Shqipëria u bë anëtare e Organizatës Botërore të Tregtisë ("OBT") në Shtator të vitit 2000. Në lidhje me telekomunikacionet, angazhimet e Shqipërisë në OBT përfshijnë si angazhimet për hyrjen në treg dhe angazhimet rregullatore përmes inkorporimit me referencë të së ashtuquajturës "Dokumenti Referencë" mbi parimet rregullatore të telekomunikacioneve.

Në lidhje me angazhimet për hyrjen në treg në Shqipëri në përgjithësi nuk kishte kufizime pas janarit të vitit 2003, me përjashtim që Telekomit Shqiptar kishte të drejtat ekskluzive për telefoninë fikse, përveç zonave rurale. Ky kufizim i veçantë u hoq në vitin 2007.

Dokumenti Referencë ka rezultuar të jetë një pasqyrim i qëndrueshëm i praktikave të mira ndërkombëtare në fushën e rregullimit të telekomunikacioneve. Dokumenti Referencë përfshin një sërë përkufizimesh dhe përcaktime, ndërmjet të tjerave, në lidhje me, interkoneksionin, masat mbrojtëse për konkurrencën, licencimin, shërbimin universal, rregullatorët e pavarur dhe e burimet e rralla. Në lidhje me shërbimin universal, Dokumenti Referencë përcakton si më poshtë:

Shërbimi Universal

Çdo Vend Anëtar ka të drejtë të përcaktojë llojin e detyrimit të shërbimit universal që dëshiron të mbajë. Detyrime të tilla nuk do të konsiderohen si anti-konkurrese në vetvete, me kusht që ato të administrohen në mënyrë transparente, jo-diskriminuese dhe në mënyrë neutrale për konkurrencën dhe nuk janë barrë më e rëndë se sa është e nevojshme për llojin e shërbimit universal të përcaktuar nga Vendi Anëtar.

2.2 Kuadri i BE

2.2.1 Shërbimi Universal

Para liberalizimit të sektorit në vendet e BE-së në vitet '90, shërbimi ofrohej përgjithësisht nën kujdesin e Shtetit, me subvencionime të tërthorta nga kompanitë monopol duke siguruar disponueshmërinë e shërbimeve bazë, në veçanti lidhjen në rrjetin fiks dhe thirrjet lokale.

Për shembull, në vitin 2002, kur doli për herë të parë Direktiva e Shërbimit Universal (DSHU), penetrimi mesatar fiks për vendet e BE-15 ishte 51%, që në praktikë do të thotë se telefonia fikse ishte pothuajse universalisht e disponueshme dhe e përdorur. Kuadri i shërbimit universal u hartua për të shoqëruar liberalizimin, me objektivin e ruajtjes së aksesit ekzistues të arsyeshëm me një çmim të përballueshëm.

Ajo ishte, në fakt, një rrjet-sigurie për ata persona, që burimet financiare apo vendndodhja gjeografike nuk i lejonin të kishin shërbimet bazë të komunikimeve elektronike që ishin tashmë në dispozicion dhe përdorshin nga pjesa më e madhe e konsumatorëve.

2.2.1.1 Direktiva e Shërbimit Universal

Direktiva e Shërbimit Universal (“DSHU”) doli për herë të parë në 2002¹ dhe u rishikua në 2009. Ajo krijon kuadrin ligjor të detyrueshëm, mbi të cilin duhet të bazohen të gjitha Vendet Anëtare për marrjen në konsideratë të çështjeve të shërbimit universal në territoret e tyre respektive kombëtare. Siç është diskutuar më poshtë, brenda këtij kuadri DSHU i ofron AKR-ve një fleksibilitet të madh për të hartuar dhe zbatuar marrëveshjet e shërbimit universal bazuar në kushtet e tyre kombëtare. Në vijim është dhënë një përmbledhje e dispozitave kryesore.

Neni 1 parashtron qëllimin dhe parimet, duke përfshirë rëndësinë e mbështetjes në rezultatet e tregut nëpërmjet konkurrencës efektive dhe zgjedhjes dhe se ndërhyrja rregullatore duhet të bëhet vetëm në qoftë se nevojat e përdoruesit fundor nuk janë duke u përmbushur nga tregu, dhe se ndërhyrje të tilla nuk duhet të shtrembërojnë konkurrencën.

Neni 1. Objekti dhe fushëveprimi

1. Në kuadër të Direktivës 2002/21/EC (Direktiva Kuadër), kjo Direktivë ka të bëjë me ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike për përdoruesit fundorë. Qëllimi është për të siguruar në të gjithë Komunitetin disponueshmërinë e shërbimeve në dispozicion të publikut me cilësi të mirë nëpërmjet konkurrencës efektive dhe zgjedhjes dhe trajtimit e rrethanave në të cilat nevojat e përdoruesve fundorë nuk plotësohen në mënyrë të kënaqshme nga tregu.[...]
2. [...] në lidhje me sigurimin e e ofrimit të shërbimit universal brenda një mjedisi tregu të hapur dhe konkurrues, kjo Direktivë përcakton grupin minimal të shërbimeve me cilësi të specifikuar për të cilat të gjithë përdoruesit fundorë duhet të kenë akses, me një çmim të përballueshëm sipas kushteve specifike kombëtare, pa shtrembëruar konkurrencën.

Në lidhje me disponueshmërinë e shërbimit universal, DSHU përcakton se Vendet Anëtare duhet të respektojnë parimet e objektivitetit, transparencës, mos-diskriminimit dhe proporcionalitetit dhe të synojnë të minimizojnë shtrembërimet e tregut.

Neni 3. Disponueshmëria e shërbimit universal

1. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që shërbimet e përcaktuara në këtë Kapitull janë në dispozicion në cilësinë e specifikuar për të gjithë përdoruesit fundorë në territorin e tyre, pavarësisht nga vendndodhja gjeografike, dhe me një çmim të përballueshëm, në varësi të kushteve të veçanta kombëtare.
2. Shtetet Anëtare do të përcaktojnë qasjen më efikente dhe të përshtatshme për të siguruar implementimin e shërbimit universal, duke respektuar ndërkohë parimet e objektivitetit, transparencës, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit. Ata do të kërkojnë të minimizojnë shtrembërimet e tregut, në veçanti ofrimin e shërbimeve me çmime ose objekt i termave dhe kushteve të tjera të cilat shmangen nga kushtet normale komerciale, ndërsa sigurojnë ndërkohe mbrojtjen e interesit publik.

Elementet specifike që janë të përfshira në fushën e shërbimit universal janë si më poshtë (fragmente):

¹ Direktiva 2002/22/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 7 Mars 2002 për shërbimin universal dhe të drejtat e përdoruesve në lidhje me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (Direktiva e Shërbimit Universal). Ajo zëvendësoi Direktivën 98/10/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 26 Shkurt 1998 për aplikimin e ofrimit të rrjetit të hapur (ONP-Open Network Provision) në telefoninë zanore dhe për shërbimin universal në telekomunikacione në një mjedis konkurrues.

Neni 4. Ofrimi i aksesit nga një vendndodhje fikse dhe ofrimi i shërbimeve telefonike.

1. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që të gjitha kërkesat e arsyeshme për lidhje në një rrjet publik të komunikimit nga një vendndodhje fikse plotësohen nga të paktën një sipërmarrës.
2. Lidhja e ofruar duhet të jetë në gjendje për të mbështetur komunikimin zanor, me faks dhe të dhënat me shpejtësi të transmetimit të të dhënave që janë të mjaftueshme për të lejuar akses funksional në Internet, duke marrë parasysh teknologjitë mbizotëruese të përdorura nga shumica e pajtimtarëve dhe realizueshmërinë teknologjike.
3. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që të gjitha kërkesat e arsyeshme për ofrimin e shërbimeve telefonike në dispozicion të publikut mbi lidhjen e rrjetit të përmendur në paragrafin 1 që lejon origjinimin dhe marrjen e thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare plotësohen nga të paktën një sipërmarrës.

Neni 5. Shërbime e kërkimit në numëror dhe numërori

1. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që:
 - (a) të paktën një numëror i përgjithshëm është në dispozicion të përdoruesve fundorë në një formë miratuar nga organi përkatës, në formë të printuar ose elektronike, ose të dyja, dhe ai përditësohet periodikisht, dhe të paktën një herë në vit;
 - (b) të paktën një shërbim i plotë kërkimi në numëror është në dispozicion për të gjithë përdoruesit fundorë, përfshirë përdoruesit e telefonave publikë me pagesë.

Neni 6. Telefonat publikë me pagesë dhe pikat e tjera të aksesit publik të telefonisë zanore

1. Vendet Anëtare duhet të sigurojnë që autoritetet kombëtare rregullatore mund të vendosin detyrime për sipërmarrësit në mënyrë që të sigurojnë ofrimin e telefonave publikë me pagesë apo pikave të tjera të aksesit publik të telefonisë zanore për të përmbushur nevojat e arsyeshme të përdoruesve fundorë në aspektin e mbulimit gjeografik, numrit të telefonave ose pikave të tjera të aksesit, aksesibilitetit për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara dhe cilësisë së shërbimeve.
2. Një Vend Anëtar duhet të sigurojë që autoriteti kombëtar rregullator i tij mund të vendosë për të mos imponuar detyrimet sipas paragrafit 1 në të gjithë ose në një pjesë të territorit të tij, në qoftë se autoriteti është i bindur, në bazë të një konsultimi me palët e interesuara siç përmendet në nenin 33, se këto facilitate ose shërbime të krahasueshme janë gjerësisht të disponueshme,.

Neni 7. Masat për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara

1. Përveçse kur kërkesat kanë qenë të specifikuar në Kapitullin IV të cilat arrijnë të njëjtin efekt, Shtetet Anëtare duhet të marrin masa të veçanta për të siguruar që aksesin në, dhe përballueshmëria e, shërbimeve të identifikuar në Nenin 4 (3) dhe Nenin 5 për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara është në nivel të njëjtë me atë të përfituar nga përdoruesit e tjerë. Shtetet Anëtare mund të detyrojnë autoritetet kombëtare rregullatore për të vlerësuar nevojën e përgjithshme dhe kërkesat specifike, duke përfshirë masën dhe formën konkrete të këtyre masave specifike për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara.

Në lidhje me caktimin e sipërmarrësve, USD përcakton sa më poshtë:

Neni 8. Caktimi i sipërmarrësve

1. Vendet Anëtare mund të caktojnë një ose më shumë sipërmarrës për të garantuar sigurimin e shërbimit universal, të identifikuar sipas Neneve 4, 5, 6 dhe 7 dhe, ku është e aplikueshme, Neni 9 (2), në mënyrë që i tërë territori kombëtar të mund të mbulohet. Shtetet Anëtare mund të caktojnë sipërmarrës apo grupe sipërmarrësish të ndryshëm për të siguruar elementet e ndryshme të shërbimit universal dhe / ose për të mbuluar pjesë të ndryshme të territorit kombëtar.

2. Kur Vendet Anëtare përcaktojnë sipërmarrës me detyrime për shërbimin universal, në të gjithë ose në pjesë të territorit kombëtar, ato duhet ta bëjnë këtë duke përdorur një mekanizëm përcaktimi eficient, objektiv, transparent dhe jo-diskriminues, ku asnjë sipërmarrës nuk është i përjashtuar a priori nga përcaktimi si ofrues shërbimi universal. Këto metoda përcaktimi duhet të sigurojnë që shërbimi universal ofrohet me kosto-efektive dhe mund të përdoren si një mjet për përcaktimin e kostos neto të detyrimit të shërbimit universal, në përputhje me Nenin 12.

Në lidhje me përballueshmërinë e tarifave, përfshirë Tarifat Sociale:

Neni 9. Përballueshmëria e tarifave

2. Shtetet Anëtare, sipas kushteve kombëtare, mund të kërkojnë që sipërmarrësit e përcaktuar të ofrojnë për konsumatorët opsione ose paketa tarifore të ndryshme nga ato të ofruara në kushte normale komerciale, në veçanti për të siguruar që ata me të ardhura të ulëta ose me nevoja të veçanta sociale nuk kanë pengesa për akses në rrjet i përmendur në Nenin 4 (1), ose për përdorimin e shërbimeve të identifikuar në Nenin 4 (3) dhe Nenin 5, 6 dhe 7, që janë pjesë e detyrimeve të shërbimeve universale dhe të ofruara nga sipërmarrësit e përcaktuar.

3. Shtetet Anëtare mundet që, përveçse ndonjë dispozite për sipërmarrësit e përcaktuar për të ofruar opsione të veçanta tarifore apo që ata të rresktojnë tavane të çmimeve apo çmime mesatare gjeografike ose skema të tjera të ngjashme, të sigurojnë ofrimin e mbështetjes për konsumatorët e identifikuar me të ardhura të ulëta ose me nevoja të veçanta sociale.

Neni 12 i DSHU lidhet me kostot e detyrimeve të shërbimit universal dhe përcakton se kur rregullatorët kombëtarë konsiderojnë se shërbimi universal mund të përfaqësojë një barrë të padrejtë mbi sipërmarrësit ofrues të shërbimit universal, ata do të llogarisin kostot neto të ofrimit të shërbimit, duke përfshirë përfitimet jo të prekshme të tregut.

Neni 13 ka të bëjë me financimin e detyrimeve të shërbimit universal dhe përcakton se kur rregullatorët kombëtarë (NRA) përcaktojnë se bazuar në kostot neto ka një barrë të padrejtë, shtetet anëtare mund të (a) prezantojnë një mekanizëm kompensimi me kushte transparente nga fondet publike, dhe / ose (b) të ndajnë koston neto të detyrimeve të shërbimit universal midis ofruesve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike. Shtetet anëtare do të krijojnë një mekanizëm për ndarjen e kostove të bazuar në parimet e transparencës, shtrembërimit më të vogël të tregut, mos-diskriminimit dhe proporcionalitetit. Shtetet anëtare mund të zgjedhin që të mos kërkojnë kontribute nga sipërmarrësit të cilët kanë të ardhura (xhiro) kombëtare më të ulëta se një kufi i caktuar.

Neni 32 i DSHU ofron fleksibilitet për shtetet anëtare për të përfshirë shërbime të tjera shtesë të detyrueshme përveç atyre të përfshira më sipër. Megjithatë, këto detyrime shtesë duhet të zbatohen jashtë fushëveprimit të detyrimeve të shërbimit universal (dhe kështu nuk duhet të jenë objekt i kompensimit të lidhur me detyrimet e shërbimit universal) dhe në përputhje me aspekte të tjera të kuadrit të BE²:

Neni 32. Shërbime të Tjera të Detyrueshme

Shtetet anëtare mund të vendosin që të bëjnë publikisht të disponueshme në territorin e vet edhe shërbime të tjera, përveç shërbimeve të përfshira në detyrimet e shërbimit universal të përkufizuara në Kapitull II, por në raste të tilla nuk mund të vendosen mekanizma kompensimi për sipërmarrës të vecantë.

² Për shembull, dokumenti i KE në vitin 2010 "Udhëzimet për Ndihmën Shtetërore në Broadband" shpjegon kushtet në të cilat fondet publike mund të përdoren për të shtrirë rrjetet broadband në zona specifike. Në vecanti, KE kërkon njoftimin nga shtetet anëtare të "Ndihmës Shtetërore" dhe komisioni mund ta kundërshtojë atë nëse financimi publik nuk është i pajtueshëm me kushtet e përcaktuara.

2.2.1.2 Rishikimi i Fushës së Shërbimit Universal

DSHU përcakton se KE do të rishikojë periodikisht fushën e shërbimit universal. Rishikimi i parë do të kryhej brenda dy viteve, dhe më pas do të kryheshin rishikime çdo tre vjet. Rishikimet do të kryhen në kuadrin e zhvillimeve shoqërore, ekonomike dhe teknologjike, ndër të tjera, lëvizshmërinë dhe të shpejtësisë broadband të të dhënave në dritën e teknologjive mbizotëruese të përdorura nga shumica e abonentëve.

Aneksi V i DSHU përcakton disa elementë të caktuar që duhet të merren parasysh nga KE për të vendosur nëse shërbime të caktuara duhet të përfshihen në fushën e shërbimit universal, përkatësisht:

- A janë shërbimet e veçanta të disponueshme dhe të përdorura nga shumica e konsumatorëve dhe mungesa e disponueshmërisë ose mos-përdorimi nga një pakicë e konsumatorëve a rezultojnë në përjashtim social?
- A krijon disponueshmëria dhe përdorimi i shërbimeve specifike një përfitim të përgjithshëm neto për të gjithë konsumatorët të tillë që të bëjë të nevojshme ndërhyrjen publike në rastet kur shërbimet specifike nuk i ofrohen publikut nën rrethana normale komerciale?

Për më tepër, DSHU tregon se që shërbime të caktuara të përfshihen në fushën e shërbimeve përkatëse ato duhet tashmë të jenë në dispozicion për një shumicë të konsiderueshme të popullsisë.

KE ka kryer tre rishikime³ të veçanta (rishikimi i fundit diskutohet më poshtë) dhe nuk ka ndryshuar fushën e detyrueshme të shërbimit universal: as mobiliteti dhe as aksesit broadband nuk kanë përmbushur kriteret e mësipërme. Megjithatë, siç është përcaktuar më poshtë, versioni i 2009 i jep Shteteve Anëtare mundësinë, por jo detyrimin, për të përfshirë aksesin në lidhje broadband brenda fushës së detyrimeve kombëtare të shërbimit universal në disa kushte të caktuara.

2.2.1.3 Komunikimi i DSHU i Nëntor 2011

Ky dokument⁴ raporton mbi rezultatin e konsultimit mbi parimet e shërbimit universal dhe broadband të ndërmarrë nga KE Dhe ai gjithashtu përfshin rishikimin e tretë periodik të fushës së shërbimit universal dhe përcakton reflektime mbi masat që duhet të merren nga shtetet anëtare për zbatimin e DSHU.

Në lidhje me parimet e shërbimit universal dhe broadband, Komunikimi ka parashtruar sa më poshtë::

- **Tregje konkurruese.** Kuadri rregullator i BE dhe politika e saj e aksesit të hapur kanë nxitur tregjet konkurruese, duke rritur zgjedhjen e konsumatorit dhe uljen e çmimeve, si dhe vendosjen e disa vendeve të BE-së ndër liderët botërorë në

³ Rishikimi parë dhe i dytë janë si në vijim: Komunikimi i Komisionit COM(2005) 203 i 24 Maj, 2005 “Mbi Rishikimin e Fushës së Shërbimit Universal në përputhje me Nenin 15 të Direktivës 2002/22/EC” dhe Komunikimi i Komisionit COM(2008) 572 i 25 Shtator, 2008 “Mbi rishikimin e dytë periodike të fushës së shërbimit universal rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike në përputhje me Nenin 15 të Direktivës 2002/22/EC”

⁴ Komunikimi i Komisionit COM(2011) 795 i 23 Nëntor, 2011 “Shërbimi universal service komunikimet elektronike: raport mbi rezultatet e konsultimit publik dhe rishikimi i tretë periodik i fushës në përputhje me Nenin 15 të Direktivës 2002/22/EC”

broadband. Brenda BE-së, vendet që kanë nivel më të lartë blerje/përdorimi të broadband janë Vendet Anëtare me konkurrencë në infrastrukturë, e kombinuar me rregullim efikas ex ante për promovimin e konkurrencës në shërbime ku konkurrenca në infrastrukturë nuk është e mundur.

- **Opsionet tjera të financimit.** Për (bashkë-)financimin e zhvillimit të infrastrukturës janë të disponueshme mjete të ndryshme të politikave, përfshirë financimin publik (p.sh. kreditë, grantet për partneritetet publiko-private). KE ka sqaruar se si mund të jepen fondet publike për zhvillimin e broadband për të arritur mbulim edhe në zonat ku nuk ka asnjë interes komercial, në përputhje me rregullat e BE-për ndihmën shtetërore.
- **Zgjerimi i mëtejshëm i tregut.** Ndryshe telefonia në BE-15 para më shumë se një dekade, tregu broadband në BE-27 nuk është ende një treg i maturuar, por më tepër një treg i karakterizuar nga inovacioni dhe evolucioni dinamik. Zhvillimet teknologjike, konkurruese dhe rregullatore, p.sh. kostot në rënie të teknologjive pa tela dhe dividenti dixhital, ka të ngjarë të rrisin në mënyrë të konsiderueshme mbulimin broadband.
- **Kostot e broadband.** Komunikimi vuri në dukje se një studim⁵ i porositur prej Komisionit, kishte llogaritur se kostot neto në rang BE për të siguruar disponueshmërinë (mbulimi) dhe përballueshmërinë (tarifat e subvencionuara sociale) e një lidhje 2 Mbps broadband ishte rreth 0.7% e xhiros së sektorit të telekomunikacioneve të BE në tërësi. Megjithatë, kjo përqindje ndryshon në mënyrë të konsiderueshme midis Vendeve Anëtare, duke qenë më i lartë në vendet me infrastrukturën broadband relativisht më pak të zhvilluar dhe me një popullsi rurale relativisht të madhe dhe/ose të rrallë. Në veçanti, kostoja për Rumaninë do të ishte 4.6% e xhiros në Rumani.
- **Detyrimi i Shërbimit Universal të mos zgerohet për të përfshirë Broadband në rang BE.** Komunikimi vërejt se ishte e qartë se nëse detyrimi i SHU do të zgjerohet për të përfshirë broadband në të gjithë BE, nevoja për financim sektorial dhe “subvencionim të tërthortë” midis grupeve të konsumatorëve të një vendi të caktuar do të rritej ndjeshëm, dhe barra mbi industrinë dhe ndikimi në çmimet e konsumatorit do të ishte më i madh në VA me mbulim dhe nivel të ulët broadband dhe të të ardhurave aktuale. Për më tepër, vendosja para kohe e detyrimit për broadband në BE apo në nivel kombëtar rrezikon shtrembërimin e tregjeve dhe pengimin e investimeve private në broadband. Ndërsa nga kompanitë e telekomunikacioneve mund të pritët që të investojnë në rrjete të reja fitimprurëse, një pyetje themelore shtrohet nëse detyrim i zgjeruar i SHU, që vëndos një barrë të rëndë vetëm në sektor në interes të përfshirjes sociale, do të ishte e përshtatshme dhe e qëndrueshme, ndërsa subjekte të tjera private dhe publike dhe shoqëria si e tërë kanë përfitime nga përhapja kudo e broadband.

Në lidhje me rishikimin e tretë periodic, KE nuk e ndryshoi fushën e detyrueshme të DSHU, por ofroi udhëzime në lidhje me broadband dhe çështje të tjera. Me objektivin e zbatimit konsekuent të DSHU në të gjitha shtetet anëtare, bazuar në këtë fleksibilitet, KE bën thirrje për një qasje koherente në veçanti për çështjet e mëposhtme:

⁵ *Impact of EU Policy options for revision of the universal service provision*, Van Dijk Management Consultants etj., Tetor 2010

- **Fusha e detyrimeve të shërbimit universal në lidhje me ‘aksesin funksional në Internet’ me shpejtësi me brez të gjerë (broadband).** Broadband nuk u vendos si element i detyrueshëm në detyrimet e SHU në të gjithë BE, por bazuar në fleksibilitetin në lidhje me këtë të përfshirë në DSHU, ky Komunikim përcaktoi një grup kriteresh që Vendet Anëtare duhet të konsiderojnë për përfshirjen e broadband në detyrimet e SHU. Në mënyrë specifike, detyrimi për të ofruar lidhje me brez të gjerë me një shpejtësi të caktuar brenda detyrimeve të shërbimit universal duhet të konsiderohet vetëm kur niveli në trajtim i shpejtësisë së të dhënave (rregulli “50/80”) përdoret nga të paktën:
 - 50% e të gjitha familjeve në nivel kombëtar, dhe
 - 80% e të gjitha familjeve më lidhje me brez të gjerë
- **Qasjet e përbashkëta për caktimin.** Një mekanizëm caktimi që lejon shtetet anëtare për të shqyrtuar të gjitha mundësitë teknike për sigurimin e shërbimit universal ka të ngjarë të prodhojë rezultatin me kosto më efektive. Një periudhë caktimi tepër e gjatë ose e pakufizuar mund të përjashtojë a priori operatorë të tjerë nga të qenit të caktuar - transparenca dhe mos-diskriminimi mund të promovohen nëpërmjet periudhave kohore të kufizuara për përcaktimin e detyrimeve të shërbimit universal. Për të shmangur diskriminimin, një përcaktim mund të hartohet në mënyrë të tillë që ai të mos zgjasë më shumë se sa është e nevojshme që të mbulojë kostot përkatëse të investimeve dhe që të mos tejkalojë një kohëzgjatje maksimale (për shembull 10 vjet).
- **Llogaritja e kostos neto e ofrimit të shërbimit universal.** Efiçensa mund të rritet nëpërmjet hartimit të qasjes metodologjike për llogaritjen e kostos neto të shërbimit universal përpara çdo procesi përcaktimi, si dhe duke u konsultuar publikisht mbi të. Kryerja e një llogaritje të veçantë të kostos neto për secilin sipërmarrës të përzgjedhur do të sigurojë transparencën dhe saktësinë. Gjithashtu është e rëndësishme që të sqarohen parimet që duhet të zbatohen nga autoritetet kombëtare kur vlerësohet nëse detyrimet e shërbimit universal përbëjnë një barrë të padrejtë mbi ofruesin e shërbimit universal.
- **Financimi.** Çdo mekanizëm financimi sektorial për shërbimin universal duhet të jetë transparent, objektiv, proporcional dhe jodiskriminues, si dhe duhet të përpiqet të minimizojë shtrembërimet në konkurrencë dhe kërkesën e përdoruesve. Prandaj, në rastet kur implementohet një mekanizëm për ndarjen e kostove, duhet të merret në konsideratë vendosja e një tavanit për kontributet e operatorëve për shërbimin universal. Çdo kosto shtesë mbi tavanin duhet të financohet nga fondet publike. Në veçanti, Komisioni propozon që operatorët që kanë më pak se €5m të ardhura vjetore nuk duhet të paguajnë kontribut, kurse për operatorët e mëdhenj kontributet për shërbimin universal duhet të kenë si tavan 0,40-0,65% të të ardhurave dhe duhet të jenë rreptësisht në proporcion me pjesët e tregut në të ardhura. Tavanet do të mund të kufizojnë edhe barrën mbi operatorët nëse një Shtet Anëtar vendos të përfshijë broadband në fushën e detyrimeve të shërbimit universal.
- **Masat për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara.** Shtetet Anëtare mund edhe të inkurajohen për të marrë në konsideratë në mënyrën e duhur nevojat e përdoruesve të tillë në hartimin e detyrimeve të tyre kombëtare të shërbimit universal, në përputhje me parimin e garantimit të ekuivalencës së aksesit.

2.2.2 Kontributi për Defiçitin e Aksesit

Para nxjerrjes së versionit të parë të DSHU në vitin 2002, kuadri i BE lidhur me shërbimin universal përfshinte një numër të dokumenteve të lidhura, reflektues i situatës së sektorit në atë kohë. Në këtë aspekt, në kontekstin e përgjithshëm të kalimit nga monopoli në konkurrencë, një prej sfidave ishte sigurimi i një tranzicion nga skemat tradicionale të subvencionimit të tërthortë për promovimin e shërbimit universal drejt mekanizmave transparente dhe efikase (të tilla si Fond i shërbimit universal i përcaktuar në DSHU).

Skema të tilla subvencimi të tërthortë të monopoleve përfshinin zakonisht tarifë nën-kosto të pajtimit mujor (dhe shpesh thirrje lokale). Defiçiti financiar i krijuar nga çmime të tilla të aksesit nën koston përkatëse referohet si "defiçit aksesi". Në mjediset monopol, një defiçit i brendshëm i tillë financohej nga ana e operatorit monopol nëpërmjet fitimeve të brendshme nga tarifat mbi kosto të thirrjeve në distancë të gjatë dhe atyre ndërkombëtare. Pasi konkurrenca është futur, këto skema subvencionimi të tërthortë të brendshëm nuk janë më të qëndrueshme ose të barabarta dhe prandaj ka presion komercial për "ribalancim" të çmimeve drejt koston, që do të thotë një rritje në çmimet e pajtimit mujor dhe thirrjeve lokale dhe një rënie në çmimet e thirrjeve në distancë të gjatë dhe ndërkombëtare .

Me synimin e kryerjes së një procesi ribalancimi gradual pas fillimit të konkurrencës, disa operatorë në vendet e industrializuara, edhe të BE, e eksternalizuan skemën e mësipërme të subvencionimit të tërthortë duke futur një Kontribut Defiçiti i Aksesit ("ADC"). Një pagesë e tillë e llojit ADC paguhej nga hyrësit e rinj konkurrues të operatorit inkumbent, përgjithësisht si një shtesë mbi tarifat e interkoneksionit të bazuara në kosto.

Direktiva e KE e vitit 1995 Aksesi i Hapur (95/62/EC) kërkonte që tarifat të ndjekin parimet themelore të orientimit në kosto dhe transparencës dhe përcaktoi që kontributet e palëve të interkonektuara për skemat e "ADC janë të lejueshme vetëm kur kufizimet rregullatore janë të imponuara nga AKR-të për disa lloje të caktuara tarifash bazuar në arsyet e përballueshmërisë dhe qasjes.

Gjithashtu, dokumenti i KE "Udhëzime mbi llogaritjen e koston dhe tarifimin për shërbimin universal", publikuar në vitin 1996, përcaktoi se skemat e ADC do të duhet të zbatoheshin vetëm përkohësisht, deri në vitin 2000, kohë në të cilën duhet të jetë kryer një nivel i mjaftueshëm i rebalancimit në të gjitha Shtetet Anëtare dhe se skema të tilla duhet të eliminohen.

Në përfundim, gjatë kësaj periudhe tranzicioni, KE nuk dëshironte që skema të tilla ADC të konvertoheshin apo përndryshe të përfshiheshin si pjesë e regjimit të ri të shërbimit universal sipas DSHU 2002 dhe direktivës paraardhëse (ONP 1998):

3. Në përputhje me Direktivën e Konkurrencës Plotë, Skemat Kombëtare për llogaritjen e koston së detyrimeve të shërbimit universal mund të mos përfshijnë një 'kontribut aksesi defiçiti' që i atribuohet strukturës kombëtare të pabalancuar të tarifave.

Tradicionalisht, operatorët shpesh kanë siguruar lidhje, pagesa mujore (dhe nganjëherë edhe thirrje lokale) me çmime të lira nëpërmjet subvencioneve të tërhorta nga të ardhurat e thirrjeve në distancë të gjatë dhe ndërkombëtare. Kjo shpesh do të thoshte që operatorët që ofronin aksesin nuk arrinin të merrnin një normë të arsyeshme fitimi nga kapitalin e punësuar nga shërbimet e lidhjes në rrjet dhe dhe pajtimit mujor për linjën e aksesit.

Kur një operator, i cili nuk përballet me konkurrencën, ka një "defiçit aksesi", tipikisht operatori kompensohet nga fitimet shumë të larta të gjeneruara nga shërbime të tjera të tilla si thirrje telefonike në distancë të gjatë dhe ndërkombëtare. Ku ekziston kjo situatë, tarifat e operatorit janë

"të pabalancuara" me kostot që ai ka. Në një treg konkurrues nje operator nuk duhet të jetë i detyruar për të ruajtur zbalancime të tilla tarifore.

4. Skemat Kombëtare të njoftuara Komisionit duhet të përfshijnë afate kohore për fazat e ardhme të zbalancimeve të mbetura të tarifave. Një ribalancim i tillë duhet të përfundojë deri më 1 Janar 2000, maksimumi, përveç rasteve të atyre Shteteve Anëtare të cilave i'u është dhënë një periudhë shtesë zbatimi në përputhje me Nenin 1 (2) të Direktivës Konkurrencës së Plotë. Në raste të tilla data për përfundimin e rebalancimit do të jetë data në të cilën përfundon periudha shtesë e zbatimit.
5. Aty ku nuk është e mundur për të përfunduar ribalancimin e tarifave deri më 1 Janar 1998, Shtetet Anëtare mund, në përputhje me Direktivën e Konkurrencës së Plotë, të krijojnë mekanizma të ndara nga Skemat Kombëtare për shërbimin universal për të parandaluar hyrësit e rinj në treg të përfitojnë padrejtësisht nga struktura e çmimeve (p.sh. tarifat e larta për shërbimet ndërkombëtare dhe në distanca të gjata të cilat nuk janë të orientuara drejt kostos) të krijuara nga rregullimi i çmimeve të operatorit incumbent.

Në vijim janë dhënë fragmente nga Aneksi B, i titulluar "Skemat e Kontributit të Defiçitit të Aksesit: Kriteret e Vlerësimit të Skemave të Defiçitit të Aksesit ":

Në mënyrë që të plotësojnë këto kushte skema të tilla duhet të jenë në përputhje me parimet e përcaktuara më poshtë

1. Pas 1 janar 1998, operatorët e interesuar ruajnë subvencionime të mëdha të tërthorta për aksesin familjar të cilat shkajnë përtej asaj çka do të pritej sipas praktikave normale tregtare (d.m.th operatorë të tillë janë objekt i kufizimeve rregullatore të cilat i kanë penguar ata nga përfundimi i procesit të ribalancimit të tarifave dhe kjo ka rezultuar në struktura tarifore të cilat janë thelbësisht jo në përputhje me kapitalin e investuar në ofrimin e aksesit lokal).
2. Skemat e Defiçitit të Aksesit duhet të zbatohen vetëm në periudha të përkohshme dhe vetëm deri më 1 Janar 2000.

2.3 Kuadri Kombëtar

2.3.1 Dokumentat e Politikave

Qeveria e Shqipërisë ka miratuar disa dokumenta të politikave që trajtojnë TIK në përgjithësi dhe telekomunikacionet në mënyrë specifike. Këto përshkruhen në mënyrë të përmbledhur më poshtë duke vënë theksin në çështjet e shërbimit universal.

2.3.1.1 Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013 ("SKZHI") u miratua nga KM në Mars 2008. SKZHI është i bazuar në 38 strategji sektoriale dhe ndërsektoriale dhe përbën dokumentin strategjik gjithpërfshirës të zhvillimit të Qeverisë Shqiptare. TIK janë identifikuar si një nga strategjitë ndërsektoriale dhe me vizionin e mëposhtëm:

Vizioni është për një shoqëri ku të gjithë qytetarët mund të përfitojnë nga teknologjia e informacionit dhe komunikimit me qëllim shtimin e njohurive, rritjen e efektshmërisë dhe të transparencës në administratën publike.

Prioritetet e kësaj strategjie ndërsektoriale në lidhje me telekomunikacionet janë identifikuar si më poshtë: 1) hyrja në fuqi e ligjit të ri për komunikimet elektronike në përputhje me *acquis communautaire* të BE, 2) përgatitja e kuadrit rregullator përkatës nga Autoriteti Kombëtar Rregullator; 3) forcimi i rolit dhe kapaciteteve të Ministrisë dhe Autoritetit

Kombëtar Rregullator dhe 4) promovimi i konkurrencës në tregun e telekomunikacioneve për shërbime të reja.

2.3.1.2 Strategjia Ndërsektoriale për Shoqërinë e Informacionit

Strategjia për Shoqërinë e Informacionit ("SSHI") u miratua nga Këshilli i Ministrave në Janar 2009 duke përcaktuar vizionin e mëposhtëm:

Progresin e Shqipërisë drejt një ekonomie të bazuar në njohuritë, përmes një zhvillimi të qëndrueshëm të shoqërisë së informacionit që do të çojë në një shoqëri ku të gjithë qytetarët përfitojnë nga teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit me qëllim shtimin e njohurive, rritjen e efektshmërisë dhe të transparencës në administratën publike.

SSHI ka përcaktuar një seri të politikave që duhen ndjekur, përfshirë në lidhje me: 1) Zhvillimi i infrastructures së TI; 2) Zhvillimi i shërbimeve të e-Government; 3) promovimi i edukimit dhe njohurive; 4) e-commerce, 5) Kuadri institucional dhe ligjor. Në lidhje me shërbimin universal, SoIS deklaroi si më poshtë:

Shërbimi universal ka një rol të dyfishtë: social dhe zhvillues. Përmbytja e shërbimit universal duhet të ndryshojë dinamikisht për të qënë në linjë me zhvillimet e vazhdueshme të infrastrukturës, teknologjive dhe kërkesave të përdoruesve. Shërbimi universal duhet të përfshijë ato elemente që i shërbejnë eliminimit të diskriminimeve për aksesin nga të gjithë në Shoqërinë e Informacionit.

2.3.1.3 Dokumenti i Politikave për Komunikimet Elektronike

Dokumenti i Politikave për Komunikimet Elektronike ("PKE") u nxorr nga Ministri i Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Parlamentin në Shkurt 2010.

PKE përcakton strategjinë afatmesme të Qeverisë Shqiptare për zhvillimin e rrjeteve dhe shërbimeve për komunikimet elektronike. Ajo zëvendëson dokumentin e politikave të miratuar në vitin 1999 për sektorin e telekomunikacionit. PKE është në vijim të SKZHI dhe kërkon të arrijë integrimin në tregun e përbashkët të BE-së për komunikimet elektronike.

Kapitulli 8 i përcakton propozimet dhe pritshmëritë në lidhje me shërbimin universal, të përmbledhura si më poshtë:

- **Objekti dhe kuptimi i "shërbimit universal"**. PKE thekson se në kohën e monopoleve, shërbimi universal në shumë vende të industrializuara (përfshirë Europën Veriore dhe Perëndimore) i referohej pritshmërisë që operatorët monoplistë të kompensojnë humbjet në një zonë me fitime nga zona të tjera. Ky lloj subvencionimi i tërthortë brenda monopolit çoi në nivele të larta të penetrimit të shërbimit të telefonisë fikse. Lejimi i konkurrencës në treg pengon mbajtjen e çmimeve të pabalancuara dhe kjo nënkuptonte që kishte nevojë për një qasje të re nëse kompensimi për humbjet do të mbahej nën kontroll. Prandaj, në kuadrin ligjor (*acquis*) të BE, shërbimi universal është përcaktuar si një paketë e detyrimeve ligjore të cilat qeveritë duhet të marrin masa për ta realizuar.
- **Ofrimi i shërbimeve kudo**. Për sa i përket kostove ekonomike të garantimit që shërbimet baz janë të disponueshme kudo, kuadri ligjor (*acquis communautaire*) i BE është hartuar në mënyrë të tillë që vendet të ruajnë nivelet e larta të penetrimit të cilat tashmë ishin arritur në vendet e BE në mënyrë që ato të mos bëheshin të papërbalueshme për shkak të liberalizimit. Direktiva e Shërbimit Universal ka dy qëllime kryesore: e para, të sigurojë që paketa e shërbimeve bazë të vazhdojë të

ofrohet dhe e dyta, të sigurojë që rregullatorët nuk shtremëbërojnë tregun me masa të ndërmarra për të financuar ofrimin e tyre.

- **Përfundime**

- **Prezantimi i** telefonisë së lëvizshme në dy dekadat e fundit ka ndryshuar plotësisht vendin e telefonisë fikse në *plotësimin e nevojave të shoqërisë*. Penetrimi i telefonisë fikse tashmë është në rënie në shumicën e vendeve të BE-së. Është e qartë se rregullat e BE-së për të siguruar disponueshmërinë universale të aksesit në komunikime mund të kenë nevojë për t'u ndryshuar si përgjigje ndaj situates së re.
- Një çështje thelbësore e cila duhet të trajtohet nga AKEP-i është shkalla në të cilën tregu i lirë është gati dhe i aftë të ofrojë paketën e shërbimeve bazë sa herë të jetë e nevojshme. Aspekti i përballueshmërisë së çmimeve është potencialisht më shumë problematic veçanërisht në pjesë të caktuara të vendit.
- Qeveria e Shqipërisë pret që Ministria, AKEP-i dhe agjencitë e tjera të interesuara të mbajnë këtë çështje në rishikim të vazhdueshëm për të siguruar përfitime maksimale për përdoruesit në Shqipëri.

2.3.1.4 Draft Plani Broadband

Më 3 Maj 2012 MITIK publikoi për konsultim publik "Draftin Final mbi Planin për Rrjetin Kombëtar Brezgjërë" ("Draft Plani Broadband"), i cili përcakton objektivat dhe procedurat për zhvillimin e ardhshëm të Broadband në Shqipëri (deri në vitin 2020), si edhe masat konkrete për mbështetjen e tij.

Politika parashtron një qasje bashkëpunuese midis sektorit publik dhe privat si edhe midis qeverisjes kombëtare, rajonale dhe locale për të promovuar dhe më vonë universalizuar shërbimet Broadband dhe ajo mbështetet tek konkurrenca për zgjerimin e tregjeve Broadband.

Draft Plani Broadband mund të përmblihdhet në mënyrë substanciale si më poshtë:

- Qeveria e Shqipërisë ka pranuar se është e domosdoshme që të ketë akses broadband me shpejtësi të lartë në të gjithë vendin dhe në veçanti në zonat rurale. Plani vlerëson situatën aktuale institucionale, ligjore dhe rregullatore dhe teknologjike dhe identifikon mundësitë për të përmirësuar aksesin në broadband.
- Draft Plani Broadband merr parasysh kërkesën për akses të gjerë për të gjitha grupet e popullsisë, sektori i biznesit dhe administratës publike, duke përfshirë promovimin e aksesit në shërbimet e Shoqërisë së Informacionit për zonat rurale dhe të largëta, në përputhje me politikat ekzistuese kombëtare.
- Draft Plani Broadband qartëson fokusin e politikës dhe përcakton një politikë Broadband përshtatur me situatën dhe sfidat me të cilat ndeshet vendi, duke përfshirë sigurimin e broadband në zonat rurale. Masat specifike do të përcaktohen për të synuar zonat e pashërbyera dhe pak të shërbyer në lidhje me broadband, përfshirë zonat e largëta dhe rurale, për të promovuar shtrirjen dhe ndërgjegjësimin për

përfitimet e TIK në jetën e përditshme, punë, arsim, tregti, qeveri dhe shëndeti, dhe për të rritur investimet.

- Draft Plani Broadband përcakton objektivat, nivelet e synuara dhe strategjitë e përgjithshme të zbatimit të broadband që përfundimisht do të çojnë në një projekt për realizimin e tyre. Ai gjithashtu thekson rëndësinë dhe rolet përkatëse të pjesëmarrjes së sektorit publik dhe privat dhe partneriteteve, si në aspektin e përcaktimit të objektivave, projekteve dhe piketave të rëndësishme, si edhe në krijimin e një shumëllojshmëri të modeleve financiare.
- Më e rëndësishmja, Draft Plani Broadband synon të krijojë instrumentat të cilat do të krijojnë një ambient të përshtatshëm për investime private, përfshirë reformën ligjore dhe rregullatore dhe mekanizmat e tregut efektiv dhe financiare për të zhvilluar rrjetet broadband.
- Qëllimi është që shumë nga masat e sugjeruara të mund të zvogëlojnë nevojën për ndërhyrje publike përmes buxhetit të qeverisë duke krijuar mjedisin ku shtrirja e rrjetit Broadband do të mund të arrihet nëpërmjet zgjerimit dhe ndërtimit nga operatorët bazuar në mekanizmat e tregut (përmes licencimit). Tregjet do të jenë në gjendje të funksionojë në mënyrë efektive dhe eficiente dhe sektori TIK do të jetë në gjendje të ofrojë akses më të madh në shërbimeve, vetëm nëpërmjet krijimit të instrumenteve të nevojshme për të lejuar lojtarët e tregut të konkurrojnë.
- Përveç liberalizimit të tregut, Qeveria Shqiptare është duke shqyrtuar instrumentet dhe mjetet rregullatore që synojnë rritjen e investimeve dhe aksesin në infrastrukturën e telekomunikacioneve në zonat rurale me kosto të lartë dhe të ardhura të ulëta. Këto mund të përfshijnë, qoftë në mënyrë të veçantë apo në kombinim me njëra tjetrën:
 - Financimin e shërbimit universal për të siguruar subvencione të pjesshme për programe që kryesisht synojnë stimulimin e sektorit privat për ofrimin e infrastrukturës në zonat rurale apo të pashërbyera;
 - Metoda të tjera financimi dhe iniciativa projektesh nga qeveritë kombëtare, rajonale dhe lokale, kooperativat, OJF-të apo operatorët privatë për të krijuar programe që synojnë zgjerimin e mbulimit në zonat rurale me kosto të lartë dhe rritjen e kërkesës së konsumatorëve me të ardhura të ulëta;
 - Metoda financimi të mandatuara nga shteti dhe të kontrolluara duke përdorur subvencione të tërthorta dhe mekanizmave të tjera financiare;
 - Minimizimin dhe/ose heqjen e ndonjë taksimi specifik për telekomunikacionet;
 - Përgatitjen e udhëzimeve të politikave miqësore ndaj investimeve (përfshirë, për shembull, transparencë, zbatueshmëri dhe stimuj për investimet).
 - Krijimin e mjeteve inovative për të siguruar mbështetje financiare dhe stimuj për investime në dhe përdorimin e Broadband, përfshirë:
 - Lejimin e aksesit për autoritetet lokale në fondet kombëtare të Broadband për të zgjeruar ose përdorur rrjetet kryesorë me fibra që kanë qenë ose janë duke u

ndërtuar për të lidhur deri entitetet publike (shkolla, biblioteka, klinikat), në mënyrë që të çojnë lidhjet me shpejtësi të lartë tek komunitetet e pashërbyera;

- Shoqërimin e përdorimit të fondeve nga partneritetet-publiko-private (PPP) dhe instrumentave të tjera financiare me fonde të qeverisë apo instrumenta që me ndarje të riskut;
- Përdorimin e instrumenteve financiare, të cilat mund të jenë lloje të borxheve, garancive ose aksioneve, ose një kombinim i tyre, për ti përshtatur me nevojat e projekteve të investimeve në aspektet e fleksibilitetit, maturimit dhe riskut.
- Objektivat specifike afatgjata të përcaktuara në Draft Planin Broadband përfshijnë:
 - Arritjen e aksesit Broadband bazë mbarëkombëtar qoftë në mënyrë direkte për të gjitha familjet apo bizneset apo përmes institucioneve jo-fitim prurëse, jo më vonë se fund i vitit 2017, me objektivat e mëposhtme të parashikuara:
 - dyfishimin e numrit të familjeve dhe kompanive që kanë akses në lidhje broadband;
 - 100% e shkollave me të paktën një lidhje Broadband në Internet në çdo klasë;
 - 100% e universiteteve me
 - 100% e zyrave postare të ofrojnë të paktën një lidhje Broadband në Internet për qytetarët [në të gjitha fshatrat me popullsi më shumë se xxx];
 - 100% e [spitaleve/qendrave mjekësore] me të paktën një lidhje Broadband në Internet;
 - Përveç disponibilitetit të aksesit bazë në rrjetet Broadband për të gjitha familjet dhe bizneset në [2015/2017], deri në vitin 2020 duhet të jetë i disponueshëm ofrimi i aksesit Broadband me shpejtësi të lartë, me shpejtësi transmetimi të paktën 100 Mbps për 50% të familjeve dhe akses në broadband me shpejtësi transmetimi të paktën 30 Mbps për të gjithë Shqiptarët.

2.3.2 Kuadri Ligjor

Ligji 9918 datë 19 Maj 2008 për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë kishte si qëllim të transpozonte *acquis communautaire* në kuadrin ligjor në përputhje me kuadrin rregullator të 2002 të BE. Me qëllim reflektimin e amendimeve të kuadrit rregullator të 2009 të BE, Qeveria e Shqipërisë në Shtator 2012 miratoi amendimet e propozuara të Ligjit 9918, përfshirë amendime që kanë lidhje me shërbimin universal, të cilat janë depozituar në Kuvend për diskutime dhe dekretim. .

2.3.2.1 Ligji 9918

Për sa i përket shërbimit universal, Neni 3 (Përkufizime) i Ligjit 9918 përmban termat dhe përkufizimet e mëposhtme të lidhura me shërbimin universal

“Ofruesi i shërbimit universal” është sipërmarrësi që ofron shërbimin universal.

“Shërbimi universal” është një minimum i përcaktuar shërbimesh, të një cilësie të caktuar, i mundshëm për të gjithë përdoruesit në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga vendndodhja gjeografike, me çmime të përballueshme.

Përcaktimet standarte të lidhura me shërbimin universal janë përfshirë në Kapitullin V të Ligjit 9918, i cili përmban gjashtë Nene (Nenet 25 deri 30). Më poshtë është një përmbledhje e këtyre neneve:

- **Neni 25 – Shërbimi Universal.** Përcakton katër elementët e Detyrimeve të Shërbimit Universal të DSHU, të quajtura akses dhe shërbim telefonik nga vendndodhje fikse (me shpejtësi të komunikimit të të dhënave jo më të vogël se 32 kbit/s), numeratori dhe shërbimet e kërkimit të informacionit në numerator, disponibilitetin e telefonave publikë me pagesë dhe akses të barabartë për përdoruesit me aftësi të kufizuara. Neni përmban gjithashtu një sërë përcaktimesh në lidhje me shkëmbimin e informacionit dhe çështje të tjera të lidhura me numeratorin dhe shërbimet e kërkimit të informacionit në numerator. Objektivi i këtij Neni është të transpozojë disa nga parimet e Neneve 3, 4, 5, 6 dhe 7 të DSHU 2002.
- **Neni 26 – Sigurimi i Shërbimit Universal.** Parashikon që AKEP mund të caktojë një ose më shumë ofrues të shërbimit universal (OSHU). Neni përcakton se në përzgjedhjen e OSHU në fillim duhet të kete gjithmonë një proces tenderi. Vetëm nëse procesi i tenderit dështon, atëherë AKEP mundet që të nominojë një OSHU bazuar në një proces konsultimi dhe pas miratimit nga Ministri. Objektivi i këtij Neni është të transpozojë disa nga parimet e Nenit 8 të DSHU 2002.
- **Neni 27 – Tarifat dhe kushtet e përgjithshme për Shërbimin Universal.** Përmban parime lidhur me tarifat e shërbimit universal, përfshirë monitorimin dhe regullimin nga AKEP, dhe se tarifa për një shërbim individual duhet të jetë e njëjtë në të gjithë territorin e vendit. Bazuar në këtë Nen mund të ofrohen edhe tarifa me zbritje (sociale). Objektivi i këtij Neni është të transpozojë disa nga parimet e Neneve 9 dhe 10 të DSHU 2002.
- **Neni 28 – Cilësia e Shërbimit Universal.** Përcakton se AKEP do të monitorojë cilësinë e shërbimit universal, përfshirë përcaktimin e kërkesave teknike. Objektivi i këtij Neni është të transpozojë disa nga parimet e Nenit 11 të DSHU 2002.
- **Neni 29 – Skema e kompensimit për sigurimin e Shërbimit Universal.** Përmban një sërë përcaktimesh në lidhje me kompensimin, përfshirë shërbimet specifike (Aksesin dhe Shërbimet nga Vendndodhje Fikse dhe Tarifat Sociale). Neni parashikon që AKEP do të përcaktojë metodologjinë e përlllogaritjes së kostove neto të Shërbimit Universal, përfshirë përfitimet e patrupëzuara për kompensimin e Ofruesve të Shërbimit Universal. Neni parashikon gjithashtu se ofruesit e Shërbimit Universal duhet të mbajnë llogari të ndara për kostot e ofrimit të shërbimit universal dhe se ata duhet të dërgojnë këtë informacion në AKEP një herë në vit, si dhe përmban përcaktime të tjera të lidhura. Objektivi i këtij Neni është të transpozojë disa nga parimet e Nenit 12 të DSHU 2002.
- **Neni 30 – Financimi i Shërbimit Universal.** Përmban përcaktime në lidhje me krijimin e fondit të shërbimit universal për kompensimin e kostove neto të shërbimit universal. FSHU do të menaxhohet dhe administrohet nga AKEP dhe ai financohet nga kontributet e sektorit të sipërmarrësve që ofrojnë shërbime të komunikimeve

elektronike të cilat nuk duhet të jenë më shumë se 1% e të ardhurave totale. Ky Nen nuk përmend mundësinë e financimit të shërbimit universal me fonde publike. AKEP rimbursen nga fond i shërbimit universal secilin ofrues të shërbimit universal për kostot neto të miratuara të shërbimit universal. AKEP depoziton në Kuvendin e Shqipërisë një raport vjetor, përfshirë informacion financiar dhe informacion tjerër të lidhur me të. Objektivi i këtij Neni është të transpozohet disa nga parimet e Nenit 13 dhe 14 të DSHU 2002.

2.3.2.2 Amendimet e propozuara për Ligjin 9918 nga Qeveria e Shqipërisë

Më poshtë është një përmbledhje e amendimeve kryesore substanciale të propozuara në lidhje me shërbimin universal:

- **Neni 25 – Shërbimi Universal.** Ky nen është riformuluar dhe ndarë (shiko më poshtë). Riformulimi parashikon që AKEP do të ndërmarrë masat e duhura rregulluese për garantimin e shërbimit universal bazuar në Ligjin 9918 dhe në rregullat e miratuara nga KM. Masa të tilla rregulluese duhet të bazohen në parimet e objektivitetit, transparencës, jodiskriminimit dhe proporcionalitetit, për të garantuar ofrimin e shërbimeve korresponduese, me sa më pak dëmtime të mundshme të tregut. Objektivi i Neni të riformuluar është të transpozohet disa nga parimet e Neni 3 të DSHU 2009.
- **Neni 25/1 – Sigurimi i aksesit nga një vendndodhje fikse dhe ofrimi i shërbimit telefonik.** Objektivi i këtij Neni të ri është të transpozohet disa nga parimet e Neni 4 të DSHU 2009. Në lidhje me aksesin në Internet ky nen përcakton, në përputhje me DSHU, se lidhja e ofruar duhet të jetë në gjendje të ofrojë “komunikimin e të dhënave, me një shpejtësi të kënaqshme për të lejuar aksesin funksional të Internetit, duke marrë parasysh teknologjitë mbizotëruese të përdorura nga shumica e pajtimtarëve dhe mundësitë e realizimit teknologjik.”
- **Neni 25/2 – Sigurimi i Numerorit Telefonik dhe Rubrika e Informimit për Numrat.** Objektivi i këtij Neni të ri është të transpozohet disa nga parimet e Neni 5 të DSHU 2009.
- **Neni 25/3 – Telefonat publike me pagese dhe pikat e tjera të aksesit publik telefonik.** Objektivi i këtij Neni të ri është të transpozohet disa nga parimet e Neni 6 të DSHU 2009.
- **Neni 25/4 – Masat për ofruesit me aftësi të kufizuar.** Objektivi i këtij Neni të ri është të transpozohet disa nga parimet e Neni 7 të DSHU 2009.
- **Neni 26 – Sigurimi i Shërbimit Universal.** Në përputhje me DSHU, Paragrafi 1 është rishikuar në mënyrë që AKEP *mund* të caktojë OSHU-t sipas rregullave të miratuara nga KM bazuar në një propozim të Ministrisë dhe objekt i një sërë kritereve. Paragrafët 2 dhe 4 shfuqizohen dhe përcaktimet e tjera janë rishikuar për konsistencë. Objektivi i këtij Neni të rishikuar është të transpozohet disa nga parimet e Neni 8 të DSHU 2009.
- **Neni 27 – Tarifat dhe kushtet e përgjithshme për Shërbimin Universal.** Në përputhje me DSHU, Paragrafi 1 është rishikuar në mënyrë që AKEP do të monitorojë shërbimet e përcaktuara të ofruara nga OSHU-t, ose nga tregu nëse nuk ka OSHU të caktuar. Paragrafi 3 është rishikuar gjithashtu për konsistencë. Paragrafi 6 është

zgjerruar për të përfshirë shumë më tepër detaje për detyrime që AKEP *mund* të vendosë ndaj OSHU-ve t'i ofrojnë përdoruesve fundorë që ata të kenë mundësinë e kontrollit të shpenzimeve të tyre. Objektivi i këtij Neni të rishikuar është të transpozohet disa nga parimet e Neneve 9 dhe 10 të DSHU 2009.

- **Neni 28 – Cilësia e Shërbimit Universal.** Ky nen ngelet i pandryshuar. Objektivi i këtij Neni është të transpozohet disa nga parimet e Nenit 11 të DSHU 2009.
- **Neni 29 – Skema e kompensimit për sigurimin e Shërbimit Universal.** Në përputhje me DSHU, Paragrafi 1 është rishikuar në mënyrë që OSHU-t të mund të kërkojnë kompensim për ofrimin e shërbimit sipas Neneve 25/1 deri 25/4 dhe Nenit 27, paragrafi 3, nëse ato krijojnë një barrë të padrejtë. Objektivi i këtij Neni të rishikuar është të transpozohet disa nga parimet e Nenit 12 të DSHU 2009.
- **Neni 30 – Financimi i Shërbimit Universal.** Ky nen ngelet i pandryshuar. Objektivi i këtij Neni është të transpozohet disa nga parimet e Neneve 13 dhe 14 të DSHU 2009.

2.3.3 Kuadri Rregullator

2.3.3.1 Shërbimi Universal

Në Vendet Anëtare dispozitat kryesore në lidhje me detyrimet e SHU janë të përfshira në legjislacionin primar. Në shumë Vende Anëtare, elementet specifike dhe të detajuar të detyrimeve të SHU, janë të përfshira në legjislacionin sekondar, të tilla si rregullore, dekretet apo vendime të AKR. Kapitulli V i Ligjit 9918 në disa raste i referohet rregulloreve që lidhen me shërbimin universal të nxjerra nga AKEP. Siç është përcaktuar në Seksionin 5.8, AKEP është i mendimit se dispozitat e përgjithshme në Kapitullin V të ligjit 9918 duhet të zhvillohen më tej të kenë më shumë specifikime dhe për këtë qëllim propozon që Rregullore të tilla të SHU të përgatiten në një kohë të përshtatshme. AKEP pret që Rregulloret e SHU të plotësojnë dispozitat përkatëse të ligjit në mënyrë të tillë që të sigurojnë më shumë detaje dhe specifikime, përfshirë detaje dhe specifikime në lidhje me kriteret, procedurat, metodologjinë dhe çështjet administrative, duke marrë parasysh edhe rregullat që mund të nxirren nga KM në zbatim të disa prej dispozitave të reja të përfshira në ndryshimet e propozuara nga Qeveria Shqiptare për Ligjin 9918, të përmenduar më lart.

2.3.3.2 Analizat e Tregut Fiks dhe ADC

Analiza e Parë e Tregut Fiks

Analiza e parë e tregut fiks u krye në vitin 2007 (Vendimi 410, datë 13.11.2007)(“Vendimi 410”). Në vendimin 410, AKEP, ndër të tjera, identifikoi nevojën për të vazhduar procesin për ribalancimin e tarifave me pakicë Albtelecom⁶. Për këtë qëllim KM (Vendimi 854, datë 18.06.2008) miratoi një metodologji për Albtelecom të propozuar nga AKEP-i për rregullimin e normës së ndryshimit të tarifave (price cap) me afat dy-vjeçar, të ndarë në katër faza.

Metodologjia e rregullimit të tarifave e miratuar nga KM kishte objektivin e vazhdimin të procesit të ribalancimit të tarifave të shërbimeve të Albtelecom me anë të rritjeve të tarifave të pajtimit mujor, instalimit dhe thirrjeve lokale dhe reduktimevetë tarifave të thirrjeve

⁶ Si edhe në vendet e tjera, procesi i ribalancimit në Shqipëri është në vazhdim dhe filloi të implementohej në kontekstin e liberalizimit të sektorit, me vendime të veçanta të KM në 2001 dhe 2003.

kombëtare dhe ndërkombëtare dhe thirrjeve drejt rrjeteve celulare. Nga mesi i 2010 aplikimi i metodologjisë së tarifave kishte rezultuar me të vërtetë në një nivel konsiderueshëm të rebalancimit – tarifat e pajtimit mujor dhe thirrjeve lokale u rritën deri në 79% dhe 45%, dhe u realizuan ulje në tarifatat e instalimit dhe thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare me 19% deri në 72%.

Analiza e Dytë e Tregut Fiks

Në Korrik 2010, AKEP nxorri Vendimin 1348 në lidhje me analizën e dytë të tregut fikse. Përmbledhtazi, AKEP gjeti Altelecom me FNT në gjashtë tregje përkatës me pakicë dhe në tre tregje përkatës me shumicë të lidhura me shërbimet fikse⁷, dhe vendosi një sërë detyrimesh përkatëse ex ante, përfshirë rregullimin e tarifave për shërbimet fikse me pakicë dhe me shumicë, sipas Nenit 45 të Ligjit 9918. Asnjë prej OA nuk u gjet me FNT për shërbimet e tyre fikse dhe për rrjedhojë asnjë prej shërbimeve të tyre fikse nuk ishte objekt i rregullimit ex ante. .

Në lidhje me ribalancimin, Vendimi 1348 vuri në dukje se pagesa e pajtimit mujor familjar të Altelecom vazhdonte të ishte më e ulëta në rajon, madje edhe me zbatimin fazës së katërt të metodologjisë së rregullimit të tarifave në 1 Mars 2010, që përfshinte një rritje të tarifës së pajtimit mujor në 442 lek / muaj. Vendimi 1348 vuri në dukje gjithashtu se tarifa aktuale e pajtimit mujor gjithashtu dukej se ishte relativisht e ulët në krahasim me disa nga rezultatet e sudimit të kostos mesatare inkrementale afatgjatë poshtë-lart ("BULRAIC), të porositur nga AKEP, dhe modeli dhe rezultatet draft finale të së cilit ishin në konsultim publik më 11 Qershor deri më 10 Korrik 2010. Bazuar në konsideratat e mësipërme, AKEP arriti në përfundimin se tarifatat e telefonisë fikse për familjarë të Altelecom nuk ishin ende plotësisht të ribalancuara dhe se procesi i ribalancimit duhet të vazhdonet në të ardhmen, por nuk përfshiu ndonjë propozim konkret. .

Me shqyrtimin e rezultateve të studimit BULRAIC, Vendimi 1348 arriti në përfundimin se për shkak të çmimit nën-kosto të pajtimit mujor Altelecom kishte një normë të ulët kthimi në tërësi dhe një deficiet të madh aksesit në veçanti. Në mënyrë të ngjashme, AKEP arriti në përfundimin se tarifatat e interkoneksionit përpara Shtator 2010 ishin më të ulëta se sa kostoja BULRAIC. E gjithë kjo do të rezultonte në një situatë të vështirë financiare për Altelecom. Në këtë kontekst, AKEP vendosi të rriste tarifatat e interkoneksionit të Altelecom në një nivel më të lartë se koston BULRAIC, si një masë e përkohshme për të siguruar qëndrueshmërinë financiare të Altelecom. Një shtesë e tillë mbi tarifatat e interkoneksionit të bazuara në kosto mund të interpretohet si skemë e tipit ADC.

⁷ 1. Tregu me pakicë i aksesit në rrjet telefonik publik nga vendndodhje fikse për klientet familjare; 2. Tregu me pakicë i aksesit në rrjet telefonik publik nga vendndodhje fikse për klientet jo-familjare; 3. Tregu me pakicë për shërbimet telefonike lokale dhe/ose kombëtare të disponueshme për publikun të ofruara nga vendndodhje fikse për klientet familjare. 4. Tregu me pakicë për shërbimet telefonike ndërkombëtare të disponueshme për publikun të ofruara nga vendndodhje fikse për klientet familjare. 5. Tregu me pakicë për shërbimet telefonike lokale dhe/ose kombëtare të disponueshme për publikun të ofruara nga vendndodhje fikse për klientet jo-familjare. 6. Tregu me pakicë për shërbimet telefonike ndërkombëtare të disponueshme për publikun të ofruara nga vendndodhje fikse për klientet jo-familjare. 7. Tregu me shumicë i origjinimit të thirrjeve në rrjetin telefonik publik telefonik të ofruara nga vendndodhje fikse. 8. Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve për rrjete publike telefonike individuale të ofruara nga Altelecom nga vendndodhje fikse. 9. Tregu me shumicë i shërbimeve transite kombëtare në rrjetet publike telefonike fikse.

Analiza e Tretë Preliminare e Tregut Fiks

Më 2 Gusht, 2012, AKEP me Vendim 2138, nxorri analizën e tretë paraprake të tregut fikse në formën e një dokumenti konsultimi ("Vendim 2138"). Vendimi përfundimtar mbi këtë analizë të tretë të tregut do të merret pas procesit dhe periudhës së konsultimit të nevojshëm.

Në lidhje me tregjet me shumicë, Vendimi 2138 ka identifikuar tre tregje përkatëse.⁸ Ai gjeti se Albtelekom dhe të gjithë OA, përfshirë AMC në shërbimet të saj GSM fikse ("FGSM") AMC Fiks, janë operatorë me FNT në tregun përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjetet e tyre përkatëse. Vetëm Albtelekom është me FNT në lidhje me tregjet përkatës të shërbimeve të origjinimit dhe tranzitimit. Në këtë aspekt, detyrimet ex ante korresponduese me shumicë për Albtelekom mbeten të pandryshuara nga vendimi 1348, përfshirë në lidhje me rregullimin e tarifave. Detyrimet ex ante për OA janë më të pakta, por ato përfshijnë rregullimin e tarifave. Në fakt, vendimi 2138 propozon një reduktim të përshkallëzuar të të gjitha tarifave të interkoneksionit të Albtelecom drejt disa vlerave që kanë marrë parasysh një sërë faktorësh, përfshirë vlerat mesatare në BE dhe vendet e rajonit. Gjithashtu, Vendimi 2138 propozon një reduktim të përshkallëzuar të tarifave të terminimit të OA (të ndryshëm nga Albtelecom), me qëllim që ato konvergojnë me tarifën e terminimit të Albtelecom në vitin 2015, duke eliminuar kështu asimetrinë aktuale të tarifave të terminimit midis Albtelecom dhe OA.

Vendimi 2138 nuk ka përfshirë ndonjë diskutimin për defiçit aksesi të Albtelecom dhe as tarifën e propozuar të interkoneksionit për Albtelecom nuk kanë përfshirë një shtesë të nënkuptuar mbi tarifën e interkoneksionit të bazuar në kosto. Në këtë aspekt, Vendimi 2138 përfundon një element të skemës së përkohshme të tipit ADC të krijuar me Vendimin 1348.

Në lidhje me tregjet me pakicë, Vendimi 2138 ka identifikuar dy tregje përkatëse⁹: akses në rrjetin publik telefonik nga një vendndodhje fikse (për abonentët familjarë dhe jo-familjarë), shërbimet publike telefonike (thirrje) të ofruara nga një vendndodhje fikse ((për abonentët familjarë dhe jo-familjarë). Duke pasur parasysh dinamikën specifike të tregut në Shqipëri (shih Kapitullin 3), duke përfshirë penetrimin relativisht shumë të lartë celular, një nga çështjet e shqyrtuara në këtë analizë të tregut ishte nëse aksesi/thirrjet nga rrjetet celulare janë në të njëjtin treg përkatës si aksesi/thirrjet nga një vendndodhje fikse? Pas diskutimit të një sërë faktorësh, duke përfshirë faktorin kyç të mobilitetit kundrejt "vendndodhjes fikse", Vendimi 2138 ka konkluduar se aksesi/thirrjet nga rrjetet celulare nuk janë pjesë e të njëjtit treg përkatës si edhe aksesi/thirrjet nga një vendndodhje fikse.

Më tej, Vendimi 2138 vuri në dukje se që prej Vendimit 1348, Vodafone dhe AMC kanë aplikuar dhe kanë marrë numeracion gjeografik fikse nga AKEP për ofrimin e shërbimeve të telefonisë fikse duke përdorur rrjetin GSM ("FGSM"). Vodafone nuk ka komercializuar ende këtë shërbim, por AMC ka filluar me markën AMC Fiks dhe tashmë ka fituar rreth 2% pjesë tregu në vetëm një muaj aktivitet. AMC ka aftësinë për të ofruar këtë shërbim në të gjithë Shqipërinë, ku ka mbulim GSM (mbulimi i popullsisë 99.8%), i cili siç është përmendur në Vendimin 2138, është një mbulim shumë më i madhe sesa i rrjetit Albtelecom. AKEP mendon se FGSM përfshihet në tregjet përkatëse me pakicë fikse të përmendura më sipër (duke pranuar se ka disa dallime midis telefonisë FGSM dhe telefonisë fikse tradicionale me tela).

⁸ Këto janë të njëjtë me tregjet me shumicë të identifikuar në Vendimin 1348.

⁹ Këto dy tregje përfshijnë të njëjtat shërbime si në Vendimin 1348, por janë të segmentuara në dy tregje dhe jo në gjashtë.

Në lidhje me FNT në tregjet fikse me pakicë, Vendimi 2138 gjeti se Albtelecom ka FNT në të dy tregjet përkatëse. Asnjë nga OA nuk u gjet me FNT në këto tregje me pakicë.

Në shqyrtimin e imponimit të detyrimeve ex ante, Vendimi 2138 ka analizuar një numër faktorësh¹⁰ dhe arriti në përfundimin se ai nuk do të vendosë më detyrimin e rregullimit të tarifave me pakicë Albtelecom. Megjithatë për këto shërbime me pakicë do të ngelen detyrimet e tjera ex ante, duke përfshirë detyrimin për transparencë dhe mos-diskriminimit. Heqja e detyrimit të rregullimit të tarifave synon të krijojë fleksibilitet në tarifim dhe shërbim për Albtelecom dhe të rrisë stimujt për investime me objektiv rritjen e penetrimit fiks.

Vendimi 2138 vuri në dukje se AKEP do të vazhdojë monitorimin e shërbimeve të caktuara me pakicë, me qëllim për të siguruar vazhdimin e përballueshmërisë së tyre për abonentët e rrezikuar dhe konsideron se reduktimet e përshkallëzuara me faza të propozuara për tarifën e terminimit do t'i krijojë fleksibilitet Albtelecom në lidhje me abonentët e tillë.

Në lidhje me rebalancimin, Vendimi 2138 theksoi se në zbatim të Vendimit 1348, çmimet për dy paketat standarde tarifore nën rregullim të Albtelecom, “Familjare” dhe “Të Tjerë” nuk kanë ndryshuar që nga ajo kohë dhe se tarifa mujore për familjare vazhdon të jetë më e ulëta në rajon. Vendimi 2138 përsëriti përfundimin e mëparshëm se, megjithëse ka pasur progress, tarifën e Albtelecom për telefoninë fiks për familjarë nuk ishin ende plotësisht të ribalancuara, por shtoi se një zgjidhje e bazuar në mekanizmat e tregut mund të jetë më efektive se sa ndërhyrje e vazhdueshme rregulatore (dhe për rrjedhojë ndërprerje të rregullimit të tarifave).

Ky është një vendim kritik në lidhje me çështjen e skemave të tipit ADC për shkak se, siç u diskutua më sipër, një element kritik i skemave të tilla është që ato rezultojnë nga kufizimet rregulatore që imponohen nga AKR për tarifën e caktuara për shkaqe të përballueshmërisë dhe qasjes. Kur kufizime të tilla rregulatore eliminohen, siç është ky rast për shkak se rregullimi i tarifave nuk është më një detyrim ex ante për Albtelecom, arsyetimi dhe domosdoshmëria për çdo formë të një skeme të tipit ADC zhduken. Kjo është për shkak se operatori përkatës tani përballet me një vendim komercial, dhe jo më me një pengesë rregulatore, se si ai të strukturojë tarifën e tij dhe për këtë arsye nuk mund t'i kërkojë operatorëve të tjerë për të kompensuar operatorin për vendime të tilla komerciale. Në këtë aspekt, Vendimi 2138 përfundon elementin tjetër të skemës së përkohshme të tipit ADC të krijuar me Vendimin 1348.

Pyetje #1: Ju lutemi jepni komentet tuaja në lidhje me këtë Kapitull. A ka politika, ligje, rregullore ose vendime apo normativa të tjera, kombëtare, rajonale apo ndërkombëtare, në lidhje me shërbimin universal që AKEP duhet të marrë në konsideratë në analizën e tij?

¹⁰ Disa prej këtyre faktorëve përfshijnë midis të tjerave: dinamikën e vecanta të Shqipërisë (përfshirë penetrimin fiks, numrin relativisht të madh të OA, trafikun e origjinnuar nga fiks në raport me atë nga celular, etj.); praktikën rregullore në vendet e BE në lidhje me shërbimet fikse; një numër relativisht i lartë i pajtimtarëve të Albtelecom kanë zgjedhur paketa të reja (kundrejt dy paketave nën rregullim); paketimi nga Albtelecom dhe OA i shërbimeve telefonike me shërbimin e Internetit; fillimi i implementimit të një sërë masash rregullore në nivel me shumicë, përfshirë hapjen e qarkut lokal dhe portabilitetin e numrit fiks që do të rrisë presionin konkurrues mbi Albtelecom.

3 Zhvillimi dhe Statusi i Sektorit

3.1 Hyrje

Ky Kapitull përmbledh zhvillimet kryesore dhe situatën aktuale të sektorit në Shqipëri nga një perspektive rajonale duke u fokusuar në Vendet Anëtare dhe Vendet Kandidate dhe Kandidate Potencialë (“CPC”¹¹)¹². Ky kapitull jep një panoramë të sektorit nga këndvështrimi i SHU dhe ka për qëllim të potësojë analizat e tjera të AKEP, përfshirë analizat përkthëse të tregjeve të shërbimeve specifike, si Vendimi 2138. Për qëllime krahasimi dhe lehtësi në prezantim, janë përdorur 3 grupimet e mëposhtme si krahasues rajonalë:


- **BE-15 (EU-15)** janë Shtetet Anëtare të cilat ishin anëtare përpara zgjerimit të BE-së në 2004: Belgjika, Danimarka, Gjermania, Irlanda, Greqia, Spanja, Franca, Italia, Luksemburgu, Holanda, Austria, Portugalia, Finlanda, Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar.
- **BE-12(EU-12)** janë 12 Shtetet Anëtare që aderuan në BE në dhe pas vitit 2004: Bullgaria, Qipro, Letonia, Republika Çeke, Estonia, Lituania, Hungaria, Malta, Polonia, Rumania, Sllovenia, Sllovakia.
- **CPC-5** janë 5 vendet CPC, përveç Shqipërisë, të cilat ndodhen në rajonin e Ballkanit dhe që nuk janë në listë për të hyrë së afërmi në BE¹³: Mali i Zi, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (“FYROM”), Bosnja dhe Hercegovina, Kosova sipas Rezolutës 1244/99 (“Kosova”) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Serbia.

Figurat 1 dhe 2 paraqesin mesataret e popullsisë dhe të të ardhurave kombëtare (Produkti i Brendshëm Bruto (“PBB”) për banorë) për të tre grupet krahasuese dhe Shqipërinë nga viti 2000 deri në vitin 2010, dhe tregojnë se mesatarisht vendet e BE-15 dhe BE-12 janë shumë më të populluara dhe kanë të ardhura më të larta se Shqipëria dhe 5 vendet CPC. Shqipëria dhe 5 vendet e grupit CPC janë relativisht të krahasueshme në lidhje me këta dy tregues të rëndësishëm.

¹¹ Shtetet në vijim janë nëntë vendet CPC deri në Korrik 2012: Islanda, Mali i Zi, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Turqia, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova (sipas Rezolutës 1244/99 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara) dhe Serbia.

¹² Të gjitha të dhënat janë marrë nga Eurostat, përveç rasteve kur tregohet ndryshe. 2010 është viti më i afërt për të cilin Eurostat ka të dhëna për treguesit më të rëndësishëm. Në raste të përshtatshme, të dhëna për vitin 2011 për Shqipërinë janë marrë nga AKEP apo INSTAT, sipas rastit.

¹³ Përveç Shqipërisë, 3 vendet CPC që nuk janë përfshirë në këtë grup janë Turqia (vend jo Ballkanik; me një popullsi 20 herë më të madhe se Shqipëria), Islanda (vend jo Ballkanik; me të ardhura kombëtare (PBB) 10 herë më të larta se të Shqipërisë) dhe Kroacia (e pranuar në BE dhe që pritet të aderojë nga mesi i vitit 2013).



3.2 Shërbimet e Telefonisë Fikse

Figura 3 tregon penetrimin mesatar të telefonisë fikse (e shprehur si përqindje e linjave fikse për banorë) për grupet e BE-15, BE-12 dhe CPC-5 dhe për Shqipërinë nga viti 2000 deri në 2011¹⁴. Në Korrik 2012 penetrimi i telefonisë fikse në Shqipëri arriti në 11.5%. Figura 4 paraqet penetrimin mesatar të telefonisë fikse për 27 vendet e BE-së dhe për 9 vendet CPC (përfshirë Shqipërinë) për 2010 në një grafik me format shpërndarje: penetrimi i telefonisë fikse paraqitet në boshtin vertikal –y dhe të ardhurat kombëtare (të shprehura si PBB/banorë) në boshtin horizontal –x. Në fakt, Figura 4 paraqet një analizë grafike të marrëdhënies midis penetrimit të telefonisë fikse dhe të ardhurave kombëtare. Në këtë figurë, pikat përfaqësojnë secilin prej 36 vendeve, përfshirë Shqipërinë.





Figura 3 tregon se megjithëse penetrimi i telefonisë fikse në vendet BE-15 mbetet krahasimisht i lartë, ai ka pësuar rënie gjatë periudhës 2000-2010 deri në rreth 42% në 2010. E njëjta gjë vlen edhe për vendet BE-12, ku niveli fillestar ishte disi më i ulët dhe rënia ka qenë nga e moderuar, dhe në 2010 niveli arriti në 30%. Në kontrast me këtë, penetrimi i

¹⁴ Vini re se për shkak të përbërjes së grupit – CPC 5, disa nga të dhënat specifike të telekomunikacioneve për shumicën e vendeve disponohen vetëm që prej 2004-s. Të dhënat për Shtetet Anëtare dhe CPC disponohen deri në 2010 nga Eurostat; të dhënat për Shqipërinë për 2011 dhe 2012 janë marrë nga AKEP.

telefonisë fikse në 5 vendet CPC ka qenë i qëndrueshëm gjatë kësaj periudhe, në nivel rreth 28% për 2010 – në këtë tregues ka një tendencë për konvergencë midis grupeve BE-12 dhe CPC drejt penetrimit në nivelin rreth 30%. Shqipëria ka pasur një rritje të qëndrueshme dhe stabilizim gjatë kohëve të fundit në penetrimin e telefonisë fikse, në nivele 10-12% në periudhën 2010-2012.

Figura 4 paraqet kurbën e tendencës që rezulton nga analiza e regresionit me një variabël dhe përfaqëson “përshtatjen më të mirë” statistikore që përshkruan marrëdhënien midis penetrimit të telefonisë fikse dhe të ardhurave kombëtare. Meqenëse pjerrësia e saj ka tendencë rritëse, ajo tregon se përgjithësisht penetrimi i telefonisë fikse rritet me rritjen e të ardhurave kombëtare në përputhje¹⁵ me Figurën 3. Vini re se kurba e tendencës në Figurën 4 ofron një përshtatje të moderuar statistikore – ka njëfarë distance (ndryshim statistikor) midis vrojtimeve dhe kurbës së tendencës. Vendet mbi kurbë kanë penetrim statistikiisht “më të lartë – nga sa pritet” (dhe anasjelltas): vëreni se Shqipëria ndodhet nën kurbën e tendencës.




3.3 Telefonat Publikë me Pagesë

Figura 5 tregon numrin mesatar të telefonave publik me pagesë për 1000 banorë për grupet BE-15, BE-12 dhe CPC 5 si dhe për Shqipërinë nga viti 2000 deri në 2011¹⁶. Figura 6 paraqet grafikun e numrit të telefonave me pagesë për 1000 banorë ndaj të ardhurave kombëtare për 27 vendet e BE-së dhe 9 vendet CPC (përfshirë Shqipërinë) për 2009. Figura 5 tregon një rënie graduale të numrit të telefonave me pagesë përgjatë kësaj periudhe për grupet krahasuese. Vendet BE-15 dhe BE-12 filluan në vitin 2000 me nivele në intervalin midis 2.5 dhe 3.0 telefona për 1000 banorë. Megjithatë, nga fundi i dhjetëvjeçarit, këto shifra pësuan rënie të ndjeshme.

¹⁵ Kjo marrëdhënie penetrimit/ të ardhura kombëtare është e përcaktuar qartë në ekonomiks in e telekomunikacioneve. Duhet theksuar se këto lloje kurbash tendence nuk janë “përcaktuese” (ka variacion nga vendi në vend) dhe ato kapin vetëm një dimension të përcaktuesve kryesorë, por pavarësisht kësaj janë një pikë e mirë fillimi.


¹⁶ Të dhënat për telefonat me pagesë disponohen nga ITU (Eurostat duket se nuk ofron të dhëna për telefonat me pagesë të krahasueshme në shkallë ndërkombëtare). Të dhënat më të fundit të disponueshme nga ITU janë për vitin 2009. Të dhënat për Shqipërinë për vitin 2010 dhe 2011 janë marrë nga AKEP.

Figura #5



Pas një rritjeje fillestare, edhe vlerat për CPC 5 kanë pësuar rënie kohët e fundit. Shqipëria pati një rritje fillestare të telefonave me pagesë, pas së cilës niveli u stabilizua dhe filloi të binte ngadalë në vitet e fundit. Figura 6 tregon një kurbë pothuajse horizontale e cila sugjeron se numri i telefonave me pagesë për 1000 banorë në grupin e marrë si kampion nuk është shumë i lidhur me të ardhurat kombëtare në 2009.

Figura #6



3.4 Shërbimet Celulare

Figura 7 tregon penetrimin mesatar të telefonisë celulare për grupet BE-15, BE-12 dhe CPC-5 si dhe për Shqipërinë nga viti 2000 deri në vitin 2011¹⁷. Figura 8 paraqet grafikun e shpërndarjes së penetrimit të telefonisë celulare dhe të të ardhurave kombëtare për 27 vendet e BE-së dhe 9 vendet CPC (përfshirë Shqipërinë) për 2010.




Figura 7 tregon për një rritje mjaft të ndjeshme të penetrimit të telefonisë celulare gjatë kësaj periudhe për të tre grupet krahasuese dhe Shqipërinë. Vendet BE-15 kishin penetrimin më të lartë të telefonisë celulare duke filluar që prej 2000 (65%), pasuar nga grupi BE-12 (27%) dhe grupi CPC-5 dhe Shqipëria (të dyja nën 5%). Megjithatë, rreth vitit 2010 penetrimi i telefonisë celulare ishte rritur në të gjitha grupet duke rezultuar në një penetrim relativisht të konvergjuar të telefonisë celulare me rreth 130% në 2010. Shqipëria i tejkaloi mesataret rajonale në 2008 duke arritur një penetrim celular prej 187% në Korrik 2012.

Figura 8 paraqet një kurbë horizontale e cila tregon se penetrimi celular në grupin e marrë si kampion është statistikisht i pavarur nga të ardhurat kombëtare në 2010. Kjo përputhet me konvergjencën e penetrimit celular për të gjitha grupet (me të ardhura të ndryshme) në Figurën 7. Në këtë rast, kurba paraqet penetrimin mesatar celular - Shqipëria ishte mbi mesataren rajonale në 2010 dhe akoma më shumë në 2011.

¹⁷ Të dhënat për grupet e Shteteve Anëtare dhe CPC disponohen nga Eurostat deri në vitin 2010; të dhënat për Shqipërinë për 2011 janë nga AKEP.

Figura #8




Figura #9




Figura 9 tregon mbulimin mesatar të popullsisë me telefoni celulare për grupet krahsuese dhe Shqipërinë për periudhën 2000-2010 dhe ajo paraqet një konvergjencë në 2010 në nivel mbulimi pothuajse universal të popullsisë. Ky tregues ishte mbi 99.8% në Shqipëri për vitin 2011, me një numër të vogël Komunash/Fshatrash të pambuluara.¹⁸

¹⁸ Niveli më i lartë administrativ në Shqipëri është Prefektura, ku gjithsej janë 12. Këto Prefektura përfshijnë 36 rrethe. Këto rrethe përfshijnë 373 Komuna, disa prej të cilave konsiderohen qytete. Komunitat jo-qytete përfshijnë 2980 Fshatra. Më poshtë jepen njësitë që nuk mbulohen nga operatorët në Shqipëri (pa specifikuar emra të operatorëve) për 2011: Operatori #1 = 10 njësi; Operatori #2 = 56 Fshatra; Operatori #3 = 130 Fshatra; Operatori #4 = 5 Komuna.

3.5 Shërbimet me Brez të Gjerë (Broadband)

Figura 10 paraqet penetrimin mesatar broadband fiks për grupet BE-15, BE-12 dhe CPC-5 si dhe për Shqipërinë nga 2004 deri në 2011 dhe reflekton rritje të ndjeshme të penetrimit broadband fiks përgjatë kësaj periudhe. Shqipëria ka arritur një penetrim broadband fiks prej 5.3% në Korrik 2012.

Figura #10




Figura #11




Figura 11 paraqet grafikun e marrëdhënies midis penetrimit broadband fiks dhe të ardhurave kombëtare për 27 vendet e BE-së dhe 9 vendet CPC (përfshirë Shqipërinë) për 2010 ku kurba e tendencës ka pjerrësi për lart e cila tregon se penetrimi broadband fiks përgjithësisht rritet me rritjen e të ardhurave kombëtare, në përputhje me Figurën 8. Kurba e tendencës në Figurën 11 ofron një përshtatje relativisht të fortë statistikore – ka relativisht pak distancë (ndryshim statistikor) midis vrojtimeve dhe kurbës së tendencës – që tregon se të ardhurat


janë një faktor i fuqishëm përcaktues për penetrimin broadband fiks. Për këtë arsye, Shqipëria ndodhet nën kurbën e tendencës për 2010.

Tabela 1 përmban penetrimin broadband celular (karta të dedikuara të shërbimit të të dhënave/modema/çelësa) për vendet e BE-15, BE-12 dhe CPC-5 si dhe për Shqipërinë për vitin më të fundit të disponueshëm, 2011¹⁹. Në ngjashmëri me broadband fiks, penetrimi broadband celular është më i lartë në BE-15, i ndjekur nga vendet e BE-12, vendet CPC-5 dhe Shqipëria. Në Korrik 2012, Shqipëria arriti penetrim broadband celular prej 1.3%.

Tabela 1: Penetrimi Broadband Celular (2011)	
BE-15	11.0%
BE-12	5.0%
CPC-5	3.4%
Shqipëria	1.2%

Figura 12 paraqet grafikun e marrëdhënies midis penetrimit broadband celular dhe të ardhurave kombëtare për 27 vendet e BE-së dhe 9 vendet CPC (përfshirë Shqipërinë). Kurba e tendencës në Figurën 12 është një përshtatje statistikore relativisht më e dobët se ajo në Figurën 11, duke treguar se, në raport me të ardhurat, penetrimi broadband celular ka më shumë variacion se sa penetrimi broadband fiks. Për këtë arsye, Shqipëria ndodhet vetëm pak më poshtë kurbës së tendencës për 2011.

Figura #12



¹⁹ Të dhënat për vendet e BE nga Eurostat. Të dhënat për CPC nga “Raporti 2 – Ofrimi i shërbimeve në monitorimin e zhvillimeve rregullatore dhe të tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve të shoqërisë së informacionit në Vendet e Zgjerimit - 2011-2013: ANEKS I – Të dhëna krahasuese midis vendeve” nga Cullen International, Korrik 2012” (“Raporti Cullen”), i autorizuar nga KE. Të dhënat historike para 2009 përgjithësisht nuk disponohen për të gjitha vendet.

3.6 Të Ardhurat e Sektorit

Figura 13 paraqet të ardhurat mesatare nga fusha e telekomunikacioneve si përqindje e PBB-së për grupet e BE-15, BE-12 dhe CPC-5 dhe Shqipërinë nga viti 2000 deri në vitin 2011. Figura 13 tregon se të ardhurat nga telekomunikacionet në raport me PBB kombëtare, kanë pësuar rënie të lehtë gjatë kësaj periudhe në vendet e BE-15 dhe BE-12, me vlera midis 3%-4% të PBB, respektivisht. Vlerat korresponduese në vendet CPC-5 dhe Shqipëri janë relativisht më të mëdha, por të cilat kanë pësuar gjithashtu rënie, duke arritur kohët e fundit me rreth 4% deri në 5% të PBB²⁰ përkatëse.

Figura #13





Figura #14



²⁰ Kjo lloj performance diferencuese midis BE-15 dhe BE-12 (vendet me popullsi më të madhe dhe të ardhura të mesme dhe më të larta) kundrejt CPC-5 dhe Shqipërisë (vende me popullsi më të vogël dhe të ardhura më të ulëta) nuk është e pazakontë në botë.

Figura 14 paraqet strukturën në përqindje të të ardhurave totale nga telekomunikacionet për vendet e BE-12 dhe Shqipërinë të ndarë në të ardhurat nga telefonia celulare, fikse dhe Interneti. Figura 14 tregon se të ardhurat nga telefonia celulare i kanë tejkaluar të ardhurat nga telefonia fikse në 12 vendet e BE-së në 2001. Mbasi arritën në 40% në vitin 2000, të ardhurat nga telefonia celulare arritën në rreth 60% të të ardhurave totale në 2009 për 12 vendet e BE-së. Në raport me të ardhurat totale, të ardhurat nga telefonia fikse për 12 vendet e BE-së kanë pësuar rënie nga rreth 55% në rreth 25% në 2009. Të ardhurat nga Interneti janë rritur duke arritur në rreth 15% në 2009. Në përputhje me diskutimin e mësipërm, Figura 14 tregon se të ardhurat nga telefonia celulare në Shqipëri, me rreth 75% të të ardhurave totale të sektorit, janë relativisht shumë më të larta se në vendet e BE-12, ndërsa të ardhurat përkatësisht nga telefonia fikse dhe interneti janë më të ulëta.

3.7 Ribalancimi i Tarifave

Siç u diskutua edhe në Kapitullin 2, Shqipëria nuk e ka përfunduar procesin e ribalancimit²¹. Figura 15 tregon se çmimi i pajtimtarëve familjarë fikse përgjithësisht ka pësuar rritje gjatë periudhës 2000-2012²². Tarifa e BE-15 është rritur në 16 Euro në 2010, ku pjesa më e madhe e ribalancimit ka ndodhur përpara vitit 2000, në përputhje me udhëzimet e BE-së të diskutuara në Kapitullin 2. Tarifa në vendet e BE-12 është rritur duke arritur në rreth 10 Euro në 2010. Këto tarifa kanë pësuar rritje edhe në Grupin e CPC-5 dhe Shqipëri, duke arritur në rreth 7 Euro dhe 4 Euro në 2012, të cilat janë ende më të ulëta se mesataret e grupeve BE-15 dhe BE-12.




Figura 16 tregon se çmimi i tarifave mujore fikse për bizneset ka pësuar gjithashtu rritje gjatë periudhës 2000-2012. Tarifa mesatare për BE-15 dhe BE-12 është rritur për të arritur në përkatësisht 18 Euro dhe 14 Euro në 2010. Këto tarifa janë rritur edhe në Grupin e CPC-5 dhe

²¹ Për shkurtime, ky seksion përmban vetëm çmimin e pajtimit mujor. Komponentët e tjerë të ribalancimit do të dëshmonin për një rritje të tarifave të thirrjeve lokale dhe rënie të tarifave të thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

²² Të dhënat e ITU për Figurat 14 & 15 për Shtetet Anëtare disponohen deri në 2010. Të dhënat për Shqipërinë/CPC për 2011-12 vijnë nga AKEP dhe Raporti i Cullen.

Shqipëri, veçanërisht gjatë viteve të fundit, duke arritur në rreth 8 Euro dhe 11 Euro në 2012. Këto vlera janë relativisht më afër mesatareve të BE-15 dhe BE-12, duke sugjeruar se Shqipëria ka bërë më shumë progress në ribalancimin e tarifave mujore të pajtimtarëve të biznesit sesa të atyre familjare.

Figura #16




Tabela 2 paraqet situatën për Mars 2012 në lidhje me tarifën mujore standarde për pajtimtarët familjarë dhe biznes, të marra nga Raporti i Cullen. Tabela 2 mbështet diskutimin e mësipërm se me gjithë rritjet e 2010, tarifa mujore prej 3.79 Euro për pajtimtarët familjarë në Shqipëri është pothuajse sa gjysma e mesatares se CPC-5 (€8.86), ndërsa tarifa prej 11.43 Euro për bizneset është mbi mesataren (€8.09).

	Familjare Standard (€)	Biznes (€)	Biznes si % Familjare Standard
Serbia	4.59	3.89	85%
Bosnia Herzegovina	6.73	8.39	125%
Mal i Zi	5.97	5.10	85%
Maqedonia	7.66	5.10	67%
Kosova	9.36	17.99	192%
Mesatarja CPC-5	6.86	8.09	111%
Shqipëria	3.79	11.43	302%

3.8 Penetrimi Fiks në Shqipëri në Nivel Prefekturë


Ky seksion ofron të dhëna për penetrimin e telefonisë fikse dhe analiza në nivel nën-kombëtar për Shqipërinë. Niveli më i lartë administrativ në Shqipëri është prefektura, ku

gjithsej janë 12. Figurat 17 deri në 20 paraqesin të dhëna për rrjetin fiks në nivel prefekturë për 2011²³, përfshirë popullsinë urbane dhe rurale²⁴.

Figura 17 paraqet grafikun e marrëdhënies midis penetrimit të telefonisë fikse dhe PBB të e prefekturave për të 12 prefekturat në Shqipëri për vitin 2011. Figura 17 tregon se ka ndryshime të ndjeshme midis prefekturave në lidhje me penetrimin e telefonisë fikse dhe të ardhurave të prefekturës. Ashtu si në grafikët e tjerë të marrëdhënies së penetrimit me të ardhurat të cilët janë paraqitur në seksionet e mëparshme, Figura 17 paraqet një kurbë me pjerrësi për lart e cila tregon se penetrimi i telefonisë fikse në nivel prefekturë rritet me rritjen e të ardhurave të prefekturës. Megjithatë, përshtatja statistikore e kurbës në Figurën 17 është relativisht e dobët, që reflektohet në distancat e ndjeshme të pikave nga kurba e tendencës.

Figura 18 paraqet grafikun e shpërndarjes së penetrimit të broadband fiks dhe PBB-në e prefekturave për të 12 prefekturat në Shqipëri për vitin 2011 dhe një kurbë tendence me pjerrësi për lart me një përshtatje relativisht të fortë statistikore (krahasuar me Figurën 17).

Figura #17



²³ Të dhënat e penetrimit për shërbimet celulare, përfshirë broadband, nuk janë të disponueshme në nivel prefekturë. Të dhënat për linjat e aksesit për 2011 janë nga AKEP, të dhëna për popullsinë e 2011 nga INSTAT (të dhëna paraprake të Censurit), të dhënat e PBB-së për 2009 sipas prefekturave janë nga INSTAT.

²⁴ Shqipëria ka një normë relativisht të lartë të popullsisë rurale, me 46% për 2011. Për krahasim, norma mesatare e popullsisë rurale të 27 vendeve të BE-së ishte 23% në 2011.

Figura #18




Figura 19 paraqet analizën grafike të marrëdhënies midis penetrimit të telefonisë fikse në zonat urbane dhe penetrimit të telefonisë fikse në zonat rurale sipas prefekturave për 2011. Figura 19 përmban gjithashtu “vijën e barazisë” e cila do të rezultonte nëse penetrimi fiks në zonat urbane do të ishte i njëjtë me penetrimin fiks në zonat rurale. Figura 19 paraqet një korrelacion pozitiv relativisht të dobët midis penetrimit fiks urban dhe penetrimit fiks rural. Të gjitha prefekturat kanë penetrim fiks më të lartë në zonat urbane se në zonat rurale – që do të thotë se, ato janë mbi vijën e barazisë (kurba e tendencës për penetrimin urban dhe rural ndodhet gjithashtu mbi vijën e barazisë). Figura 19 tregon se penetrimi fiks urban për të gjithë Shqipërinë (19.8%) është rreth 11 herë më i lartë se penetrimi fiks rural (1.7%). Ky raport tregon të jetë më i lartë në prefekturat me të ardhura më të ulëta të cilat kanë penetrim fiks rural më të ulët (p.sh. Dibër, Kukës, Lezhë, etj.). Këto ndryshime në penetrim janë në përputhje me ndryshimet administrative në nivel kombëtare në shumë vende të tjera me penetrim fiks relativisht të ulët dhe popullsi rurale relativisht të lartë.

Figura #19




Figura #20




Figura 20 paraqet analizën grafike të marrëdhënies midis penetrimit të broadband-it fiks në zonat urbane dhe penetrimit të broadband-it fiks në zonat rurale sipas prefekturave për 2011 si dhe “vijën korresponduese. Virtualisht, Figura 20 nuk paraqet asnjë korrelacion statistikor midis penetrimit të broadband-it fiks në zonat urbane dhe penetrimit të broadband-it fiks në zonat rurale. Të gjitha prefekturat kanë penetrim broadband fiks më të lartë në zonat urbane se në zonat rurale – që do të thotë se, ato janë mbi vijën e barazisë (kurba e tendencës për penetrimin e broadband-it urban dhe rural ndodhet gjithashtu mbi vijën e barazisë). Penetrimi broadband fiks urban për të gjithë Shqipërinë (7.7%) është rreth 25 herë më i lartë se penetrimi broadband fiks rural (0.3%).

Ky raport tenton të jetë më i lartë në prefekturat me të ardhura më të ulëta të cilat kanë penetrim broadband fiks rural më të ulët (p.sh. Dibër, Kukës, Lezhë, Fier, Elbasan etj.). Këto ndryshime në penetrim janë më të mëdha se ato që mbizotërojnë në tregun e telefonisë fikse, ndoshta sepse broadband-i fiks është një shërbim relativisht më i ri dhe është shumë më tepër i lidhur me të ardhurat.

3.9 Diskutim

Ky Kapitull ofroi një panoramë të përgjithshme mbi zhvillimet dhe statusin e sektorit nga një perspektivë rajonale, duke u fokusuar në Vendet Anëtare të BE-së dhe vendet CPC siç është përcaktuar nga KE, si dhe në të dhënat dhe analizat në nivel nën-kombëtar për Shqipërinë. Konkluzionet kryesore janë:

- Penetrimi i telefonisë fikse ka pësuar rënie në të gjithë BE-në dhe rritje në vendet CPC dhe Shqipëri. Megjithatë, penetrimi i telefonisë fikse në Shqipëri mbetet shumë herë më i ulët se mesataret e BE-së dhe Ballkanit. Një pjesë e këtij “hendeku” mund të shpjegohet nga të ardhurat më të ulëta kombëtare të Shqipërisë. Një tjetër shpjegim i mundshëm mund të jetë penetrimi relativisht i lartë celular. Të ardhurat nga telefonia

fikse në Shqipëri përbëjnë një pjesë më të vogël të të ardhurave totale të sektorit krahasuar me mesataret e BE-së.

- Penetrimi i telefonave me pagesë ka pësuar rënie në vendet e BE-së dhe në 5 vendet e CPC, ndërsa ka pësuar rritje të lehtë në Shqipëri. Penetrimi i telefonave me pagesë në Shqipëri mbetet nën mesataret e BE-së dhe CPC-5. Një pjesë e këtij “hendeku” mund të shpjegohet nga të ardhurat më të ulëta kombëtare të Shqipërisë. Një tjetër shpjegim i mundshëm mund të jetë penetrimi relativisht i lartë celular.
- Penetrimi celular ka pësuar rritje në vendet e BE-së, CPC dhe Shqipëri duke konverguar në një nivel “ngopjeje” që me sa duket është i pavarur nga të ardhurat kombëtare. Mbulimi i popullsisë ka konverguar gjithashtu midis 99% dhe 100%, përfshirë Shqipërinë. Të ardhurat nga telefonia celulare në Shqipëri përbëjnë një pjesë më të madhe të të ardhurave totale të sektorit krahasuar me mesataret e BE-së.
- Penetrimi broadband fiks është rritur në vendet e BE-së, CPC dhe Shqipëri. Megjithatë, penetrimi broadband fiks mbetet ende shumë poshtë mesatareve të BE-së dhe Ballkanit. Një pjesë e këtij “hendeku” mund të shpjegohet nga të ardhurat më të ulëta kombëtare të Shqipërisë. Të ardhurat nga broadband-i fiks në Shqipëri përbëjnë vetëm një pjesë të vogël të të ardhurave totale të sektorit krahasuar me mesataret e BE-së.
- Ka pasur ribalancim të konsiderueshëm në vendet e BE-së dhe CPC. Pjesa më e madhe e procesit të ribalancimit në 15 shtetet e BE-së ka ndodhur para vitit 2000. Vendet e BE-12 dhe CPC-5 dhe Shqipëria kanë bërë më shumë progress në ribalancimin e tarifave të pajtimatrëve të biznesit sesa të pajtimtarëve familjare. Pajtimi familjar fiks në Shqipëri është sa gjysma e tarifës në CPC-5 dhe më pak se një e treta apo çereku i tarifave të BE-12 dhe BE-15.
- Marrëdhëniet në nivel rajonal midis telefonisë fikse, broadband fiks dhe të ardhurave që rezultojnë në vendet e krahasuara reflektohen gjithashtu edhe në nivel nën-kombëtar (prefekturë) në Shqipëri: penetrimi fiks dhe penetrimi broadband fiks tentojnë të jenë më të larta në prefekturat me të ardhura më të larta.
- Penetrimi fiks dhe penetrimi broadband fiks në Shqipëri në zonat urbane janë shumë më të larta se në zonat rurale. Ky raport tenton të jetë më i lartë në prefekturat me të ardhura më të ulëta të cilat kanë penetrim relativisht të ulët. Këto ndryshime në penetrim janë në përputhje më ndryshimet administrative në nivel nën –kombëtar në shumë vende të tjera me penetrim relativisht të ulët dhe popullsi rurale relativisht të lartë.

Pyetje #2: Ju lutem jepni komentet tuaja mbi këtë kapitull në përgjithësi dhe mbi këtë Seksion diskutimi në mënyrë specifike. A ka të dhëna, studime apo konkluzione të tjera në lidhje me statusin dhe zhvillimet e sektorit të cilat AKEP duhet t'i marrë parasysh në analizën e tij?

4 Shërbimi Universal në Praktikë

DSHU ofron fleksibilitet të madh për Shtetet Anëtare për të hartuar dhe zbatuar shërbimin universal bazuar në kushtet kombëtare. Ky kapitull ofron një përmbledhje të përgjithshme se si Vendet Anëtare dhe vendet CPC kanë zbatuar DSHU në praktikë²⁵.

4.1 Caktimi i Sipërmarrësve

4.1.1 BE-27

Shumë nga Vendet Anëtare kanë caktuar sipërmarrësit – Ofrues i Shërbimit Universal ("OSHU") - për të kryer disa ose të gjithë elementet e detyrimeve të shërbimit universal të përcaktuara në DSHU. Megjithatë, një numër i vogël Vendesh Anëtare, kryesisht në grupin e BE-15 (p.sh. Gjermania, Suedia dhe Italia, etj), nuk kanë caktuar asnjë sipërmarrës për ndonjë element të shërbimit universal. Në disa raste të tilla një mungesë e caktimit (ose heqja e një caktimi të mëparshëm) bazohet në përfundimin e Rregullatorit Kombëtar se të katër elementet e shërbimit universal janë duke u ofruar në kushtet e tregut dhe për këtë arsye nuk është e nevojshme caktimi i ndonjë sipërmarrësi për ofrimin e tyre. Në disa raste të tjera (p.sh. Itali), ndërsa Autoriteti Rregullator Kombëtar nuk ka bërë asnjë caktim zyrtar, sipërmarrësi incumbent, më parë kompani shtetërore, ka vazhduar të ofrojë disa elemente të detyrimeve të shërbimit universal bazuar në rregullime informale. Kohëzgjatja e caktimeve ekzistuese të Ofruesve të Shërbimit Universal ndryshon në mënyrë të konsiderueshme, nga tre dhe pesë vjet në dhjetë apo edhe tridhjetë vjet.

4.1.2 CPC-9

Deri më sot, rreth gjysma e vendeve të CPC kanë kryer caktime të Ofruesit të Shërbimit Universal në linjë me DSHU:

- Në **Kroaci**, caktimi fillestar prej 5 vjet i operatorit incumbent të mëparshëm është kryer me nominim. Pas skadimit të afatit në 2010, Autoriteti Kombëtar Rregullator zgjodhi opsionin e procesit të tenderit, për të cilin një operator aplikoi dhe i'u dha elementi i numeratorit. Për elementët e tjerë të USO nuk pati aplikime, kështu që Autoriteti Kombëtar Rregullator nominoi operatorin me FNT (ish incumbent) si Ofrues i Shërbimit Universal për të gjithë elementët e tjerë të USO për një periudhë 5 vjeçare (akses nga vendndodhje fikse, Shërbimi i Kërkimit të Informacionit në Numerator, tarifa Sociale etj.). Ky ofrues i shërbimit universal përgatiti system tarifor të veçantë të përshtatur për nevojat e grupeve të përdoruesve fundore më dizavantazhe sociale, duke përfshirë një paketë tarifore të veçantë për personat me të ardhura të ulëta, e cila u miratua nga Autoriteti Kombëtar Rregullator.
- Në **Islandë**, Autoriteti Kombëtar Rregullator pas një procedure konsultimi, bëri caktime tre-vjeçare në 2007 për elementët e mëposhtëm të USO: a) akses funksional në Internet dhe telefona publikë me pagesë; b) lidhje në vendndodhje fikse, c) Numeratori dhe Shërbimet e Kërkimit të Informacionit në Numerator.
- Në **Mal të Zi**, bazuar në një proces tenderi publik, Autoriteti Kombëtar Rregullator në 2011 ndërmorri caktime pesë-vjeçare të dy ofruesve të ndryshëm të shërbimit

²⁵ Ky kapitull bazohet në studimin e kryer nga AKEP si edhe në Komunikimin e Nëntor 2011 të KE dhe dokumentin "Raport i BEREC mbi Shërbimin Univesal – reflektime për të ardhmen (Qershor 2010)"

universal për elementët e mëposhtëm të USO: a) për lidhje dhe akses nga vendndodhje fikse, duke përfshirë akses funksional në Internet; dhe b) Numeratori dhe Shërbimet e Kërkimit të Informacionit në Numerator. Për rastin e telefonave publikë me pagesë, nuk kishte aplikim në tenderin përkatës dhe në këtë mënyrë nuk u caktua asnjë ofrues shërbimi universal për këtë element.

- Në **FYROM (Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë)**, Autoriteti Kombëtar Rregullator në 2011, bazuar në një proces tenderi publik, bëri caktime pesë-vjeçare të dy ofruesve të ndryshëm të shërbimit universal për elementët e mëposhtëm të USO: a) Numeratori dhe Shërbimet e Kërkimit të Informacionit në Numerator, dhe b) të gjithë elementët e tjerë të USO.

Në vendet e tjera (Kosovë, Shqipëri, Serbi, Turqi, Bosnja dhe Herzegovina) nuk ka pasur caktime apo vendsoje detyrimesh në licensa apo koncesione. Shqipëria nuk ka caktuar ndonjë ofrues të shërbimit universal në përputhje me Ligjin 9918.

Kohëzgjatja e caktimeve të ofruesve ekzistues të shërbimit universal në vendet e CPS-9, ku është e aplikueshme, përgjithësisht është më e shkurtër se në vendet e BE, dhe shumë prej tyre janë midis tre dhe pesë viteve.

4.2 Forma e Caktimit

4.2.1 BE-27

Midis grupeve BE-15 dhe BE-12 ka një dallim të madh për sa përket formës më të zakonshme të caktimit. Nga ato vende që kanë caktuar të paktën një OSHU:

- Shumica e vendeve të BE-15 kanë caktuar një OSHU të vetme për të ofruar të gjitha elementet e detyrimit të SHU. Ky sipërmarrës është zakonisht operatori fiks inkumbent kombëtar. Ky sipërmarrës ka qenë përgjithësisht i caktuar në bazë të një procesi të emërimit ose nëpërmjet legjislacionit, ose nëpërmjet një vendimi të AKR pas një procedure të konsultimit publik.
- Në shumë vende të BE-12, janë caktuar OSHU të ndryshëm në lidhje me elemente të ndryshëm të detyrimit të SHU. Në këto vende, këto përcaktime kanë tentuar të jenë të bazuara në procese tenderash publike për secilin prej elementëve përkatës të detyrimit të SHU.

4.2.2 CPC-9

Katër vende të CPC-9 kanë kryer caktimet e OSHU në përputhje me DSHU. Në dy vende janë përcaktuar OSHU të ndryshme në lidhje me elemente të ndryshëm të USO dhe caktimi ka tentuar të jetë i bazuar në procese tenderi publik për secilin prej elementëve përkatës të detyrimit të SHU. Në Kroaci dhe Islandë përcaktimet janë kryer me procedura të emërimit.

4.3 Elementët e përcaktuar të detyrimit të SHU

4.3.1 BE-27

Në ato vende ku nuk është caktuar asnjë OSHU nuk ka pasur as përcaktim të ndonjë elementi të detyrimit të SHU. (p.sh. Gjermania, Suedia dhe Italia, etj.) Në ato vende ku të paktën është caktuar një OSHU, shumica e Vendeve Anëtare kanë caktuar të katër elementët e detyrimit të

SHU. Asnjë Vend Anëtar nuk ka përcaktuar aksesin broadband si një element të detyrimeve të SHU.

Aksesi në vendndodhje fikse vazhdon të jetë elementi i përcaktuar më shpesh ndër elementët e detyrimit të SHU nga vendet anëtare. Me përjashtim të atyre që nuk kanë ndërmarrë ndonjë proces caktimi, shumica e vendeve të BE-15 i kanë dhënë efekt praktik këtij përcaktimi bazuar në mbulimin shumë të madh të rrjetit fiks inkumbent.

Në të kundërt, një pakicë e konsiderueshme e vendeve të BE-12 kanë bërë përcaktimet përkatëse bazuar në kushtet e tyre specifike kombëtare (të ndryshme nga ato të BE-15) dhe në veçanti, bazuar në diferencat në mbulim të rrjeteve celulare dhe fikse (shih Kapitullin 3).

Në mënyrë të veçantë, Republika Çeke dhe Rumania janë dy vende të BE-së 12 që kanë përcaktuar se disa shërbime të ofruara nga rrjetet celulare plotësojnë edhe kriteret e elementit të detyrimit të SHU, akses dhe shërbim nga vendndodhje fikse. Në këto vende të BE-12 ky element i detyrimit të SHU nuk u përcaktua (për shkak se ai është i disponueshëm në kushtet e tregut) ose një operator celular u caktua si OSHU për një element të tillë të përcaktuar të detyrimit të SHU, siç detajohet më poshtë:

- Në rishikimin e saj të përcaktimit të detyrimit të SHU në vitin 2006 Autoriteti Kombëtar Rregullator i **Republikës Çeke** mori vendim që të ndërpriste elementin e aksesit nga vendndodhje fikse të detyrimit të SHU. Ky vendim u bazua në një analizë të hollësishme të kryer në kuadrin e një procesi të konsultimit publik dhe përfshinte konsideratat e mëposhtme:
 - Autoriteti Kombëtar Rregullator ndërmori një analizë të tregut të segmenteve fikse dhe celulare nga viti 2004 deri në mesin e vitit 2006 dhe vuri në dukje se a) kishte shumë më tepër abonime celulare se fikse; b) abonimet në rrjet fiks vazhduan të binin gjatë periudhës, ndërsa abonimet celulare u rritën (rënia ishte tregues i një rënie të interesit dhe në kombinim, dëshmi e një efekti i zëvendësimit të fortë të fiksit me celular), dhe: c) rrjetet celulare ofronin 98% mbulim gjeografik dhe 99% mbulim të popullsisë.
 - Autoriteti Kombëtar Rregullator gjithashtu shqyrtoi tendencën për aplikimet në pritje për lidhjet fikse nga viti në të cilën ishte caktuar OSHU (2002) deri në kohën aktuale. Në shqyrtimin e këtyre të dhënave, Autoriteti Kombëtar Rregullator arriti në përfundimin se, më së fundi, vetëm 18 raste të tilla nuk mund të plotësoheshin nëpërmjet një lidhje fikse pa tela GSM ("FGSM") (në krahasim me 172 për vitin e mëprshëm).
 - Në këtë kontekst, Autoriteti Kombëtar Rregullator vendosi se lidhje të tilla FGSM, të cilat janë gjerësisht të disponueshme dhe të ofruara nga operatorët individualë celularë, plotësojnë detyrimin e SHU lidhur me parametrat për akses nga vendndodhje fikse, përfshirë dhe aksesin funksional në lidhje në Internet.
 - Së fundi, Autoriteti Kombëtar Rregullator vuri në dukje se si një masë plotësuese, ai ishte duke vazhduar vendosjen e një elementi të detyrimit të SHU të çmimeve speciale me zbritje për përfitues të caktuar (Tarifat Sociale).

- **Rumania** ka reformuar kohët e fundit regjimin e saj të shërbimit universal me objektivin për të qenë në përputhje me BE më 31 Dhjetor 2012. Nën regjimin e ri, dhe duke pasur parasysh kushtet kombëtare në Rumani (duke përfshirë penetrimin fikse dhe celularë dhe mbulimin e popullsisë), Autoriteti Kombëtar Rregullator ka vendosur që të ashtuquajturat produkte "home zone" të ofruara nga operatorët celularë duhet gjithashtu të konsiderohen se përmbushin kriteret e elementit akses nga vendndodhje fikse të detyrimit të SHU. Me rrjetet celulare që mbulojnë afërsisht 100% të popullsisë kombëtare, kjo qasje adresoi sfidën e mbulimit relativisht më të kufizuar të rrjeteve fikse. Prandaj, sfida do të jetë për të financuar aksesin në ato shumë pak vendndodhje pa mbulimin celular.

Tarifat me zbritje për grupe të veçanta (me të ardhura të ulëta, aftësi të kufizuar, pensionistët, etj) janë zbatuar në rreth dhjetë Vende Anëtare.

Në një pjesë shumë të vogël të vendeve anëtare ku është caktuar të paktën një OSHU, janë përjashtuar disa elementë të tjerë të detyrimit të SHU (në këto raste nuk është caktuar asnjë OSHU):

- **Telefonat publike me pagesë** nuk janë përfshirë si një element i detyrimit të SHU në rreth gjashtë Vende Anëtare. Në shumë nga këto raste Autoriteti Rregullator Kombëtar përkatës ka marrë vendim se përfshirja e këtij elementi të detyrimit të SHU nuk është më proporcional apo efikas për shkak të rënies së përdorimit të tyre si pasojë e mbulimit dhe disponueshmërisë të gjerë të telefonave celularë.
- **Numeratori/ Shërbimet e Kërkimit të Informacionit në Numerator** nuk është përfshirë si një element i detyrimit të SHU në rreth gjashtë Vende Anëtare. Në shumicën e këtyre rasteve Autoriteti Rregullator Kombëtar përkatës ka bërë një përcaktim që shërbimet e tilla janë duke u siguruar në mënyrë adekuate në kushtet e tregut dhe për këtë arsye nuk do të ishte më e përshtatshme që ato të përfshihen si një element i detyrimit të SHU.

4.3.2 CPC-9

Në ato katër vende të CPC që kanë kryer caktime të OSHU në përputhje me DSHU, qasja më e zakonshme ka qenë përcaktimi i të katër elementëve të detyrimit të SHU.

Aksesi në vendndodhje fikse vazhdon të jetë elementi i përcaktuar më shpesh ndër katër vendet e CPC që janë në përputhje me DSHU. Për tu përmendur ndër këto vende është Mali i Zi, i cili ka vendosur që disa shërbime të ofruara nga rrjetet celulare plotësojnë edhe kriteret e elementit akses dhe shërbim nga vendndodhje fikse të detyrimit të SHU, dhe kështu ka caktuar një operator celular si OSHU për këtë element të detyrimit të SHU. Siç është detajuar më poshtë, efekti i një përcaktimi të tillë ishte për të zgjeruar ofrimin e shërbimeve të tilla fikse-pa tela në kontekstin e detyrimit të SHU. Kjo është në kontrast me Republikën Çeke dhe Rumaninë, ku disponueshmëria në treg e shërbimeve të tilla fikse-pa tela është përdorur si një element për të kufizuar fushën e detyrimit të SHU.

- Në vitin 2011, Autoriteti Kombëtar Rregullator i **Malit të Zi** ndërmori një proces tenderimi publik për të bërë një përcaktim pesë-vjeçar të ofruesit të shërbimit universal për elementet e përcaktuar të detyrimit të SHU, duke përfshirë lidhjen dhe aksesin nga vendndodhje fikse, përfshirë akses funksional në Internet. Para procesit të tenderit, Autoriteti Kombëtar Rregullator kishte vendosur që ky element detyrimit të

SHU mund të sigurohej nga teknologjitë fikse ose celulare për aq kohë sa shërbimi i ofruar plotëson parametrat e përcaktuara në legjislacionin përkatës. Ofruesit e SHU do të kenë të drejtë të kërkojnë kompensim nga fondi i SHU bazuar në dispozitat specifike në rregulloret përkatëse.

- Ofertuesi fitues ishte një nga operatorët vendas celularë dhe caktimi i tij i kërkon operatorit që të përmbushë të gjitha kërkesat e arsyeshme, pavarësisht nga vendndodhja gjeografike, për një lidhje në shërbimin e përcaktuar (fikse-pa tel), duke përfshirë paketë Tarifore Sociale. Kjo Tarifë Sociale është e disponueshme vetëm për përdorues të përcaktuar me të ardhura të ulëta ose me aftësi të kufizuara të cilët demonstronë nëpërmjet një formulari aplikimi që ata përmbushin kriteret e veçanta, duke përfshirë edhe miratimin nga autoriteti përkatës qeveritar.
- Ndërsa përcaktimi është kombëtare, interesi më i madh pritet të jetë në zonat rurale dhe zona të tjera tradicionale me penetrim të ulët fikse. Autoriteti Kombëtar Rregullator ka përcaktuar si kërkesë "të arsyeshme" një kërkesë, ku kostoja e lidhjes së re për OSHU nuk është më shumë se njëzet herë më e lartë se tarifa e përcaktuar standarde e lidhjes prej 55,55 €
- Përcaktimi përfshin parametrat e çmimeve për OSHU, duke përfshirë paketën standarde dhe Tarifat Sociale. Respektivisht, tarifa për lidhjen është €55,55 dhe 25,00 € tarifa mujore është €6,79 dhe €4,00. Tarifat e thirrjeve të Paketës Sociale janë 20% më të lira se ato të paketës standarde. Për tu përmendur është fakti se tarifat mujore janë disi më të larta se ato të ofruara nga operatori incumbent për paketat standarde dhe me përdorim të ulët (€5,97 dhe 3,04 €) (siç është përcaktuar në Tabelën 6).
- Parametrat e cilësisë së shërbimit për OSHU për shërbimin e caktuar përfshijnë një shpejtësi të garantuar Interneti prej 144 kbit /s, bazuar në dispozitat e rregulloreve përkatëse.

Në lidhje me elementet e tjera të mundshme, për shembull, në Kroaci dhe Islandë ka Numerator/ Shërbim të Kërkimit të Informacionit në Numerator, ndërsa në Mal të Zi dhe Maqedoni shërbime të tilla pritet të jenë të disponueshme në periudhë afatmesme, si rezultat i caktimit të ofruesve të tyre në 2011. Në Kosovë, Shqipëri, Serbi, Turqi apo Bosnjë dhe Hercegovinë nuk ka Numerator/ Shërbim të Kërkimit të Informacionit në Numerator.

4.4 Kërkesat për Kompensim

4.4.1 BE-27

Në rreth të Vende Anëtare, ofruesi (ofruesit) i zgjedhur i shërbimit universal nuk ka kërkuar kompensim për koston e tij neto të detyrimit të SHU. Për ato Vende Anëtare me proces emërimi të ofruesit, kjo mund të jetë për shkak të një numri arsyesh, duke përfshirë një vlerësim nga OSHU se nuk ekziston mekanizmi për të bërë efektive kërkesën e kompensimit, pritshmëri që kostoja e tij neto nuk është materiale ose nuk përbën një barrë të padrejtë ose që kërkesa nuk do të jetë e suksesshme. Në ato Vende Anëtare ku caktimi është i bazuar në një proces të tenderit publik, mund të jetë për shkak se procesi i tenderit nuk ka përfshirë një komponent subvencionimi që do të duhet të kompensohet.

Në vende të tjera anëtare, OSHU e caktuar ka kërkuar kompensim (për shembull në Mbretërinë e Bashkuar), por Autoriteti Kombëtar Rregullator ka mohuar kompensimin për shkak se ai ka konstatuar se nuk ekziston një kosto neto për detyrimin të SHU (duke marrë parasysh përfitimet e paprekshme), ose në qoftë se të tilla kosto neto të detyrimit të SHU do të ekzistonin, ato nuk do përbënin një barrë të padrejtë për OSHU.

Në vende të tjera anëtare, procesi i lidhur me kërkesën për kompensim nga OSHU ka qenë komplekse, shpesh janë dashur disa vjet për ta zbatuar ose nuk është zbatuar. Më tej, vonesat administrative, procedurat gjyqësore (të iniciuar nga i ofruesi i zgjedur i shërbimit universal ose nga sipërmarrës që kontribuojnë) dhe /ose mungesa e mekanizmave të kompensimit (fonde publike ose mekanizma të kontributit të sektorit) kanë vonuar apo penguar procesin. Për shembull:

- Në **Bullgari** legjislacioni parashikonte që OSHU mund të kërkonte kompensim vetëm nëse kishte një pjesë tregu prej më pak se 80%. Kjo dispozitë shkaktoi një apel të suksesshme gjyqësore nga OSHU në KE, e cila i kërkoi Bullgarisë shfuqizimin e dispozitës në vitin 2011, pasi ishte në kundërshtim me kuadrin e BE-së. OSHU tani pritet të kërkojë kompensim.
- Në **Itali**, edhe pse nuk ka asnjë përcaktim formal, operatori incumbent vazhdoi të ofronte shërbimin universal. AKR nuk miratoi llogaritjen fillestar të koston neto në 2003 deri 2010 (AKR kishte mbledhur kontributet për vitin 2003, por nuk ka disbursuar pasi ka qenë e pezulluar nga ankimi gjyqësor). Vlerësimi i llogaritjen së koston neto 2004-2008 është i pezulluar për shkak të ankesave gjyqësore të shoqëruara me një metodologji të re të koston neto që u desh të aplikohet në mënyrë retroaktive.
- Në **Letoni** OSHU i caktuar ka pretenduar kompensim duke filluar nga viti 2006, por nuk është krijuar ndonjë mekanizëm me kontribut sektorial, si dhe as shteti nuk ka ardhur në dispozicion asnjë financim publik.
- Në **Austri** OSHU i caktuar nuk ka kërkuar kompensim nga AKR. Në vend të kësaj, financimi ka qenë i negociuar dhe rënë dakord mes tyre mbi kompensimin për sipërmarrësin e caktuar, në fakt, duke e "privatizuar" procesin.

4.4.2 CPC-9

Në ato këto katër vende të CPC që kanë kryer përcaktimet e OSHU në përputhje me DSHU, kërkesa për kompensim e bazuar në emërimin e vetëm, në rastin e Islandës, është trajtuar. Në ato vende ku zgjedhja e CPC është e bazuar në një proces të tenderit publik, asnjë komponent subvencionit nuk është raportuar si pjesë e procesit të tenderit.

4.5 Mekanizmat Aktualë të Financimit

4.5.1 BE-27

DSHU përcakton se vendet anëtare mund të financojnë koston neto të detyrimit të SHU, kur është e përshtatshme dhe e nevojshme dhe me një kërkesë kompensim nga një OSHU, ose nëpërmjet financimit publik dhe/ose nëpërmjet një mekanizmi kontributi të sektorit, në varësi të legjislacionit kombëtar.

Siç është vënë në dukje më lart, në disa Vende Anëtare nuk ka OSHU të caktuar. Ka disa Vendet të tjera Anëtare ku nuk është bërë asnjë kërkesë kompensimi apo ku një kërkesë e tillë nuk parashikohet. Së fundi, ka disa vende anëtare ku është bërë një kërkesë kompensimi, por ajo ose është refuzuar, vonuar, shtyrë ose bllokuar për shkak të mungesës së mekanizmit të financimit.

Kjo do të thotë se vetëm në një pakicë të Vendeve Anëtare ka pasur një mekanizëm financimi plotësisht funksional, në kuptimin që një OSHU e caktuar e ka marrë në të vërtetë financimin USF.

Financime Funksionale nga Kontributet e Sektorit

- **Franca** ka rregullimet më të vjetra operative të financimit të detyrimit të SHU. Bazuar në një kërkesë për kompensim të miratuar nga AKR sipërmarrësit që kanë dëtrimit për të dhënë kontribut transferojnë fonde për tek Ofruesi i Shërbimit Universal, nëpërmjet AKR. Disa vendime të mëparshme në lidhje me llogaritjen e disa elementeve të kostos neto janë apeluar me sukses juridikisht nga disa sipërmarrës, ndërsa ka pasur dhe ankime jo të suksesshme. Tabela 3 paraqet një përmbledhje të kostos neto sipas elementëve të detyrimit të SHU, llogaritjen e përfitimeve të patrupëzuara dhe shumën totale të kostos neto të detyrimit të SHU gjatë periudhës 2000-2009. Kostoja neto e detyrimit të SHU për 2009 është më pak se 0.1% e të ardhurave të sektorit në Francë.
- Tabela 3 tregon se si kanë evoluar në terma absolute dhe relative elementët e ndryshëm të detyrimit të SHU gjatë periudhës përkatëse. Në fillim të periudhës (2000-2002, për shembull), elementi më i madh i detyrimit të SHU ishte i lidhur me mesatarizimin gjeografik të tarifave. Këto ishin zona gjeografike ku kostot përkatëse të ofrimit janë më të larta se çmimi mesatar kombëtar dhe kështu, në mënyrë për të ruajtur përbalueshmërinë, kompensohej OSHU. Megjithatë, ky komponent është eliminuar në mënyrë efektive në fund të periudhës (2007-2009, për shembull), si pasojë e ribalancimit të përgjithshëm të normave dhe në veçanti rritjes së tarifës së pajtimit mujor (shih Kapitullin 3). Në vend të kësaj, komponenti më i madh gjatë fundit të periudhës janë bërë Tarifatat sociale.

Tabela 3: Kostot Netë të detyrimit të SHU - France (miliona €)										
	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Mestarizim gjeografik	105	105	154	77	57	3	1	0	3	1
Telefona me pagesë	14	15	21	24	19	14	14	12	14	14
Tarifa Sociale	9	22	35	36	39	37	36	30	37	36
Numeratori	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitime të paprekshme	0	0	-95	-84	-82	-23	-22	-21	-23	-22
TOTALI	129	142	124	53	33	31	30	27	30	29

- Edhe **Spanja** ka pasur një regjim funksional të detyrimit të SHU për disa vite. Fillimisht, operatori incumbent u emërua për të gjitha elementet e detyrimit të SHU, për të cilat ai është kompensuar në bazë të kontributeve nga operatorët që tejkalojnë një prag të caktuar (në fakt, janë vetëm tre operatorët celularë dhe sipërmarrësi i caktuar si OSHU). Kohët e fundit, elementi i Numeratorit/Shërbimi i Kërkimit të Informacionit në Numerator ishte objekt i një procesi tenderi. Tabela 4 paraqet një

përmbledhje të kostos neto sipas elementëve të detyrimit të SHU, llogaritjen e përfitimeve të patrupëzuara dhe shumën totale të kostos neto të detyrimit të SHU për vitin 2008. Tabela 5 përcakton pagesat e kontributit të sektorit për vitin 2008 - AKR vendosi një prag minimal, kështu që vetëm katër operatorët më të mëdhenj (për të ardhurat), kanë detyrimin të japin kontribute. Kostoja neto e detyrimit të SHU për 2008 është rreth 0.3% e të ardhurave të sektorit në Spanjë.

- Tabela 4 tregon peshën absolute dhe relative të elementeve të ndryshme të detyrimit të SHU. Të dy komponentët më të mëdhenj janë të lidhura me “zonat jofitimprurëse” (mesatarizimi gjeografik) dhe Tarifatat Sociale. Element i parë lidhet me zonat gjeografike ku kostot përkatëse të ofrimit janë më të larta se çmimi mesatar kombëtar dhe kështu, në mënyrë për të ruajtur përbalueshmërinë, kompensohej OSHU. Ndërsa elementi tjetër ka lidhje me marrëveshjet për tarifa të veçanta nën kosto.

	2008
Zona JoFitimprurëse	49
Përdorues me aftësi të kufizuara	0.02
Tarifa Sociale	36
Numeratori	0
Përfitime të paprekshme	-10
TOTALI	75

	2008
Telefonica	28
Telefonica Moviles	22
Vodafone Spain	16
France Telecom Spain	8
Të tjerë	0.0
TOTALI	75

Plane të Ardhme

- **Rumania** u aderua në BE në 1 Janar 2007 dhe kohët e fundit ka reformuar regjimin e saj të shërbimit universal me objektivin për të qenë në përputhje me BE më 31 Dhjetor 2012. Më parë, gjatë periudhës 2004-2008 Rumania kishte bazuar regjimin e saj në tenderimin e aksesit public me tele-qendra në zonat me pak ose aspak ofrim të shërbimit, zakonisht në zonat rurale. Nën regjimin e ri, çdo element i përcaktuar si pjesë e detyrimit të SHU (ato që rezultojnë se janë të disponueshme në treg nën kushte normale komerciale) do të financohet nga kontributet e sektorit të administruara nga një FSHU.
- **Republika Çeke** ka caktuar vetëm dy elemente detyrimit të SHU: telefonat publike me pagesë dhe masa të veçanta për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara. OSHU për këto dy elemente do të caktohet në bazë të një procesi tenderi publik dhe do të financohet nga fondet publike për vitet 2010 e tutje. Dy elementët e tjerë të detyrimit të SHU (akses në vendndodhje fikse dhe Numeratori/Shërbimi i Kërkimit të Informacionit në Numerator) janë përcaktuar nga AKR se janë të disponueshme në treg në kushte normale komerciale.

4.5.2 CPC-9

Në ato katër vende të CPC që kanë kryer përcaktimet OSHU në përputhje me DSHU, kontributi sektorial është zbatuar vetëm në Islandë, ku dy OSHU kanë marrë pagesat nga

FSHU. Në vitin 2009, një OSHU ka marrë pagesë prej 757.000 €, si kompensim për humbjet neto të USO të lidhura me shtrirjen e shërbimeve ISDN në 2000-2005. Një tjetër OSHU (ofruer i shërbimit të përgjigjeve të numrave të emergjencës 112) ka marrë kompensime prej 189.000 € 209.000 € dhe 240.000 € respektivisht për vitet 2008, 2009 dhe 2010. Kontributet arritën në 0.65% dhe 0.10% të të ardhurave të operatorëve për vitet 2009 dhe 2010, respektivisht. Asnjë mekanizëm kompensimi nuk është zbatuar në Kroaci, Mal të Zi apo Maqedoni.

4.6 Diskutim

Ky kapitull ka dhënë një panoramë se si Vendet Anëtare të BE dhe vendet CPC kanë zbatuar DSHU në praktikë. Përfundimet kryesore që mund të kenë lidhje me Shqipërinë mund të përfshijnë sa më poshtë:

- Midis Vendeve Anëtare dhe vendeve CPC ka një variacion të madh në mënyrën specifike se si është implementuar DSHU. Një varacion i tillë duket se është i bazuar në kushtet kombëtare dhe konsideratat administrative.
- Në disa Vende Anëtare, nuk është përcaktuar asnjë ofruer i US, sepse AKR konsideron se të gjitha elementet detyrimit të SHU janë duke u ofruar në kushtet e tregut. Në disa vende të tjera janë përcaktuar vetëm disa elemente detyrimit të SHU, ndërsa në vende të tjera janë caktuar të gjitha elementet detyrimit të SHU. Deri më sot, rreth gjysma e CPC kanë kryer përcaktimet OSHU në përputhje me DSHU.
- Duke marrë parasysh kushtet kombëtare dhe konsideratat administrative, vendet e BE-12 dhe CPC-9 mund të jenë relativisht më të krahasueshme me Shqipërinë, dhe në vijim janë disa nga gjetjet kryesore:
 - Disa vende CPC nuk kanë kryer asnjë caktim të OSHU ose detyrimit të SHU për shkak të konsideratave administrative.
 - Në vendet ku ka pasur caktime, janë caktuar ofruer të ndryshëm të Shërbimit Universal për element të ndryshëm të detyrimit të SHU.
 - Në përgjithësi, caktimet e ofruerëve të US janë bazuar në procese të tenderit publik për çdo element përkatës të detyrimit të SHU.
 - Në rastet ku ka pasur caktime, nuk janë përcaktuar të katër elementet detyrimit të SHU ose ato nuk janë përcaktuar në të njëjtën mënyrë si kryhet në përgjithësi në vendet e BE-15:
 - Telefonat publikë me pagesë dhe Numeratori/Shërbimi i Kërkimit të Informacionit në Numerator nuk janë përcaktuar në disa vende për shkak se ato janë konsideruar se ofrohen në kushtet e tregut ose nuk janë më të aplikueshme.
 - Bazuar në kushtet kombëtare, disa vende (Republika Çeke, Rumania dhe Mali i Zi) kanë vendosur që disa shërbime të ofruara nga rrjetet celulare plotësojnë kriteret për akses dhe shërbim nga vendndodhje fikse dhe për

këtë arsye nuk kanë caktuar një element të tillë detyrimit të SHU ose kanë caktuar një operator celular si OSHU për një element të tillë të detyrimit të SHU.

- Zbatimi i mekanizmave të financimit në përgjithësi ka qenë i lidhur me përcaktimin e OSHU bazuar në nominime. Në përgjithësi mekanizmat e financimit nuk janë raportuar si pjesë e përcaktimeve të bazuara në procese të tenderit publik.
- Në lidhje me rastet e caktimit me nominim, në disa Vende Anëtare OSHU nuk ka bërë asnjë kërkesë për kompensim, ose në qoftë se ajo e bëri, një kërkesë e tillë ose është refuzuar, vonuar, shtyrë ose bllokuar për shkak të ankimit gjyqësor, vonesave administrative ose mungesës së mekanizmit të financimit, ndër të tjera. Vetëm në një pakicë të Vendeve Anëtare ka pasur një mekanizëm financimi plotësisht funksional (në kuptimin që një OSHU e caktuar e ka marrë në të vërtetë financimin), të bazuar në kontributet sektoriale. Në vende të tilla madhësia relative dhe absolute e mekanizmit të financimit ka qenë përgjithësisht në rënie duke arritur në nivele relativisht modeste (në rangun e 0.1% deri në 0.3%).
- Në lidhje me caktimin nëpërmjet procesit të tenderit publik, mund të jetë administrativisht shumë herët për OSHU-t e caktuara për të bërë ndonjë kërkesë për kompensim (dhe mekanizmat e financimit janë krjuar vetëm në bazë të një kërkesë të veçantë të miratuar për kompensim) ose procesi i tenderit ka qenë i bazuar në fondet publike. Kjo është në kontrast me qasjen më të zakonshme të përdorura në mbarë botën jashtë rajonit të BE-CPC, procesi i tenderit publik i financuar nga kontributet e sektorit që janë akumuluar në bazë të vendimeve të mëparshme AKR për të filluar krijimin e FSHU. Në këtë mënyrë, në një mjedis pa subvencione, termat dhe kushtet e përfshira në procesin e tenderit përkatës publik duhet të jenë të hartuara në atë mënyrë që e bën detyrimit të SHU relativisht tërheqëse.

Pyetje #3: Ju lutemi jepni komentet tuaja për këtë Kapitull në përgjithësi dhe për këtë Seksion diskutimi në veçanti. A ka të dhëna, studime apo konkluzione të tjera lidhur me mënyrën specifike në të cilën DSHU është zbatuar në praktikë në BE dhe vendet CPS që AKEP duhet të marrë parasysh në analizën e tij?

5 Dikutim dhe Identifikimi i Opsioneve

Ky kapitull përmban një diskutim të disa prej sfidave dhe objektivave afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë dhe identifikon një sërë opsionesh në lidhje me hartimin dhe zbatimin e regjimit të shërbimit universal në Shqipëri.

5.1 Hyrje

DSHU vendos një detyrim për Vendet Anëtare për të siguruar që elementet e USO "janë të disponueshëm në cilësinë e specifikuar për të gjithë përdoruesit fundorë në territorin e tyre, pavarësisht nga vendndodhja gjeografike ... në një çmim të përballeshëm".

Në kontekstin e objektivit të SKZHI për integrimin me BE-në, Shqipëria ka transpozuar konsiderueshëm dispozitat e DSHU 2002 në kapitullin V të Ligjit 9918, dhe Qeveria e Shqipërisë ka propozuar të amendojë Ligjin 9918 për të reflektuar ndryshimet e 2009 të DSHU. Zbatimi i këtyre dispozitave, megjithatë, ka mbetur prapa. Në mënyrë të veçantë, nuk është përcaktuar asnjë element i detyrimit të SHU apo caktuar ndonjë ofrues i shërbimit universal. E thënë ndryshe, nuk është marrë ndonjë vendim që të thotë se të gjitha elementet e detyrimit të SHU janë duke u ofruar në mënyrë adekuate në kushtet e tregut. Nuk është formuluar asnjë plan kohor për të studiuar apo ndërmarrë përcaktime apo vendime të tilla në përputhje me përcaktimet e DSHU.

Në këtë kontekst, qëllimi i AKEP-it është të krijojë një plan kuadër shumë-vjeçar me qëllim që Shqipëria të implementojë plotësisht DSHU ("Plani Kuadër"), ndërsa në të njëjtën kohë siguron që kjo të bëhet në një mënyrë të tillë që t'i sjellë përfitime Shqipërisë. Në këtë kontekst, ky dokument Konsultimi është një hap fillestar në këtë proces. Dokumentet pasuese, përfshirë Planin Kuadër, do të përcaktojnë më tej këtë proces.

5.2 Parimet

Ky seksion përcakton disa nga parimet kryesore që AKEP po shqyrton t'i miratojë e që do të drejtojnë hartimin dhe zbatimin e çdo Plani Kuadër.

- **Së pari, Zgjidhjet e Tregut.** Nëpër botë dhe në rajon, mekanizmi më efektiv dhe i qëndrueshëm i shërbimit universal është konkurrenca e tregut. Në të vërtetë, kjo ishte një nga objektivat e strategjisë së liberalizimit për Shqipërinë. DSHU përcakton se imponimi i një USO është i përshtatshëm vetëm kur tregu nuk është duke u ofruar në mënyrë adekuate shërbimin. Në të vërtetë, siç përcaktohet në Kapitullin 4 dhe në zbatim të këtyre dispozitave të DSHU, disa vende të BE-së dhe CPC kanë hequr disa ose të gjitha caktimet e ofruesve të shërbimit universal, sepse ata kanë vendosur që elementet korresponduese të detyrimit të SHU janë duke u ofruar në mënyrë adekuate nga tregu. Kur është e mundur, AKEP mendon se mekanizmat e tregut duhet të jenë mënyra e preferuar e plotësimit të objektivave të shërbimit universal. Në këtë kontekst, AKEP do të vazhdojë për të siguruar që tregjet janë duke punuar mirë dhe të eliminojë çdo pengesë rregullatore për konkurrencën e tregut. Ndërhyrja rregullatore në formën e vendosjes së një regjimi të detyrimit të SHU të bazuar në përcaktim në përputhje me DSHU, duhet të konsiderohet me kujdes bazuar në kushtet kombëtare dhe statusin e sektorit. AKEP mendon se çdo ndërhyrje e tillë duhet të bazohet në një vlerësim që ka përfitime neto në krahasim me alternativën e zgjidhjeve të tregut.

- Çdo ndërhyrje duhet të jetë në proporcion me kushtet kombëtare.** Parimi i proporcionalitetit është një faktor kyç në vlerësimin kosto/ përfitim për krijimin e një regjimi i detyrimit të SHU bazuar në përcaktim në përputhje me DSHU. Një përmbledhje e përvojës ndërkombëtare dhe rajonale tregon se një numër disproporcionalisht i madh i FSHU-ve të suksesshme nëpër botë, gjenden në vendet më të mëdha dhe me të ardhura më të larta. Kjo mund të jetë për shkak se vendet e mëdha kanë tendencë të kenë popullsi më të madhe absolute në zonat rurale dhe të izoluara dhe kështu një masë më të madhe kritike që përlligj shpenzimet administrative, financiare dhe të burimeve njerëzore për krijimin e një FSHU. Në të njëjtën mënyrë, vende të tilla gjithashtu kanë burime financiare dhe njerëzore për të krijuar dhe administruar një regjim të tillë. Ndërkohë, vendet e vogla dhe me të ardhura të ulëta në përgjithësi nuk kanë krijuar FSHU, ose në qoftë se ato e kanë bërë këtë, shkalla e suksesit në këto vende ka qenë më e ulët pikërisht për arsyt e kundërta që përmendëm më lart. Siç përcaktohet në Kapitullin 4, Vendet Anëtare që kanë bërë disa përparime në lidhje me një kërkesë për kompensim (Austria, Italia, Republika Çeke) ose në krijimin e një mekanizmi financiar (Franca, Spanja, Rumania), e kanë mesatarisht popullsinë (35 milion) dy herë më të lartë se mesatarja e BE (18 milionë). Krahasuar me Shqipërinë, këto vende kanë një popullsi shumë herë më të lartë (35 milion krahasuar me 2.8 milion në Shqipëri), të ardhura për frymë shumë herë më të lartë (rreth 25.000 €krahasuar me rreth 3.000 €për Shqipërinë) dhe penetrim të lartë të telefonisë fikse (rreth 36% në krahasim me rreth 10% në Shqipëri). Kjo nuk do të thotë se Shqipëria duhet të tërhiqet, nëse ajo vendos të shkojë përpara, nga zbatimi i një regjimi të detyrimit të SHU të bazuar në përcaktimin e ofruesit në përputhje me DSHU. Përkundrazi, këto shifra tregojnë se vlerësimi kosto/përfitim duhet të shqyrtojë në detaje proporcionalitetin e krijimit të një regjimi të tillë, duke pasur parasysh kushtet kombëtare që janë në Shqipëri dhe se çdo regjim i tillë duhet të thjeshtohet dhe të jetë proporcional.
- DSHU duhet të implementohet duke reflektuar statusin kombëtar të sektorit.** Kapitujt 3 dhe 4 kanë treguar se ekziston variacion i konsiderueshëm në të gjitha Vendet Anëtare dhe vendet CPC në çështjen specifike të mënyrës së implementimit të DSHU dhe se variacioni i tillë duket të jetë i bazuar në kushtet kombëtare dhe konsideratat administrative. Penetrimi fikse ka qenë në rënie në të gjithë BE-së dhe në rritje në vendet e CPC dhe Shqipëri. Penetrimi fikse dhe të proporcioni që zenë të ardhurat nga fiksi në totalin e të ardhurave në Shqipëri janë shumë poshtë mesatareve krahasuese. Nga ana tjetër, penetrimi celular dhe mbulimi i popullsisë me celular në Shqipëri ka konverguar në një nivel "ngopjeje". Të ardhurat nga celulare në Shqipëri përbëjnë një pjesë shumë më të madhe të të ardhurave totale të sektorit sesa mesatarja e BE. Duke marrë parasysh kushtet kombëtare dhe konsideratat administrative vendet e BE-12 dhe CPC-9 mund të jenë relativisht më të krahasueshme me Shqipërinë. Disa vende të CPC nuk kanë zbatuar ende asnjë përcaktim të detyrimit të SHU apo ofrues të shërbimit universal. Në vendet ku ka pasur përcaktime, janë caktuar ofrues të ndryshëm të Shërbimit Universal për element të ndryshëm të detyrimit të SHU. Në përgjithësi, caktimi i OSHU është bazuar në proces tenderi publik për secilin nga elementet përkatëse të detyrimit të SHU. Jo të gjithë elementët e detyrimit të SHU janë përcaktuar ose ato nuk janë përcaktuar në të njëjtën mënyrë si kryhet në përgjithësi në vendet e BE-15: Telefonat publikë me pagesë dhe Numeratori/Shërbimi i Kërkimit të Informacionit në Numerator nuk janë përcaktuar në disa vende për shkak se ato janë konsideruar se ofrohen në kushtet e tregut ose nuk janë më të nevojshme/të aplikueshme për shkak të mbulimit dhe penetrimin celular (për

telefonat publik me pagesë). Më tej, bazuar në mbulimin dhe penetrimin celular (kudo) disa vende kanë vendosur që disa shërbime të ofruara nga rrjetet celulare plotësojnë gjithashtu kriteret për akses dhe shërbim nga vendndodhje fikse (p.sh. Republika Çeke, Rumania dhe Mali i Zi). Në këto vende ky element i detyrimit të SHU nuk është përcaktuar (për shkak se ai është i disponueshëm në kushtet e tregut) ose një operator celular është caktuar si ofrues i këtij elementi të detyrimit të SHU. Në përgjithësi mekanizmat e financimit nuk janë raportuar si pjesë e përcaktimeve të bazuara në procese të tenderit publik.

- **Siguri ligjore dhe korrektësi procedurale.** Siç është vërejtur në Kapitullin 4, në shumë Vende Anëtare zbatimi i DSHU ka qenë objekt i vonesave administrative dhe apelimeve gjyqësore në lidhje me përcaktimin e ofruesit të shërbimit universal, llogaritjen e kostove neto të USO dhe pagesën në mekanizmin e kontributit të sektorit. Në këtë kontekst, AKEP konsideron shumë të rëndësishme që zbatimi i një regjimi i detyrimit të SHU me bazë përcaktimi, në përputhje me DSHU, të bëhet në kontekstin e sigurisë ligjore dhe korrektësisë procedurale. Në përputhje me praktikën ndërkombëtare dhe rajonale, AKEP është duke marrë parasysh përgatitjen dhe hyrjen në fuqi të Rregulloreve të Shërbimit Universal që do të plotësojnë parimet ligjore dhe kompetencat institucionale të përgjithshme të përfshira tashmë në kreun V të Ligjit 9918. Legjislacioni sekondar (plotësues) si Rregullorja e propozuara e Shërbimit Universal mund të përmbajë dispozita më të hollësishme që mund të sigurojnë bazën për siguri më të madhe juridike dhe korrektësi procedurale se sa Kreut V më vehte. Gjithashtu, legjislacioni dytësor mund të ndryshohet më lehtë se legjislacioni primar për të pasqyruar zhvillimet e mëtejshme dhe mësimet e nxjerra në bazë të përvojës aktuale praktike.
- **Analiza dhe planifikimi i ardhshëm.** Siç u përmend më lart, objektivi kryesor i Planit Kuadër është që Shqipëria të implementojë plotësisht DSHU, ndërsa në të njëjtën kohë të sigurojë se ajo bëhet në mënyrë të tillë që të përfitojë Shqipëria. Në këtë kontekst, AKEP pret të kryejë analizën dhe planifikimin me bazë të ardhshëm. Kjo do të thotë, që AKEP jo vetëm do të shikojë në situatën e tanishme, por gjithashtu, bazuar në tendencat dhe vlerësimin aktuale, do të shikojë së çfarë situatë ka të ngjarë të jetë në të ardhmen e afërt dhe atë afatmesme. Për këtë arsye, Plani Kuadër duhet të hartohet për të krijuar mundësinë e rishikimit dhe përditësimit të tij, siç kërkohet, por duhet gjithashtu të ketë një kohëzgjatje të caktuar, pas së cilës ai duhet të riformulohet. Duke pasur parasysh zhvillimet rajonale, AKEP mendon se një tre-vjeçar horizont mund të jetë një afat i përshtatshëm, dhe prandaj pret që analiza duhet të konsiderohen në një periudhë të tillë. Në praktikë, duke pasur parasysh fazën e procesit të konsultimit, data e fundit e punës për Planin do të jetë 31 Dhjetor 2015.

Pyetje #4: Ju lutem jepni komentet tuaja mbi parimet e shtruar më sipër që AKEP propozon t'i përdorë si bazë për përgatitjen e Planit Kuadër. Ju lutem komentoni nëse AKEP duhet të konsiderojë parime të tjera në analizën e tij?

5.3 Akses & Shërbim nga Vendndodhje Fikse

5.3.1 Përcaktimi i elementit të detyrimit të SHU

Siç përcaktohet në Kapitullin 4, në përgjithësi ky element i detyrimit të SHU është më i madhi nga një perspektivë financiare dhe si pasojë ka shumë aspekte për tu marrë në konsideratë, duke përfshirë edhe ato të paraqitura më poshtë.

5.3.1.1 Dinamikat e Tregut

Në kontrast me BE-në si një e tërë, ku penetrimi fiks ka rënë, në Shqipëri penetrimi i telefonisë fikse është rritur në mënyrë të vazhdueshme gjatë dekadës së fundit, ajo është më shumë se dyfishuar nga rreth 5% në vitin 2000 në rreth 11-12% në 2010-2012, periudhë gjatë së cilës penetrimi fiks duket se është stabilizuar. Pas futjes së konkurrencës fikse në zonat rurale në vitin 2001, konkurrenca është e lejuar edhe në zonat urbane duke filluar në vitin 2007. Duke filluar nga hyrja në fuqi e ligjit 9918 në vitin 2008, operatorët alternativë gjithashtu mund të veprojnë në shkallë kombëtare (zona urbane dhe rurale). Operatori inkumbent ish-monopolist është privatizuar gjithashtu.

Një numër relativisht i madh i OA (mbi 80 janë licencuar) tani konkurrojnë me Albtelecom në ofrimin e shërbimeve fikse me tela në tregjet e familjarëve dhe bizneseve në nivel kombëtar, duke përfshirë zonat urbane dhe rurale. Deri në fund të vitit 2011, të gjithë OA së bashku kishin 24% pjese tregu për nga numri i abonentëve, ndërkohë që Albtelekom mban një pjesë tregu prej 76%.

Të gjitha të OA janë në pronësi private dhe disa nga më të mëdhenjtë janë edhe operatorë të televizioneve kabllore ("CATV") që ofrojnë shërbime fikse zanore, shpesh në kontekstin e paketave Triple Play (CATV, Internet dhe telefoni fikse)²⁶. Kohët e fundit, operatori celular AMC ka filluar ofrimin e një shërbimi të telefonisë fikse "AMC Fiks" që është i disponueshëm në nivel kombëtar duke përdorur një telefon tavoline të të specializuar me një numër fiks që ka akses në rrjetin GSM të AMC.

Siç është përmendur në Seksion 3.2, Shqipëria ka parë një rritje të qëndrueshme dhe kohët e fundit një stabilizim në penetrimin e telefonisë fikse. Pavarësisht kësaj, penetrimi fiks në Shqipëri është nën mesataren e BE-së dhe të vendeve të tjera të rajonit, siç është vënë në dukje në Seksion 3.2. Siç është thënë në Seksion 3.8. të dhënat në nivel rajonal tregojnë se penetrimi fiks është shumë më i lartë në zonat urbane (19.8%) sesa në zonat rurale (1.7%). Diferenca të tilla në penetrim janë në përputhje me diferencat midis zonave administrative në shumë vende me penetrim të ulët me popullsi relativisht të madhe në zonat rurale. Nga ana tjetër, penetrimi celular dhe mbulimi i popullsisë me telefoni celularë në Shqipëri janë rritur shumë shpejt gjatë dekadës së fundit dhe ka konvergjuar në një nivel "ngopjeje" me vendet e tjera në BE dhe të rajonit. Shifrat e fundit në dispozicion për 2011 tregojnë se penetrimi celular në Shqipëri është rreth 183%, shumë më lart se mesataret e BE dhe rajonit. Më shumë se 99.8% e popullsisë në nivel kombëtar në Shqipëri është e mbuluar nga një ose më shumë operatorë celularë, nga katër operatorët aktuale celularë. Në këtë kontekst të përgjithshëm, nuk është për t'u habitur që të ardhurat nga celularë si një përqindje e të ardhurave të sektorit në Shqipëri janë relativisht shumë më të larta se niveli mesatar në BE dhe rajon, dhe për pasojë të ardhurat nga fiksi janë relativisht të ulëta.

²⁶ Me të vertetë, ABCOM dhe ASC janë dy OA më të mëdhenj dhe të dy ofrojnë paketa të tilla "trefishe (triple play)"

Në mënyrë të përmbledhur, ndryshe nga vendet e BE-15 në vitin 2002, kur ka dalë DSHU e parë, në Shqipëri telefonia fikse me tela nuk ka qenë as nuk është ende e disponueshme dhe përdorur në mënyrë universale. Objektivi origjinal i DSHU për mbrojtjen e një shërbimi të tillë universal nuk vlen për telefoninë fikse në Shqipëri për shkak se këto shërbime nuk janë "tashmë në dispozicion të, dhe të përdorura nga shumica e madhe e konsumatorëve".

Një llogaritje e përafërt ofron një vlerë indikative të penetrimit fiks që mund të konsiderohet si "universale", në këtë shembull të vogël në rastin e Shqipërisë. Bazuar në vlerësimet paraprake të regjistrimit të popullsisë për vitin 2011, popullsia e Shqipërisë është rreth 2.8 milion. Aktualisht, ka rreth 3.8 persona për familje. Bazuar në të dhënat aktuale të AKEP, rreth 90% e linjave fikse janë familjarë. Prandaj, që telefonia fikse të jetë universale për përdoruesit familjarë mund të kërkojë rreth 2.8 milion / 3.8 persona / familje/ 90% familjarë ≈ 825.000 linja në total (familjarë dhe të biznesit). Kjo është ekuivalente me rreth 825,000 linjave / 2.800.000 popullsisë * 100% $\approx 29\%$ penetrim fiks²⁷. Kjo shifër është në kontrast të madh me penetrimin aktual fiks në Shqipëri, e cila, siç përcaktohet në Seksion 3.2, është stabilizuar kohët e fundit (në mënyrë të ngjashme me vendet CPC-5). Penetrimi fiks ka qenë në rënie gjatë dekadës së fundit në vendet e BE-15 dhe BE-12.

Pyetje #5: Ju lutemi jepni komentet tuaja në lidhje me diskutimin më sipër mbi Dinamikat e Tregut për shkak të lidhjes me elementin e Aksesit & Shërbimit nga Vendndodhje Fikse. A ka ndonjë aspekt tjetër që AKEP duhet të marrë në konsideratë në analizën e tij?

5.3.1.2 Tarifat Sociale

Tarifat sociale janë opsione ose paketa tarifore me zbritje që janë të disponueshme vetëm për grupe të caktuara sociale (p.sh. me të ardhura të ulëta, nevoja të veçanta sociale, me aftësi të kufizuara, pensionistët, etj.) Në përgjithësi, Tarifat Sociale janë të mandatuara në bazë të një detyrimit të SHU ose një lloj tjetër detyrimi ose marrëveshje. Në lidhje me të parën, Neni 9 i DSHU përfshin përkrahimin në vijim "opsione ose paketa tarifore të cilat devijojnë nga ato të ofruara në kushte normale komerciale, ... për të siguruar që ata me të ardhura të ulëta ose me nevoja të veçanta sociale nuk pengohen për aksesin në rrjet ose për ... përdorimin e shërbimeve ... që janë pjesë e detyrimeve të shërbimit universal dhe të ofruara nga sipërmarrësit e caktuar".

Paketat tarifore për përdorim të ulët që ofrohen vullnetarisht nga operatorët në kushte normale komerciale janë të ndryshme nga Tarifat Sociale. Këto paketa tarifore për përdorim të ulët, të cilat në përgjithësi kanë një tarifë të ulët fikse mujore dhe tarifa më të larta për thirrjet (ose më pak minuta falas të përfshira në tarifën mujore) janë të hartuara të jenë më të favorshme për çmimin për përdoruesit që kanë relativisht pak ose aspak thirrje dalëse.

Me synimin për të siguruar një terminologji të qëndrueshme në këtë drejtim, në vijim do të përdoren termat e mëposhtëm:

- **Tarifa Sociale të detyrimit të SHU.** Një opsion ose paketë tarifore e cila devijon nga ato të ofruara në kushte normale komerciale, që është e disponueshme vetëm grupe

²⁷ Në mënyrë interesante, kjo është afër nivelit të përafërt prej 30% në të cilin duket se ka një konvergjençë midis grupeve BE-12 dhe CPC, të paraqitur në Kapitull 3.

sociale të caktuara dhe ofruar nga një ofrues i përcaktuar për shërbimin universal bazuar në detyrimin të SHU siç përcaktohet nga Autoriteti Kombëtar Rregullator kompetent, për të cilën ofruesi i shërbimit universal ka të drejtë për kompensim nga Fond i Shërbimit Universal, në përputhje me legjislacionin përkatës.

- **Tarifa të Tjera Sociale.** Një opsion ose paketë tarifore e cila devijon nga ato të ofruara në kushte normale komerciale, që është e disponueshme vetëm grupe sociale të caktuara dhe e ofruar nga një sipërmarrës bazuar në një kërkesë, detyrim ose rregullim tjetër që nuk një detyrimin të SHU siç përcaktohet nga Autoriteti Kombëtar Rregullator kompetent, për të cilën sipërmarrësi mund ose mund të mos ketë të drejtë për kompensim nga një burim i ndryshëm nga Fond i Shërbimit Universal, në përputhje me rregullimin e vecantë të detyrimin përkatës.
- **Paketë Tarifore për Përdorim të Ulët.** Një opsion ose paketë tarifore që ofrohet në kushte normale komerciale dhe është e disponueshme për publikun e gjerë dhe e ofruar vullnetarisht nga një sipërmarrës, për të cilën nuk ka kompensim. Paketat për përdorim të ulët përbëjnë një përzierje të ndryshme të çmimeve për shërbimet e aksesit dhe thirrjeve, në mënyrë që përdoruesit do të "vetë-zgjedhin": personat me përdorim të ulët do të zgjedhin paketa të tilla, ndërsa personat me përdorim të mesëm dhe të lartë do të zgjedhin paketën standarde.

Paketat Tarifore për Përdorim të Ulët dhe Tarifat Sociale të detyrimin të SHU janë të disponueshme në disa vende Anëtare. Për shembull, siç është vënë në dukje Seksion 4.5, Tarifat Sociale të detyrimin të SHU janë disa nga komponentët financiarë më të mëdhenj të regjimeve USO në Spanjë dhe Francë. Është e rëndësishme të theksohet se Tarifat e Tjera Sociale, për aq sa ato janë jashtë regjimit të detyrimin të SHU, nuk janë në përputhje me DSHU dhe ka mundësi të ndaloheshin nga KE.

Ndër vendet e CPC-9, vetëm katër prej tyre kanë kryer përcaktimet të OSHU në përputhje me DSHU. Nga këto katër vende, Kroacia dhe Mali i Zi kanë implementuar Tarifat Sociale të detyrimin të SHU. Tarifat e Tjera Sociale dhe Paketat Tarifore për Përdorim të Ulët janë të disponueshme në disa vende të tjera të CPC-9, siç janë paraqitur në Tabelën 6, përpiluar në bazë të të dhënave të përfshira në Raportin Cullen, të plotësuar me të dhënat e mëposhtme:

- Është përfshirë një kolonë shtesë që përmban klasifikimin e AKEP për paketat tarifore si "Paketat Tarifore për Përdorim të Ulët", "Tarifave Sociale të detyrimin të SHU " ose "Tarifa të Tjera Sociale", bazuar mbi termat dhe përkufizimet e përfshira më sipër.
- Për shembull, në rastin e Shqipërisë, VKM 850, datë 17 Dhjetor 2004, me objektivin për të promovuar përballueshmërinë për grupe të veçanta sociale, ka detyruar Albtelecom për të ofruar një paketë tarifore familjare me zbritje për telefoninë fikse për përdoruesit e përcaktuar me aftësi të kufizuara, deri kohët e fundit (shiko më poshtë). Kjo paketë përfshinte një zbritje prej 200 lekë për tarifën mujore familjare (duke e çuar atë nga 530,4 lekë / muaj për 330.4/muaj) dhe një zbritje prej 80% për të gjitha tarifat e thirrjeve deri në 2000 lekë / muaj (0% zbritje për tarifat e thirrjeve për shpenzime mbi këtë vlerë).. Për shkak se kjo paketë tarifore speciale e Albtelecom nuk është më në fuqi, ajo nuk pasqyrohet në Tabelën 6.
- Sic është vënë në dukje më lart, kjo paketë speciale e Albtelecom nuk është më e detyrueshme për tu ofruar sipas VKM [[xx]], datë [[Muaji]][[Dita]], 2012. Ky

Vendim ndryshoi skemën e përshkruar më sipër në një skemë ku Qeveria e Shqipërisë tani ofron një pagesë direkte subvencioni prej 1,000 lek/muaj për përdoruesit e përcaktuar me aftësi të kufizuara për të blerë shërbime fikse të telekomunikacioneve.

- Siç është vënë re në Kapitullin 4, një numër vendesh kanë përcaktuar se një shërbim i disponueshëm FGSM plotëson parametrat e elementit të detyrimeve të SHU në një vendndodhje fikse për qëllime të DSHU. Altelekom aktualisht nuk ofron një paketë familjare të vecantë për përdorim të ulët përveç paketës standarde²⁸.
- Sic është theksuar në Vendim 2318, shumë OA konkurrojnë në tregun fiks, përfshirë dhe me paketa të ndryshme. Për shembull, operatori celular AMC ofron një shërbim FGSM, "AMC Fiks", në të gjithë vendin. Është e mundur që një konsumator që kërkon një "paketë familjare për përdorim të ulët", si një alternativë për paketën standarde të Altelecom mund të marrë paketën "Bazë" me kontratë 2 vjeçare për një tarifë mujore 1,78 €²⁹. Kjo është përfshirë në Tabelën 6 si një "Paketë Përdorim i ulët" për Shqipërinë.
- Siç përcaktohet në Kapitullin 4, në Mal të Zi një operator celular u caktua si OSHU dhe ka detyrimin të përmbushë të gjitha kërkesat e arsyeshme, pavarësisht nga vendndodhja gjeografike, për një lidhje të re në shërbimin e caktuar (fikse-pa tela), përfshirë edhe një Tarifë Sociale - paketë (e disponueshme vetëm për përdoruesit e përcaktuar me të ardhura të ulëta ose me aftësi të kufizuara). Tarifat mujore për paketën standarde dhe Tarifa Sociale janë €6,79 dhe €4,00. Tarifat e thirrjeve për paketën tarifa Sociale janë 20% më të lira sesa ato të paketës standarde. Këto dy paketa tarifore janë të përfshira edhe në Tabelën 6. Vini re se këto Tarifa specifike të SHU bashkë-ekzistojnë me paketat korresponduese të ofruara nga operatori inkumbent fiks që nuk janë objekt i detyrimeve të SHU, përfshirë edhe bërjen të disponueshme "pavarësisht vendndodhjes gjeografike". Siç është diskutuar në Kapitullin 4, interesi më i madh për paketën e detyrimeve të SHU pritet të jetë në zonat rurale dhe zonat e tjera që tradicionalisht kanë penetrim të ulët të telefonsisë fikse.

²⁸ Sic është vënë re në dukje në Vendim 2138, Altelecom ofron tani disa paketa opsionale të përziera të telefonsisë fikse dhe aksesit në Internet ('paketa dyfishe') që përbejnë 20-30% të pajtimtarëve deri në fund të Qershor 2012. Në fakt, Vendimi 2138 vuri në dukje se të tilla paketa të përziera të telefonsisë fikse dhe aksesit në Internet ofrohen edhe nga disa OA. Popullariteti i paketave të tilla dyfishe (nga Altelecom dhe OA) tregon se konkurrenca midis operatorëve fiks nuk është vetëm në aspektin e telefonsisë fikse, por edhe të shërbimit të Internetit, dhe ky i fundit konsiderohet si shtytësi kryesor i zhvillimit të telefonsisë fikse.

²⁹ Sic përcaktohet në Vendim 2138, ka disa opsione të tjera të mundshme të krahasueshme të disponueshme nga OA të tjerë. Vini re se AMC Fiks ofron gjithashtu opsione me parapagim.

Tabela 6: Trifat mujore familjare Standarde dhe përdorim i ulët/Tarifa Sociale (€) (Mars, 2012)							
	Operatori	Paketa Standarde Familjare		Paketa Përdorim i Ulët /Tarifa Sociale			
		Tarifa Mujore	Njësi të Thirrjeve të Përfshiral	Tarifa Mujore	Njësi të Thirrjeve të Përfshiral	Lloji i Paketës	Kufizime në Disponueshmëri (nëse ka)
Serbia	Inkumbent Fiks	4.59	300 impulse	2.29	300 impulse	Tarifa të Tjera Sociale	Vetëm për personat e përcaktuar me aftësi të kufizuara.
Bosnja Herzegovina	Inkumbent Fiks	6.73	120 minuta lokale në kohë pik	2.40	100 minuta lokale në kohë pik	Tarifa të Tjera Sociale	Vetëm për familjet e dëshmorëve & personat me aftësi të kufizuara
Mali i Zi	Inkumbent Fiks	5.97	100 minuta lokale në kohë jashtë pikut	3.04	0	Paketa Përdorim i Ulët	Vetëm për familjarë.
	Ofruesi i Përcaktuar i SHU(cellular)	6.79	0	4.00	0	Tarifa Sociale të USO	Vetëm për personat me të ardhura të ulëta ose me aftësi të kufizuara.
Maqedonia	Inkumbent Fiks	7.66	0	2.07	0	Tarifa të Tjera Sociale	Ka kufizime.
Kosova	Inkumbent Fiks	9.36	2,500	4.99	75	Paketa Përdorim i	Nuk ka kufizime.
Mesatare CPC-5		6.94		3.05			
Shqipëria	Inkumbent Fiks	3.79	0		0		
	OA (AMC Fiks FGSM)			1.76	100 minuta drejt numrave të të njëjtit OA	Paketa Përdorim i Ulët	Nuk ka kufizime.

Mesatarisht, vlera mesatare e CPC-5 për paketën Përdorim i Ulët/ Tarifa Sociale prej 3,05 € është sa 44% e vlerës mesatare të paketës standarde familjare prej 6,94 € Paketa standarde familjare për Shqipërinë prej 3,79 € është relativisht e ulët dhe është më shumë e krahasueshme me vlerën mesatare të CPC-5 për paketën Përdorim i Ulët/ Tarifa Sociale (3,05€) se sa me vlerën mesatare të paketës standarde (6,94 €). Në Shqipëri, Paketa Familjare Përdorim i Ulët (1,76 €) ka tarifë mujore më të ulët se sa paketa standarde që ofrohet nga Albtelecom (3,79 €).

Pyetje #6: Ju lutemi jepni komentet tuaja në lidhje me diskutimin më sipër mbi Tarifat Sociale për shkak të lidhjes me elementin e Aksesit & Shërbimit nga Vendndodhje Fikse. A ka ndonjë aspekt tjetër që AKEP duhet të marrë në konsideratë në analizën e tij?

5.3.1.3 Përballueshmëria

Akses & Shërbim nga Vendndodhje Fikse

Nenet 3 dhe 9 të DSHU përfshijnë dispozita që lidhen me disponueshmërinë e shërbimeve të caktuara me çmime të përballueshme, “në kuadër të kushteve të veçanta kombëtare”. Figura 15 në Seksionin 3.7 tregoi se pagesa fikse mujore familjare ishte rritur në vendet e CPC-5 dhe Shqipëri gjatë viteve të fundit. Së bashku me tarifën e thirrjeve në rënie (kombëtare dhe

ndërkombëtare) të përmendura, vlera totale e “paketës” për shumë abonentë të telefonisë fikse do të jetë zvogëluar, ndërsa ajo mund të të jetë rritur për ata pak abonentë me pak thirrje dalëse.

Tabela 7 paraqet një krahasim çmime-të ardhura të pagesës mujore të paketave tarifore standarde dhe Përdorim i ulët/Sociale për vendet e CPC-5 dhe Shqipërisë dhe të dhenat janë marrë nga versioni aktual i Raportit Cullen (të dhënat i referohen Mars 2012) . Këto të dhëna u paraqitën në Tabelën 6 dhe janë plotësuar në Tabelën 7 me të dhëna PBB/banorë, e cila është përdorur për të llogaritur përqindjen e PBB mesatare mujore të një personi që do të ishte e nevojshme për të blerë shërbimin/paketën korresponduese³⁰. Tabela 7 tregon se në vendet e CPC-5, tarifa fikse mujore e paketës standarde familjare është 6,94 €dhe përbën 2.6% të PBB për person në muaj. Edha Shqipëria ka një situatë të ngjashme, ku paketa e përdorimit të ulët e shërbimeve celulare (5,50 €) është pak më e lartë se Tarifa fikse mujore e paketës standarde familjare në Shqipëri është 3,79 €dhe përbën një një proporcion shumë më të ulët (1.6%) të PBB për person në muaj. Në lidhje me paketat familjare të përdorimit të ulët/Tarifë Sociale, në vendet e CPC-5 ato kanë vlerë mesatare 3,05 € dhe kjo është relativisht më e përballeshme sesa paketa standarde familjare, duke kushtuar mesatarisht 1.1% të PBB-së mesatare mujore. Për Shqipërinë, paketa e përdorimit të ulët prej 1.76€ është shumë më e ulët se mesatarja e CPC-5 dhe kushton vetëm 0.7% të PBB mesatare mujore.

	Tarifa Fikse Mujore e paketës Standarde Familjare		Tarifa Fikse Mujore Familjare për paketa përdorim i Ulët/Tarifa Sociale	
	Pajtimi Mujor (€)	% e PBB/pop	Pajtimi Mujor (€)	% e PBB/pop
Serbia	4.59	1.4%	2.29	0.7%
Bosnja Herzegovina	6.73	2.5%	2.40	0.9%
Mali i Zi	6.38	1.5%	3.52	0.8%
Maqedonia	7.66	2.7%	2.07	0.7%
Kosova	9.36	4.7%	4.99	2.5%
Mesatare CPC-5	6.94	2.6%	3.05	1.1%
Shqipëria	3.79	1.6%	1.76	0.7%

Alternativa Konkurruese për Aksesin & Shërbime nga Vendndodhje Fikse: Telefonja Celulare

Vendimi 2138 arriti në përfundimin se aksesit/thirrjet nga rrjetet celulare nuk janë pjesë e tregut përkatës të aksesit/thirrjeve nga vendndodhje fikse. Megjithatë, Vendimi 2138 gjithashtu vuri në dukje se shërbimet celulare janë një alternativë konkurruese, sidomos duke pasur parasysh reduktimin në vite të tarifave celulare. Tarifat e thirrjeve të veçanta brenda grupeve të mbyllura të përcaktuara nga përdoruesi në të njëjtin rrjet celular janë të krahasueshme me tarifat e thirrjeve lokale dhe kombëtare të Altelecom. Së bashku me tarifat mujore te ulëta ose në nivel zero, telefonja celulare përbën një alternativë konkurruese. Siç

³⁰ Për Malin e zi në Tabelë 6 kishte dy shërbime alternative-në Tabelë 7 është përfshirë mesatarja e tyre.

është përcaktuar në Vendimin 2138, e gjithë kjo ka rezultuar në efekte zëvendësimi të thirrjeve telefonike nga rrjetet fikse në rrjetet celulare, kështu që thirrjet e bëra nga rrjetet celulare janë rritur ndjeshëm gjatë periudhës 2008-2011 dhe kanë qenë në nivel më të madh se thirrjet nga rrjeti Albtelecom që nga viti 2007.

Për të ilustruar reduktimin relativ të tarifave celulare në Shqipëri, ne kemi përdorur “shportat” tarifore celulare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim ("OECD"). Kjo metodologji është përdorur nga OECD për më shumë se një dekadë, dhe është përdorur nga KE për krahasime midis të gjithë Vendeve Anëtare të saj³¹. Shportat celulare janë përcaktuar si "përdorim i ulët" - 30 thirrje dalëse (brenda rrjetit, drejt celulareve të tjerë, drejt fikse) në muaj (duke pasur 44 minuta të thirrjeve dalëse në muaj si MOU) plus 33 mesazhe SMS në muaj, "përdorim i mesëm" - 65 thirrje dalëse plus 50 SMS në muaj, dhe "përdorim i lartë" - 140 thirrje dalëse dhe 55 SMS në muaj. Duke pasur parasysh se ky është një diskutim mbi reduktimin relative të tarifave celulare pasi ato ndikojnë përbalueshmërinë, në analizë është përfshirë shporta “përdorim i ulët”.

Figura 21 tregon ecurinë e paketës së përdorimit të ulët celular të OECD nga viti 2007 deri në Mars 2012 për vendet CPC-5 dhe Shqipërinë. Të dhënat janë nga Raporti i Cullen dhe, sipas metodologjisë së shportave, për secilin vend është përzgjedhur oferta më e ulët në dispozicion. Mesatarja e vendeve të CPC-5 ka rënë në fillim dhe më pas ka mbetur në 5,50-6,00 € gjatë periudhës 2008-2012. Në të kundërt, çmimet celulare në Shqipëri ishin disa nga më të lartat në rajon në vitin 2007, duke qenë më shumë se sa dy herë e gjysmë e tarifave mestare të CPC-5. Megjithatë që nga ai vit, çmimet celulare kanë rënë me një normë të qëndrueshme duke arritur që në vitin 2012 ato të jenë në të njëjtin nivel si mesatarja e CPC-5. Rënia e çmimeve të telefonisë së lëvizshme në Figurën 21 është në përputhje me Figurën 7 në Kapitullin 3 që demonstroi se si Shqipëria, pasi kishte ngelur prapa tendencave rajonale të penetrimit të telefonisë së lëvizshme, filloi të kapte vendet e tjera (2007-2008) dhe t'i tejkaloi ato (2009-2012) në lidhje me penetrimin celular.

³¹ Vini re se disa komentues në rajon kanë argumentuar për krijimin e një grupi shportash që mund të reflektojnë më mirë modelet kombëtare apo rajonale të përdorimit. Megjithatë, një rishikim i tillë i shportave do të bënte të pamundur krahasimet ndër-rajonale ose me BE. Në të vërtetë, ka mundësi që rishikimi të bënte shumë të vështirë krahasimet historike kombëtare apo rajonale, vetëm nëse rezultatet e vjetra do të mund të rillogariteshin. Në të vërtetë, është ky krahasim historik që është duke u theksuar në këtë seksion. Në të vërtetë, paketa celulare ‘përdorim i vogël’ e OECD mund të konsiderohet si një "kufi i sipërm" për disa përdorues. Shporta OECD ka një peshë prej 48% për thirrjet brenda rrjetit, 22% për thirrjet drejt celularëve të tjerë, 22% thirrje drejt fikse dhe 8% për postë zanore. Për shembull, përdoruesit që kanë një përqindje të lartë të thirrjeve brenda grupeve të mbyllura në të njëjtin rrjet celular (brenda-rrjetit), do të jenë në gjendje të përfitojnë nga këto tarifa relativisht shumë të ulëta ose falas, të përmendura më lart, dhe kështu shpenzimet e përgjithshme të tyre do të jenë më të ulëta. Nga ana tjetër, abonentët e tjerë me modele të ndryshme përdorimi nuk do të zgjidhnin paketën e grupeve të mbyllur. Në të vërtetë, versioni më i fundit i Raporti Cullen vëren se të ardhurat mesatare (jo të ponderuara) për minutë për trafikun dalës për katër operatorët celularë në Shqipëri ishte rreth €0,039. Të ardhurat mesatare për minutë për përdoruesit me parapagim do të jetë më i ulët dhe ka të ngjarë në vlerat 0,02 € deri në 0,03 €.

Figura #21




Tabela 8 paraqet një krahasim çmime-të ardhura, të paketës celulare OECD ‘përdorim i ulët’ për vitet 2007 dhe 2012, për vendet e CPC-5 dhe Shqipërisë dhe të dhenat janë marrë nga versionet e tanishme dhe versionet e mëparshme të Raportit Cullen. Këto të dhëna u paraqitën në Figurën 21 dhe janë plotësuar në Tabelën 8 me të dhëna PBB/banorë, e cila është përdorur për të llogaritur përqindjen e PBB mujore mesatare për person që do të jetë e nevojshme për të blerë shërbimin/paketën³² korresponduese. Tabela 8 konfirmon se çmimet celularë kanë rënë shumë ndjeshëm në Shqipëri gjatë pesë viteve të fundit. Për shportën OECD me përdorim të ulët, personi mesatar në Shqipëri do të kishte shpenzuar 10.6% të PBB së tij mujore për të blerë një paketë të tillë për 21,79 € në vitin 2007. Megjithatë, në Mars 2012, kjo shifër ka rënë në vetëm 2.3% me 5,50 €³³. Për shportën me përdorim të ulët të OECD, çmimet celulare të Shqipërisë tani janë të krahasueshme me ato të mesatares së CPC-5 prej 5,68 € e cila do të kushtonte 2.0% të PBB mujore për ta blerë. E gjitha kjo për të konkluduar se telefonia celulare, siç është përmendur më lart, është një alternativë konkurruese për telefoninë fikse, dhe sic është venë në dukje në Kapitull 3, ka shumë më tepër pajtimtarë, të ardhura dhe mbulim se telefonia celulare në Shqipëri.

³² Vini re se vetëm për qëllime prezantimi, ky krahasim supozon se përdoruesi mesatar në fjalë bën 30 thirrje në muaj ekuivalent me 44,1 minuta dalëse në muaj. Të dhënat më të fundit tregojnë se përdorimi mesatar mujor celular MOU është më shumë se dy herë më i lartë se ky numër. Krahasuar me paketën e OECD-së, kjo do të rrisë çmimin e paketës dhe përqindjen përkatëse të të ardhurave mujore të nevojshme për të blerë një numër kaq të lartë të thirrjeve.

³³ Duke pasur parasysh se janë 44.1 minuta thirrje në paketën OECD të përdorimit të ulët, të ardhurat mesatare për minutë korresponduese janë rreth 0,125 € (pa marrë parasysh çmimin e SMS), apo rreth tri herë më të larta se të ardhurat aktuale mesatare për minutë për Shqipërinë që u përmend më lart. Duke e krahasuar (kombinuar çmimin për minutë) me paketën e OECD, kjo do të ulte çmimin e paketës dhe përqindjen e të ardhurave përkatëse mujore të nevojshme për të blerë minuta me çmim të tillë të ulët.

Tabela 8:
Krahasim Çmim/PBB për Paketën celulare 'përdorim i ulët' i OECD (€)
(2007 & 2012)

	2007		2012	
	(€)	% e PBB/person	(€)	% e PBB/person
Serbia	7.61	2.4%	3.97	1.2%
Bosnja	10.16	4.2%	9.18	3.4%
Mali i Zi	6.18	1.7%	5.64	1.4%
Maqedonia	7.41	3.0%	4.54	1.6%
Kosova	11.12	8.4%	5.09	2.6%
Mesatare CPC-5	8.50	3.9%	5.68	2.0%
Shqipëria	21.79	10.6%	5.50	2.3%

Pyetje #7: Ju lutemi jepni komentet tuaja në lidhje me diskutimin më sipër mbi Përbalueshmërinë për shkak të lidhjes me elementin e Aksesit & Shërbimit nga Vendndodhje Fikse. A ka ndonjë aspekt tjetër që AKEP duhet të marrë në konsideratë në analizën e tij?

5.3.1.4 Aksesi Broadband

Broadband aktualisht nuk është i përfshirë si një element i detyrueshëm në SHU. Siç u diskutua në Kapitull 2, KE në rishikimin më të fundit të fushës së shërbimit universal, vendosi në mënyrë specifike që të mos zgjerohet fushën e SHU për të përfshirë broadband në të gjithë BE. Kjo u bazua, ndër të tjera, se tregjet konkurruese janë të vendosur mirë për të zgjeruar tregun e broadband dhe se mundësitë e financimit të ndryshme nga detyrimet e SHU ishin të disponueshme dhe se shpenzimet e një detyrimi të tillë do të krijonin një barrë të rëndë jo-propocionale mbi sektorin e telekomunikacioneve vetëm, ndërsa subjekte të tjera private dhe publike dhe shoqëria në tërësi do të nkishin përfitime nga broadband kudo. Më tej, KE vuri në dukje se mandati para kohe i broadband në BE apo në nivel kombëtar rrezikon deformimin e tregjeve dhe pengimin e investimeve private në broadband.

Përkundrazi, duke pasur parasysh fleksibilitetin në këtë drejtim të përfshirë në DSHU, KE përcaktoi një grup kriteresh që Vendet Anëtare individuale duhet të konsiderojnë për përfshirjen e broadband në fushën kombëtare të detyrimeve të SHU. Me qëllim të zbatimit të konsistent në të gjithë BE-së, KE-ja ka kjuar rregullin e ashtuquajtur 50/80 ku detyrimi për të siguruar lidhjet broadband me një shpejtësi të dhënë në regjimin e detyrimit të SHU duhet të konsiderohet vetëm kur shkalla e të dhënave në fjalë është përdorur nga të paktën 50 % e të gjitha familjeve në nivel kombëtar dhe 80% e të gjitha familjeve me një lidhje broadband.

Niveli i penetrimit të broadband fiks në Shqipëri në Korrik 2012 ishte 5.3% dhe prandaj aktualisht nuk plotëson Rregullin 50/80 të përcaktuar nga KE në Komunikatën e Nëntor 2011. Duke përdorur të njëjtën metodologji si ajo e përdorur më lart në lidhje me "universalitetin" e penetrimit të telefonisë fikse, një nivel prag prej 50% e familjeve do të përkthehej në afërsisht gjysma e numrit të llogaritur më sipër ose $50\% * 29\% \approx 15\%$ penetrim broadband.

Për të vënë këtë objektiv të ndërmjetëm në perspektivë, ne vëmë re nga Figura 10 në Kapitullin 3, se vendet e BE-12 në vitin 2005 patën një penetrim mesatar broadband fiks prej 5% e cila arriti 15% në vitin 2008, apo tre vjet më pas. Në të kundërt, vendet e CPC-5 që janë ekonomikisht-më-të krahasueshme (me Shqipërinë), kishin një penetrim broadband fiks prej 4% në 2007 dhe nuk kishin arritur ende në 15% në vitin 2010 (ose në vitin 2011 në bazë të projeksioneve). Një penetrim prej 15% mund të arrihet nga vendet e CPS-5 deri në fund të vitit 2012, ose pesë vjet pas arritjes së 5%. Nxjerrja e vlerësime të tilla sugjeron se Shqipëria, mund të arrijë një penetrim prej 15% broadband në rreth pesë vjet nga arritja e penetrimit 5% në vitin 2011, pra rreth vitit 2016. Bazuar në këto parashikime, Shqipërisë mund t'i duhen edhe katër vjet që të plotësojë pragun e Rregullit 50/80.

Siç është përmendur në Kapitullin 2 dhe në përputhje me nenin 32 të DSHU, Vendet Anëtare janë të lira të ndjekin iniciativa broadband jashtë kontekstit të marrëveshjeve të detyrueshme të SHU dhe mekanizmit të kontributeve të sektorit. Ky është edhe rasti i Shqipërisë, ku Qeveria Shqiptare ka ndjekur një numër iniciativash për të promovuar broadband.

Ligji 9918 aktualisht nuk përfshin broadband si një element të përcaktuar të detyrimeve të SHU. Siç përcaktohet në Kapitullin 2, element aktual i detyrimeve të SHU është aksesin dhe shërbimi i telefonik nga vendndodhje fikse dhe shërbimet e të dhënave, "komunikim i të dhënave me shpejtësi minimale prej 32 kbit / s". Amendimet korresponduese të propozuara nga Qeveria e Shqipërisë janë identike me dispozitat përkatëse të DSHU: "komunikimin e të dhënave, me një shpejtësi të kënaqshme për të lejuar aksesin funksional të Internetit, duke marrë parasysh teknologjitë mbizotëruese të përdorura nga shumica e pajtimtarëve dhe mundësitë e realizimit teknologjik".

Siç është diskutuar në Kapitullin 2, Draft Plani Broadband përfshin një sërë objektivash/ synimesh (target) dhe procedurash për zhvillimin e ardhshëm të Broadband në Shqipëri (deri në vitin 2020), si dhe masat për mbështetjen e tij. Draft Plani Broadband parasheh që shtrirja e broadband do të arrihet kryesisht nëpërmjet zgjerimit dhe ndërtimit nga operatorët bazuar në mekanizmat e tregut dhe fokusohet në krijimin e instrumenteve të nevojshme për të lejuar lojtarët e tregut të konkurrojnë. Përveç konkurrencës në treg, dhe me qëllim të plotësisht të objektivave, përfshirë ato në lidhje me broadband në zonat e pashërbyera dhe pak të shërbyera, Qeveria Shqiptare është duke shqyrtuar instrumentet dhe mjetet rregullatore që synojnë rritjen e investimeve dhe aksesin në infrastrukturën e telekomunikacioneve në zonat rurale me kosto të lartë dhe të ardhura të ulëta. Midis alternativave të listuara përfshihen financimi i shërbimit universal, metodat e tjera të financimit, metoda financimi të mandatuara nga Shteti dhe të kontrolluara, minimizimi dhe/ose heqja e ndonjë taksimi specifik për telekomunikacionet; përgatitjen e udhëzimeve të politikave miqësore ndaj investimeve, mjete inovative për të siguruar mbështetje financiare etj.

Pyetje #8: Ju lutem jepni komentet tuaja mbi diskutimin për Broadband për shkak se është i lidhur me elementin Akses & Shërbim nga Vendndodhje Fikse të detyrimit të SHU. A ka aspekte të tjera që AKEP duhet të marrë në konsideratë në analizën e tij?

5.3.1.5 Fusha e Shërbimit Universal

Në lidhje me fushën e shërbimit universal ekzistojnë disa çështje dhe opsione të rëndësishme. Fillimisht këto janë dhënë të përmbledhura dhe më pas ato jepen të detajuara.

- Kriteri i teknologjisë fikse me tela për përcaktimin e një qasjeje me neutralitet teknologjik për caktimin. Kjo çështje është objekt i diskutimit në Opsionet #1 dhe #2.
- Nëse detyrimi i mbulimit gjeografik do të fokusohet në zonat aktualisht të shërbyera dhe/ose zonat e pashërbyera. Kjo çështje është objekt diskutimi në Opsionet #3 dhe #4.
- Nëse duhen përfshirë ose jo Tarifatat Sociale në detyrimet e SHU. Kjo çështje është objekt diskutimi në Opsionet #5 dhe #6.
- Nëse duhet të mandatohet ose jo aksesit broadband në detyrimet e SHU. Kjo çështje është objekt diskutimi në Opsionet #7 dhe #8.

Është e qartë se këta elementë të fushës janë të ndërlidhur, në atë që zgjedhja në një do të ketë impakt në zgjedhjen e tjetër. Megjithatë, konceptualisht, AKEP beson se këto janë çështje të vecanta dhe duhet të vlerësohen në mënyrë substanciale në këtë fazë të procesit. AKEP do të marrë në konsideratë ndër-lidhshmërinë e tyre në analizimin e mëtejshëm të fushës, përfshirë atë të bazuar në komentet e marra nga Palët e interesuara.

Është e rëndësishme të vëmë re se DSHU vendos theksin kryesor në arrijen e objektivave të shërbimit universal bazuar në rezultatet e tregut nëpërmjet konkurrencës efektive dhe zgjedhjes dhe se ndërhyrja rregullatore duhet të ndërmerret vetëm nëse nevojat e përdoruesve fundorë nuk plotësohen nga tregu. Në këtë kontekst mund të ndodhë që disa nga objektivat e lidhura me këto elementë të objektit të jenë plotësuar ose pritet të plotësohen në masë të konsiderueshme nga rezultatet e tregut. Në këto raste, parimet e DSHU sugjerojnë se detyrimet e SHU nuk janë të nevojshme ose të përshtatshme për atë element.

Më tej, çdo element i fushës ka implikime administrative dhe shpenzime. Gjithashtu, brenda çdo elementi të fushës, sa më i zgjeruar të jetë opsioni aq më shumë kosto ka implementimi dhe administrimi i tij dhe aq më shumë e mundshme është që ai të shkaktojë shtrembërime në treg. DSHU kërkon nga AKR-të të përcaktojnë qasjen më eficiente dhe “të kërkojnë të minimizojnë shtrembërimet e tregut në vecanti ofrimin e shërbimeve me çmime ose objekt i termave dhe kushteve të tjera që devijonë nga kushtet normale komerciale, ndërsa në të njëjtën kohë ruajnë interesin e publikut.”

Elementi #1: Kriteri Teknologjik për Caktimin

Fillimisht duhet të vendoset për një qasje në lidhje me kriterin teknologjik të përdorur për përcaktimin e këtij elementi të detyrimeve të SHU. Opsionet më poshtë parashtrajnë disa nga qasjet më kryesore:

- **Opsioni #1. Ruaj një kriter teknologjik “tradicional” fiks me tela.** Kjo është e bazuar në situatën që ishte në vitin 2002, kur u miratua DSHU e parë, dhe penetrimi mesatar fikse për vendet e BE-15 në vitin 2002 ishte 51% dhe objektivi, në kontekstin e liberalizimit, ishte për të mbrojtur aksesin ekzistues me një çmim të përballeshëm. Sipas këtij opsioni, Shqipëria do të vazhdojë të përqëndronte ndërhyrjen rregullatore për SHU në disa ose të gjitha teknologjitë fikse me tela për të promovuar shërbimin

universal në këtë element të detyrimeve të saj. Duke pasur parasysh penetrimin relativisht të ulët të Shqipërisë për fiksin, ky Opsion mund të jetë relativisht më i kushtueshëm për shkak se ai mund të kërkojë burime të rëndësishme për të ruajtur ose zgjeruar penetrimin e tillë fikse. Megjithatë, duke pasur parasysh preferencat aktuale të konsumatorit, siç është shfaqur në madhësinë dhe rritjen relative midis penetrimin fikse dhe celulare, ka mundësi që marrja e shërbimeve të tilla nga konsumatori të jetë relativisht modeste.

- **Opsioni #2. Adoptimi i kriterit me neutralitet teknologjik të vendndodhjes fikse për caktimin.** Sektori i Shqipërisë është zhvilluar në mënyrë të ndryshme nga zhvillimi i ndodhur në vendet e BE-15 në vitin 1998 apo 2002. Siç u përmend më lart duke marrë në konsideratë dinamikën e penetrimin dhe mbulimit celular/fiks, një pjesë e vendeve të BE-12 dhe CPC kanë vendosur që disa shërbime të ofruara nga rrjetet celulare plotësojnë kriteret për këtë element të SHU. Një grup i ngjashëm shërbimesh aktualisht janë të disponueshme edhe në Shqipëri: siç u përmend në Kapitull 2 në lidhje me Vendim 2138, shërbimi FGSM "AMC Fiks" është i disponueshëm duke përdorur një pajisje të specializuar telefonike fikse me një numër fikse që akseson rrjetin GSM të AMC (me 99.8% mbulim popullsisë) dhe ky shërbim konsiderohet si pjesë e tregjeve përkatës me pakicë të aksesit/thirrjeve nga vendndodhje fikse³⁴. Gjithashtu, edhe Vodafone Albania ka marrë numeracion gjeografik për një shërbim të ngjashëm por ende nuk është operacional. Duke pasur parasysh se në kombinim me mbulimin e Albtelecom dhe të OA të tjerë, mbulimi me rrjet GSM i popullsisë nga AMC prej 99.8% do të thotë se ky element i detyrimeve të SHU është shumë afër të qënurit i disponueshëm në mënyrë universale në Shqipëri, dhe në këtë mënyrë tregu është duke plotësuar në mënyrë të arsyeshme nevojat e përdoruesve fundorë në aspektin e disponibilitetit të këtij elementi të detyrimeve të SHU.

Pyetja #9: Ju lutem jepni komentet tuaja mbi analizën dhe opsionet e diskutuara më sipër. Ju lutem rendisni këto opsione nga ai më i përshtatshmi në atë më pak të përshtatshmin për Shqipërinë. Ju lutemi përshkruani opsione të tjera (ose variacione të opsioneve të përshkruara më sipër) që AKEP duhet të marrë në konsideratë në analizën e tij

Elementi #2: Shtrirja/Mbulimi Gjeografik

Opsionet # 1 dhe #2 kërkojnë trajtim të mëtejshëm në lidhje me llojin dhe mbulimin gjeografik të elementit të caktuar të detyrimit të SHU. Për shembull, sipas Opsion # 1, një gjykim kyç do të jetë nëse edhe OA do të mund të caktohen krahas Albtelecom në ato zona ku ky i fundit nuk është i pranishëm. Një tjetër komponent që duhet vendosur është metodologjia për të përcaktuar zonat me kosto të lartë të shërbimit ku për zona të veçanta gjeografike çmimet e mesatarizuara kombëtare të fiksit janë joekonomike. Logjikisht do të duhet të përcaktohet shtrirja gjeografike e detyrimit. Për shembull, një mënyrë për të parë këtë çështje do të ishte për të përqendruar vëmendjen në ato zona të territorit kombëtar që nuk kanë fare shërbim fikse. Në këtë mënyrë, regjimi i detyrimit të SHU do të fokusohet në

³⁴ Vendimi 2138 arriti gjithashtu në përfundimin se aksesit/thirrjet nga rrjetet celulare nuk janë pjesë e tregut përkatës të aksesit/thirrjeve nga vendndodhje fikse. Gjithashtu, siç u diskutua në Kapitull 2 dhe 4, DSHU nuk përfshin mobilitetin si pjesë të lëtij elementi të detyrimeve të SHU, i cili është përkufizuar specifikisht që të jetë nga një vendndodhje e përcaktuar. Asnjë VA nuk ka përfshirë mobilitet të tillë në detyrimet e veta të SHU.

zgjerimin e rrjetit fiks në zonat ku ofrohet, në vend të ruajtjes së rrjetit ekzistues fiks. Ky zgjerim i rrjetit me "projekt pas projekti" është i mirë testuar në shumë vende të botës.

Sipas Opsionit # 2, të gjitha sa u diskutuan më sipër gjejnë zbatim, me dallimin se madhësia relative e territorit të pambuluar në Shqipëri është relativisht shumë më e vogël. Siç është vërejtur më sipër, mbulimi i popullsisë nga rrjeti GSM i AMC, nëpërmjet të cilit ofrohet shërbimi FGSM "AMC Fiks", është 99.8%, dhe për këtë arsye popullsia e pambuluar me shërbim FGSM është vetëm 0.2%, që përbën një numër të kufizuar të komunave/fshatra të vecanta në Shqipëri.

- **Opsioni # 3. Mbulimi gjeografik përfshin vetëm zona të pambaluara aktualisht.** Fokusi i kësaj qasje do të ishte për të siguruar infrastrukturë, akses dhe shërbimit në zonat gjeografike që aktualisht nuk kanë shërbim, bazuar në përcaktimin sipas teknologjisë të diskutuar më lart. Natyrisht, fusha e këtij opsioni, dhe kostoja e tij relative, do të ishte dukshëm më i madh nëse përzgjidhet Opsioni # 1 ndaj Opsioni # 2. Kjo është për shkak se mbulimi i popullsisë i rrjetit GSM të AMC është shumë më i madh (99.8%) se ai i gjithë rrjeteve fikse të marrë së bashku. Zonat e pambaluara do të shërbeheshin në bazë të një procesi tenderi "projekt pas projekti" ku OSHU i caktuar ka detyrimin të ofrojë shërbimin në zonën e veçantë gjeografike.
- **Opsioni # 4. Mbulimi gjeografik përfshin vetëm zonat aktualisht me shërbim me kosto të lartë.** Në të kundërt, prioritet në këtë qasje do të ishte sigurimi i mbështetjes së vazhdueshme financiare për mesatarizimin gjeografik/zona me kosto të lartë të shërbimit ku çmimet e mesatarizuara kombëtare të fiksit janë joekonomike. Përcaktimi i OSHU do të varet gjithashtu nga fakti nëse në një përcaktim të tillë do të përfshihen pajtimtarët ekzistues dhe/ose të rinj. Qasja standarde është që një OSHU të caktohet për të siguruar shërbimin e caktuar për abonentët e rinj. Në këtë rast, shërbimi i detyrimit të SHU mund të bashkë-ekzistojë me shërbimet e tjera të ofruara nga sipërmarrësit e tjera në zonat gjeografike, por vetëm OSHU i caktuar ka të drejtë të kërkojë kompensim. Ky është rasti i Malit të Zi, për shembull, i cili është përshkruar në Kapitullin 4.

Pyetja #10: Ju lutem jepni komentet tuaja mbi analizën dhe opsionet e diskutuara më sipër. Ju lutem rendisni këto opsione nga ai më i përshtatshmi në atë më pak të përshtatshmin për Shqipërinë. Ju lutemi përshkruani opsione të tjera (ose variacione të opsioneve të përshkruara më sipër) që AKEP duhet të marrë në konsideratë në analizën e tij.

Elementi #3: Tarifat Sociale

Paketat tarifore për përdorim të ulët dhe Tarifat Sociale të SHU janë të disponueshme në disa vende anëtare. Vendet CPC kanë një kombinim të paketave për Përdorim të Ulët, Tarifave Sociale të SHU dhe Tarifa të Tjera Sociale. Si është vënë në dukje më sipër, bazuar në një vendim të kohëve të fundit të KM, në Shqipëri nuk ka më Tarifa Sociale në vetvete, sepse skema u ndërrua me një skemë tjetër ku Qeveria e Shqipërisë ofron një pagesë subvencionimi direkte për përdoruesit e përcaktuar me aftësi të kufizuar për blerjen e shërbimeve të telekomunikacioneve fikse. Në këtë aspekt, një objektiv kyç, duke marrë parasysh të gjithë analizën mbi paketat tarifore me përdorim të ulët dhe mbështetjen me subvencion direkt nga Qeveria e Shqipërisë, është nëse për Shqipërinë do të ishte e përshtatshme një paketë e llojit Tarifa Sociale e detyrimit të SHU në përputhje me DSHU dhe Ligjin 9918.

- **Opsioni # 5. Nuk ka nevojë për Tarifa Sociale të SHU pasi tregu plotëson nevojat e përdoruesve fundorë.** Si një e tërë, analiza paraqitur në Kapitullin 3 dhe në seksionet e mësipërme në këtë kapitull sugjerojnë se ky element i detyrimeve të SHU është relativisht i përballueshme për një numër shumë të madh të Shqiptarëve. Çmimet aktuale për paketën standarde të Albtelecom ose për paketën AMC Fiks, që është e disponueshme më gjerësisht, janë shumë më poshtë se mesataret e BE dhe rajonit dhe përbëjnë një pjesë në përqindje relativisht shumë të vogël të të ardhurave mesatare personale. Këto mund të bëhen edhe më të përballueshme për të ulët të përdorimit të abonentëve duke zgjedhur nga opsionet e disponueshme me parapagesë. Më tej, në qoftë se paketa AMC Fiks merret në konsideratë sipas Opsion # 2, ajo është e disponueshme për më shumë se 99,8% të popullsisë kombëtare, bazuar në mbulimin e rrjetit celular GSM të AMC. Më tej, siç u diskutua më sipër, dinamikat e tregut në Shqipëri janë të tilla që shumë përdorues do të zgjidhnin paketën me parapagesë celulare si një alternativë konkurruese të këtij elementi të detyrimeve të SHU.
- **Opsion # 6. Një paketë e re Tarifa Sociale të SHU është e nevojshme duke pasur parasysh se tregu nuk po plotëson nevojat e përballueshmërisë së grupeve të veçanta shoqërore.** Siç u përmend më lart, Qeveria tani ofron një pagesë të drejtpërdrejtë subvencionimi për përdoruesit të përcaktuar me aftësi të kufizuara për blerjen e shërbimeve fikse të telekomunikacionit. Për shembull, kjo mund të përfshijë telefoni së bashku me akses në Internet, përfshirë me shpejtësi broadband. Megjithatë, grupet e tjera të veçanta sociale nuk janë të përfshira direkt në një skemë të tillë. Në disa VA, Tarifet Sociale për telefoninë fikse përfshijnë familje me të ardhura të ulëta, për shembull. Në Shqipëri mund të jetë rasti, që një paketë e re e tipit Tarifa Sociale të SHU të hartohet që të jetë e disponueshme vetëm për familjet e përaktuara me të ardhura të ulëta. Një OSHU do të duhet të jetë i caktuar për të ofruar një paketë të tillë Tarifa Sociale të SHU. Më tej, do të duhet të përcaktohet fusha e kësaj pakete Tarife Sociale e SHU, përfshirë nëse ajo do të përfshijë aksesin në Internet, dhe nëse po, në çfarë shpejtësie, përfshirë shpejtësinë broadband. Natyrisht, në këtë rast do të duhet të merret parasysh administrimi i një skeme të tillë, për shkak se kushtet e përfitimit të saj do të duhet të hartohen dhe bashkërendohen së bashku me departamentet përkatëse që merren me administrimin e programeve të asistencës sociale të Qeverisë Shqiptare të lidhura me të ardhurat e ulëta.

Pyetja #11: Ju lutem jepni komentet tuaja mbi analizën dhe opsionet e diskutuara më sipër. Ju lutem rendisni këto opsione nga ai më i përshtatshmi në atë më pak të përshtatshmin për Shqipërinë. Ju lutemi përshkruani opsione të tjera (ose variacione të opsioneve të përshkruara më sipër) që AKEP duhet të marrë në konsideratë në analizën e tij.

Elementi #4: Aksesi Broadband

Siç u diskutua më sipër, versioni aktual i DSHU ofron mundësinë Vendeve Anëtare, por jo detyrimin, për të përfshirë aksesin në lidhje broadband brenda fushës së SHU kombëtar. Pasi broadband përfshihet në detyrimet e SHU, ai mund të financohet nga mekanizmat kontributiv të sektorit; përndryshe ai duhet të financohet nga fondet publike ose direkt nga operatori broadband.

Shqipëria aktualisht nuk plotëson Rregullin 50/80 të KE, për të mandatuar ofrimin e broadband në detyrimet e tij kombëtare të SHU. Njëkohësisht nuk është as e mundur për të përmbushur këtë prag deri rreth vitit 2016. Megjithatë, në bazë të nenit 32 të DSHU, Shqipëria është e lirë për të ndjekur nismat broadband jashtë kontekstit të rregullimeve të detyrueshme SHU dhe mekanizmave të kompensimit me kontribute të sektorit, përfshirë ato të përshkruara në Draft Planin Broadband.

- Ligji 9918 aktualisht nuk përfshin broadband si një element të përcaktuar të detyrimeve të SHU. Amendimet e propozuara nga Qeveria e Shqipërisë përmbajnë përcaktimin se aksesit dhe shërbimi nga vendndodhje fikse mund të përfshijë komunikim të të dhënave “me shpejtësi të kënaqshme për të lejuar aksesin funksional të Internetit, duke marrë parasysh teknologjitë mbizotëruese të përdorura nga shumica e pajtimtarëve dhe mundësitë e realizimit teknologjik”. Ky është një përcaktim i njëjtë me atë DSHU dhe përmban nivelin prag kritik që duhet të merret në konsideratë për shpejtësinë e të dhënave “teknologjitë mbizotëruese të përdorura nga shumica e pajtimtarëve”, mbi të cilën bazohet edhe Rregulli 50/80 i KE. **Opsioni # 7. Caktoje tani aksesin broadband si një shërbim të detyrueshëm të SHU.** Duke ditur se ajo aktualisht nuk e plotëson prapësinë për Rregullin 50/80, Shqipëria mund të vendosë të përfshijë aksesin broadband në një regjim të ri të SHU, bazuar në disa nga parimet e përfshira në Draft Planin Broadband. Rregulli 50/80 aplikohet rreptësisht vetëm për Vendet Anëtare. Në diskutimin për çështjen e kostove të përfshirjes së broadband si një detyrim i SHU, KE në Komunikatën e saj në Nëntor 2011 vuri në dukje se një studim³⁵ i autorizuar për llogaritë të BE, përrlllogariti se kostot neto për të siguruar disponueshmërinë (mbulimi) dhe përbalueshmërinë (tarifat e subvencionuara sociale) e një lidhje broadband 2 Mbps ishte rreth 0.7% e xhiros së sektorit të telekomunikacioneve të BE si një e tërë. Megjithatë, kjo përqindje ndryshon në mënyrë të konsiderueshme midis Vendeve Anëtare, duke qenë më e lartë në vendet me popullsi të rrallë/rurale, me terren të vështirë apo me infrastrukturë më pak të zhvilluar. Norma më e lartë e kostos do të ishte në Rumani (4.6% e xhiros). Shqipëria nuk ishte përfshirë në studimin e BE, por duke pasur parasysh parametrat³⁶ e sipërpërmendura, është e mundur që kostot shoqëruese të përfshirjes së broadband në detyrimet e SHU në Shqipëri do të ishin më të mëdha se 5% e xhiros së sektorit në Shqipëri. Përqindje të tilla do të ishin shumë larg vlerave të intervalit të rekomanduar nga KE (shih Kapitullin 2) dhe atyre të vëna në praktikë në disa nga VA (shih Kapitullin 4) dhe do të krijonin një barrë dizproporcionale mbi sektorin e telekomunikacioneve. Për më tepër, një përqindje e tillë tejkalon ndjeshëm vlerat e dispozitave në ligjin 9918, i cili përcakton në nenin 30 se çdo FSHU do të financohet nga kontributet e sektorit nga sipërmarrësit që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike dhe kontributet të mos kalojnë 1% të totalit të të ardhurave. Neni 30 nuk përmend mundësinë e financimit publik të FSHU.
- **Opsioni # 8. Monitoro situatën, por mos përcakto broadband si një element të detyrueshëm të SHU për momentin.** Sipas kësaj qasjeje, aksesit broadband nuk do të përcaktohej në detyrimet e SHU në këtë kohë, me objektivin për t'i dhënë më shumë

³⁵ *Impakti i opsioneve të Politikave të BE për rishikimin e ofrimit të shërbimit universal*, Van Dijk Management Consultants etj., Tetor 2010

³⁶ Të ardhurat kombëtare të Rumanisë janë sa dyfishi i atyre të Shqipërisë; Penetrimi broadband i Rumanisë, fiks apo dhe celular, është dy apo tre herë më i madh se i Shqipërisë; Shqipëria ka një proporcion më të madh të popullsisë rurale se Rumania.

kohë tregut për të siguruar broadband në kushte komerciale. Analiza në Kapitullin 3 tregon se si broadband fiks dhe celular janë rritur me shpejtësi në Shqipëri dhe po i afrohen mesatareve të rajonit. Në këtë kontekst, Qeveria Shqiptare do të finalizonte Draft Planin Broadband, përfshirë objektivat dhe synimet korresponduese. Njëkohësisht, Qeveria Shqiptare do të monitoronte situatën dhe do të përdorte disa nga instrumentat e tjera, të ndryshme nga ato të detyrimeve të SHU të propozuara në Draft Planin Broadband për të fokusuar ngushtësisht fusha dhe aplikime të veçanta. Për momentin kjo do të shmangte financimin sektorial dhe subvencionim e tërthortë, me barrën shoqëruese në sektor dhe ndikimin mbi konsumatorët për shkak të kostove relativisht shumë të larta në rastin e Shqipërisë, siç u diskutua më sipër. Bazuar në një monitorim të tillë, AKEP do të shqyrtonte përsëri çështjen bazuar në zhvillimet e tregut, përfshirë shqyrtimin e saj para arritjes së niveleve prag të lidhura me Rregullin 50/80, p.sh. rreth datës 31 Dhjetor 2015. Së fundmi, siç theksohet në Komunikatën e Nëntorit 2011 të KE, "mandatimi para kohe i broadband në BE apo në nivel kombëtar rrezikon shtrembërimin e tregjeve dhe ngadalësimin e investimeve private në broadband. Ndërsa nga kompanitë e telekomunikacioneve mund të pritet të investojnë në rrjetet të reja fitimprurëse, një pyetje themelore shtrohet nëse detyrimet ekstensive të SHU, duke vënë një barrë të rëndë në sektorin vetëm në interes të përfshirjes sociale, do të ishte e përshtatshme dhe e qëndrueshme, ndërsa subjektet e tjera private dhe publike dhe shoqëria si e tërë nxjerrin përfitime nga broadband kudo. "

Pyetja #12: Ju lutem jepni komente në lidhje me çështjen nëse të caktohet broadband si një element i detyrueshëm i SHU në Shqipëri ose kjo të mos bëhet dhe të monitorohet situata dhe të përdoren politika të tjera për të promovuar broadband, përfshirë ato të parashtruara në Draft Planin Broadband. Ju lutemi jepni çdo koment shtesë mbi këtë çështje.

Çështje të Tjera

Në lidhje me caktimin OSHU, Ligji 9918 përcakton që së pari duhet të ndiqet një proces tenderi publik dhe pastaj së dyti, në qoftë se ai dështon, mund të ndiqet një procedurë emërimi (nominimi).³⁷

Në përputhje me DSHU, AKEP do të propozonte për të mbajtur një proces të hapur dhe transparent që nuk do përjashtonte ex ante asnjë operator apo lloj operatori që mund të plotësojë kriteret e caktimit. Idealisht, termat dhe kushtet që lidhen me këtë proces të tenderit do të ishin të tilla që OSHU të mos kishte nevojë apo kërkonte financim. Bazuar në analizën e Kapitullit 4, shumica e caktimeve me tender në vendet CPC priren të kenë kohëzgjatje 3-5 vjet.

Pyetje # 13: Ju lutemi jepni komentet tuaja për çdo proces tenderi publik për caktimin e një OSHU për të zbatuar këtë element të detyrimeve të SHU. Në veçanti, ju lutem komentoni mbi llojet e termave dhe kushteve të tilla që OSHU të mos ketë nevojë apo kërkojë asnjë financim të jashtëm. Më tej, ju lutem jepni komentet tuaja mbi periudhën e kohëzgjatjes së caktimit të OSHU.

³⁷ Vini re se amendamentet e propozuara të Qeverisë Shqiptare, rishikojnë dispozitat e caktimit të Ligjit 9918 në Nenin 26 dhe përcaktojnë se rregullat për caktimin e OSHU-ve do të miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të Ministrisë. Në këtë rast, në qoftë se amendamentet miratohen, AKEP do të ndjekë VKM, qoftë ajo caktim nga procesi i tenderit ose nominimin. Pavarësisht kësaj, çështjet substanciale të diskutuara në këtë seksion në lidhje me përcaktimin e OSHU janë të zbatueshme përsëri. E njëjta gjë vlen edhe për diskutimin e caktimit të OSHU-ve për elementet e tjerë të detyrimit të SHU më poshtë.

Nëse tenderi dështon, Ligji 9918 parashikon që AKEP mund të emërojë një OSHU për këtë element të detyrimeve të SHU. Sipas një skenari të tillë, AKEP mund të përfundojë (pezullojë) procesin e caktimit derisa kushtet të jenë më të favorshme për një tender të suksesshëm apo mund të vazhdojë me procesin e nominimit

Pyetja #14 Ju lutemi jepni opinionet tuaja në lidhje me kriteret e vendimit në rastin kur një tender dështon dhe AKEP duhet të vendosë midis përfundimit të procesit të caktimit derisa kushtet të jenë më të favorshme për një proces të tenderit të jetë i suksesshëm, apo ecjes përpara me një proces të emërimit.

Nëse AKEP do të vendoste për të lëvizur përpara me një proces të nominimit, pasi një proces tenderi ka dështuar, ai do të duhet të vendosë kriteret për të përcaktuar se cili operator ose cilët operatorë janë të vendosur më mirë për tu caktuar si OSHU për të siguruar elementin në fjalë të detyrimit të SHU, duke pasur parasysh kriteret e përcaktimit. Dokumenti i BEREC i referuar në Kapitullin 4 raporton që kriteret e mëposhtme janë kritere të zakonshme përcaktimi që janë përdorur nga AKR-të në BE:

- Kriteret teknike mund të përfshijnë, ndër të tjera:
 - Kërkesat të disponueshmërisë, p.sh. mundësia për t'u arritur nga abonentët e ofruesve më të mëdhenj të shërbimeve;
 - Kërkesa të cilësisë;
 - Përvoja në ofrimin e shërbimit në fjalë ose të shërbimeve të ngjashme;
 - Madhësia absolute dhe/ose relative e biznesit të sipërmarrësit, duke përfshirë shtrirjen, penetrimin dhe fleksibilitetin e rrjetit të tij të komunikimeve në ofrimin e shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun në zonën e caktuar nën shqyrtim.
- Kriteret ekonomiko-financiare mund të përfshijnë, ndër të tjera:
 - Gjendja ekonomike dhe financiare e sipërmarrësit;
 - Tarifat e përdoruesit fundor;
 - Kostoja neto/shuma e kompensimit financiar që kërkohet për të përmbushur detyrimin e SHU.

Pyetja #15: Ju lutemi jepni opinionet tuaja në lidhje me kriteret e përfshira më sipër që AKEP mund të marrë parasysh për të vendosur se cili operator ose cilët operatorë janë të vendosur më mirë për tu caktuar si OSHU për të siguruar elementin në fjalë të detyrimit të SHU. A ka kritere të tjera që AKEP duhet të marrë parasysh?

5.4 Disponueshmëria e Numeratorit të Përgjithshëm dhe Shërbimit të Kërkimit në Numerator

